



Kontrolli i Lartë i Shtetit

**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

PËRPUTHSHMËRIE

NË

**“AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL”
SHQIPTAR**

DHJETOR 2019



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Nr.	Përmbajtja.	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.	HYRJE	11
a.	Titulli	11
b.	Marrësi.	11
c.	Objektivat dhe qëllimi.	11
d.	Identifikimi i çështjes.	11
e.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.	11
f.	Përgjegjësitë e audituesve.	12
g.	Kriteret e vlerësimit.	12
h.	Standardet e auditimit.	13
i.	Përmbledhje e punës së kryer.	13
III.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT	13
Pika 1.	Mbi realizimin e Rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.	14
Pika 2.	Mbi hartimin dhe realizimin e buxhetit sipas strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe raportimi i tyre.	15
Pika 3.	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, Bordit të Administrimit të Këshillit Drejtues si edhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.	17
Pika 4.	Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve.	20
Pika 5.	Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.	25
Pika 6.	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimit të kontratave.	30
Pika 7.	Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël.	52
Pika 8.	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.	57
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	58
V.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	81
VI	ANEKSE	83
VII	SHKURTIME	93



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.A. PËRSHKRIM I PROJEKTIT TË AUDITIMIT.

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, është person juridik publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit që mbulon çështjet e transportit ajror. Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

I.B NJË PËRMBLEDHJE E GJETJEVE DHE REKOMANDIMEVE NGA AUDITIMI.

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
1.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: AAC nuk ka arkëtuar në buxhetin e shtetit, fitimin e ngelur pas mbylljes së vitit financiar 2017 dhe 2018. Fondi prej 181,846 mijë lekë i mbartur deri në muajin mars 2018 është një tejkallim prej 74,846,000 lekë të ngurtësuar në llogaritë e AAC. Gjithashtu, AAC në llogaritë e saj bankare, ka mbajtur pas muajit mars 2019, në kundërshtim me ligjin, një shumë prej 279,917,654 lekë ose 172,917,654 lekë më shumë sesa shuma e lejuar.	15-16	E mesme	Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, pas muajit mars të vitit pasardhës, të arkëtojnë në buxhetin e shtetit shumën e detyrimit ligjor.
2.	Likuidimi nga AAC në vlerën e 152,600 Euro, për llogari të konsulentit “RB” GMBH, në zbatim të kontratës për shërbime konsulence të nënshkruar midis Shtetit Shqiptar dhe Kompanisë Konsulente në datën 28.04.2018. Nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë shërbimet e kryera nga Konsulenti në përputhje me pikën 6.1 të kontratës së lidhur. Si rezultat, vlera e investuar nga AAC prej 152,600 euro, nuk është e justifikuar me dokumenta dhe fakte sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. Kjo vlerë duhet analizuar nga AAC dhe KD dhe nëse nuk argumentohet, të konsiderohet dëm ekonomik.	17-18	E lartë	Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithëshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e investuar nga AAC dhe të përfituar nga operatori ekonomik “RB” GMBH, dhe vetëm nëse nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës, të konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 152,600 Euro nga operatori ekonomik “RB” GMBH, si vlerë që i përket zërave të pa argumentuar në kundërshtim



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
				me nenin 6.1 të kontratës së lidhur.
3.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurën e marrjes me qira të ambienteve tek TBP, u konstatua se:</p> <p>1. AAC me përfaqësues z. KK, dhe TBP me përfaqësues znj. SA, kanë nënshkruar një kontratë për marrje ambientesh me qira në total 973.7 metra katror (sipërfaqe bruto) sipas nenit 1.1, pikës 1.1.1 të kontratës me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018;</p> <p>2. Në vazhdim është shkresa me nr. 74 prot., datë 13.06.2019 TBP dhe nr. 1176 prot., datë 17.06.2019 AAC, Propozim për zgjidhjen e kontratës së qirasë datë 19.11.2018, ku TBP propozon që të zgjidhet kontrata me mirëkuptim duke mbajtur vetëm pagesën e garancisë që është depozituar nga AAC me lidhjen e kontratës.</p> <p>3. Me shkresën me nr. 1176/1 prot., datë 18.06.2019 AAC i kërkon takim TBP-së për të negociuar kushtet e zgjidhjes së kontratës. Me shkresën nr. 1176/2 prot., datë 21.06.2019, janë dokumentuar minutat e takimit lidhur me negociimin e zgjidhjes së kontratës nga ku bihet dakord që nga qiramarrësi të mbahet vlera e garancisë e paguar nga AAC në datën e lidhjes së kontratës së qirasë, prej 20,252.96 Euro.</p> <p>-Sa më sipër, referuar gjetjeve dhe konkluzioneve të grupit të auditimit, vlera e likuiduar nga AAC, në favor të TBP prej 20,252,96 Euro, konsiderohet dëm ekonomik për AAC/Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga personat përgjegjës të cilët kanë vepruar në kundërshtim me interesat ekonomike të</p>	19-20	E lartë	<p><i>Ministri i Industrisë dhe Energjisë, Këshilli Drejtues i Autoritetit të Aviacionit Civil, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithëshme, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masat për të analizuar shkaqet dhe personat përgjegjës për dëmin ekonomik që i kanë sjellë AAC/Buxhetit të Shtetit dhe në vazhdim, nga personat përgjegjës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 20,252,96 Euro, vlerë e konsideruar dëm ekonomik dhe që i përket garancisë të likuiduar nga AAC në favor të TBP.</i></p>



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	institucionit.			
4.	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën e auditimit 01.01.2018 - 31.08.2019, u konstatuan 2 raste të ndryshimit të strukturës, respektivisht me 69 dhe 73 punonjës. Ndërsa para shkurtit të vitit 2018 në strukturën e AAC ka pasur 83 punonjës me organigramë duke tejkaluar në mënyrë të parregullt me 17 punonjës numrin e përcaktuar me VKM nr.100 datë 26.02.2014. Nuk ka relacione shpjeguese se përse bëhen këto ndryshime strukturore në numër dhe në përmbajtje.	21	E lartë	Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa, që në të ardhmen, të kërkojnë miratimin e strukturës nga Departamenti i Administratës Publike dhe nga Ministria e Financave.
5.	AAC ka shpenzuar nga humbja e proceseve gjyqësore në total për periudhën 20 muajore të auditimit, 6,112,547 lekë gjithësej, të ndarë në dy periudhat e ndryshme vjetore përkatësisht në 528,396 lekë (viti 2018) dhe 5,584,151 lekë (8 muajt e parë të vitit 2019).	22	E lartë	Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa, që në të ardhmen të mos i shkaktojnë Autoritetit efekte negative financiare nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës me punonjësit, prej mos respektimit të të gjitha kriterëve ligjore në fuqi.
6.	Nga auditimi i dokumentacionit të transferimeve kapitale të AAC, konstatohet se: Janë kryer dy transferime kapitale (automjete). Në të dy rastet për transferimin kapital të automjeteve, rezultoi se, në dosjet e transferimit nuk ka akte rrespektive të konfirmimeve, të cilat duhet të bëheshin për dërguesin brenda datës 20 të muajit pasardhës të cilat duhet të nënshkruheshin nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i njësisë pritëse. Gjithashtu nga Organet drejtuese të Autoritetit nuk është kryer ndonjë vlerësim për to, të cilat të jenë konsideruar të panevojshme përkohësisht për njësinë apo të jenë të papërdorshme nga AAC.	29-30	E mesme	Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në rastet e transferimeve kapitale, të kërkojnë dhe plotësohet praktika me dokumentacionin përkatës sipas kuadrit ligjor.
7.	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të	32-33	E lartë	



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	<p>auditimit lidhur me fillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO për nevojat e AAC”, lloji procedurës “Shërbim Konsulence”, me fond limit 6,966,189 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se kjo procedurë është iniciuar nga AAC në të njëjtën kohë që institucioni ka pasur struktura të ngritura për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë, të cilat, referuar rregullores së brendshme me nr. 549 prot., datë 23.04.2013, kanë pasur si detyrë parësore, monitorimin e përmbushjes së vazhdueshme të standarteve të cilësisë ISO.</p>			<p>Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë, të bashkëpunojnë me menaxherët e cilësisë dhe organet standardizuese për akreditimin, çertifikimin e institucionit me standardet ISO.</p>
8.	<p>Me shkresën nr. 1208/3 prot., datë 02.07.2018, Titullari i AAC, nxjerr urdhrin për pajtimin e një eksperti të jashtëm për antar të KVO për procedurën e prokurimit me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”. Me shkresën nr. 1208/4 prot., datë 04.07.2018, Titullari i AAC, nënshkruan kontratën me ekspertin e jashtëm z. RS. Në dosjen e procedurës së prokurimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion verifikues për mënyrën e përzgjedhjes së ekspertit të jashtëm si antar i KVO në ndryshim nga mënyra e përzgjedhjes së ekspertit për hartimin e DST për të cilin është shpallur vendi vakant në faqen web të AAC. Kontraktimi i ekspertit të jashtëm nga Drejtori i AAC duke nënshkruar kontratën është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, jo transparente dhe diskriminuese. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe konkretisht të dosjeve të personelit, u konstatua se AAC në</p>	43	E ulët	<p>Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, të propozojnë kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për procedurat e prokurimit, vetëm pasi të jetë konkluduar se AAC ose dhe Autoritete të tjera Kontraktore, nuk kanë në përbërje të strukturave të tyre, punonjës të specializuar.</p>



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	<p>stafin e saj ka nëpunës të specializuar në shkencat ekonomike me profesion ekspert kontabël të regjistruar madje edhe auditues. Vlera e shpenzuar për kontraktimin e ekspertit të jashtëm, sipas urdhër xhirimit të bankës BKT me kod 205/11552 dhe datë 15.02.2019, është 94,581 lekë dhe përbën shpenzim me efekte negativ financiar për AAC dhe buxhetin e shtetit.</p>			
9.	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt “<i>Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s</i>”, viti 2018, AAC ka likuiduar operatorin ekonomik “BA” SHPK për një ekspert më shumë krahasuar me numrin e ekspertëve të kërkuar për përmbushjen e kushteve të kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, referuar dosjes së zbatimit të kontratës, u konstatua se operatori ekonomik, ka dorëzuar faturën për likuidim në vlerën sipas strukturës së propozimit ekonomik të ofruar në procedurën e prokurimit. Tek ky propozim, tek pika 2 përcaktohen në total 9 ekspertë dhe konkretisht sipas pikës 3, kostot e drejtpërdrejta, 1 partner menaxhimi, 1 drejtues ekipi, 2 auditues dhe 5 ekspertë financiar kontabël. Tek DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3, kapaciteti teknik, kriteret kualifikuese të stafit të domosdoshëm për këtë shërbim, kërkohet që: “<i>Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në përbërje të stafit të tij, Partner Menaxhimi 1 (një punonjës), Drejtuesi i Ekipit 1 (një punonjës), Ekspertë të Kontrollit Financiar (Auditues Ligjor) 2 (dy punonjës) dhe Ekspertë Financiar & Kontabël 4 (katër punonjës)</i>”. Në total, kërkohen 8 ekspertë mbi bazën e të cilëve</p>	4546	E lartë	<p>Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e shpenzuar me pasojë efekt negativ për institucionin dhe të nxirren personat përgjegjës.</p>



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	<p>është kryer dhe përlogaritja e fondit limit nga grupi i ngritur me shkresën nr. 777/5 prot., datë 26.04.2018, të përbërë nga SP (AAC), IB (Eksp.Jashtëm) dhe KK (AAC). Në vazhdim, nuk është evidentuar ky fenomen as nga strukturat përkatëse për likuidimin e operatorit ekonomik. Konkretisht, tek pika 3 e kostove të drejtpërdrejta, nga operatori ekonomik i kualifikuar “BA” SHPK, është ofertuar për një ekspert financiar & kontabël më tepër nga sa kërkohet në DST dhe në kontratën e lidhur. Pagesa ditore e ekspertit financiar & kontabël është 590 Euro për 36 ditë pune= 21,240 Euro më tepër të deklaruara në preventiv të cilat i përkasin zërit “Kostot e drejtpërdrejta”. Operatori ekonomik, duhej të vihej në dijeni të gabimeve në preventivin/faturën e dorëzuar me qëllim korrigjimin e faturës përfundimtare. Kjo vlerë, e likiduar më tepër në favor të operatorit ekonomik prej 21,240 Euro, përbën shpenzim me efekt negativ për AAC.</p>			
10.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me fillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”, lloji procedurës “Shërbim Konsulence”, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se kjo procedurë është iniciuar nga AAC pasi i është kërkuar përzgjedhja e konsulentit dhe mbulimi i shpenzimeve nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE). Drejtori i AAC, përpara se të nxirrte urdhrin për hartimin e</p>	48-49	E lartë	<p>Këshilli Drejtues i AAC, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të analizojnë vlerën e investuar prej 33,186,387 lekë për kryerjen e rishikimit të pavarur ekonomik, duke verifikuar nëse me kryerjen e këtij shpenzimi, janë zbatuar Rekomandimet e Konsulentit “BA” SHPK për arritjen e objektivave të përcaktuara më parë për “Rikthimin e ekuilibrit ekonomik të Konçesionit të TIA-s”. Në të kundërt, të nxirren përgjegjësitë për Drejtorin Ekzekutiv të AAC dhe Sektorin e Kontratave</p>



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	<p>termave të referencës apo urdhrin e prokurimit, duhej që të kërkonte mendim nga sektori i përfaqësimit ligjor dhe i prokurimeve të institucionit, duke analizuar detyrat e AAC sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi. Konkretisht, nga auditimi i ligjit të AAC dhe rregullores së brendëshme të institucionit, nga grupi i auditimit, konstatohet se AAC e ka pasur si detyrë të përcaktuar në rregulloren e brendëshme, monitorimin e performancës së Marrëveshjeve Koncesionare. Këtë detyrë, AAC e ka zbatuar prej vitesh aq më tepër që procedura e prokurimit kërkon rishikimin e pozicionit ekonomik për vitet e kaluara pra kontrata do ketë fuqi paravepruese dhe ndryshimi i strukturës në vazhdimësi pas vitit 2018, nuk ka luajtur rol në humbjen e aftësisë së AAC për të monitoruar Koncesionarët gjë që e ka bërë vazhdimisht në të kaluarën. Qëllimi final i kontratës së lidhur midis AAC dhe operatorit ekonomik “BA” SHPK, nuk është dorëzimi i një raporti lidhur me “Rishikimin e pavarur të pozicionit ekonomik të Koncesionit” por rikthimi i ekuilibrit ekonomik i konstatuar nga “BA” SHPK (nëse ka pasur disekuilibër) sipas gërmës b) dhe gërmës c) të klauzolës nr. 19.4 të ligjit nr.9312, datë 11.11.2004 (Kontrata Koncesionare) duke zbatuar një ose më shumë nga Rekomandimet e dhëna nga operatori ekonomik pas kryerjes së rishikimit të pavarur ekonomik të koncesionit.</p>			<p>dhe Shërbimeve, lidhur me fillimin e një procedure prokurimi dhe kryerjen e një investimi në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efijensës dhe efektivitetit të shpenzimeve të fondeve publike.</p>
11.	<p>Drejtori i AAC, ka lidhur një kontratë me objekt “<i>Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC</i>” me “IG” SHA, pa procedurë prokurimi duke shmangur konkurrencën.Me</p>	51-52	E lartë	<p>Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa, që në të ardhmen, të nënshkruhen</p>



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	<p>shkresën nr. 1023 prot., datë 22.05.2019, drejtori i AAC i dërgon kërkesën për mundësinë e ofrimit të shërbimit me roje të godinës së AAC-së, administratorit të shoqërisë “IG” SHA, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm të MB. Me shkresën nr. 1378 prot., datë 12.07.2019, Drejtori i AAC, nxjerr urdhrin për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit duke u drejtuar tek shoqëria “IG” SHA, për ofrimin e shërbimit si organ i ngarkuar me VKM. Përlllogaritja e vlerës së fondit limit, është kryer nga KK dhe vlera e fondit limit të përlllogaritur është 5,514,048 lekë pa TVSH. Në vazhdim, është nënshkruar kontrata me objekt “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC”, në datën 17.07.2019 midis AAC me përfaqësues KK dhe “IG” SHPK me përfaqësues administratorin HE. Vlera e kontratës është 6,616,857 lekë me TVSH me afat 1 vit nga data e lidhjes. Si rezultat, Drejtori i AAC KK, ka nënshkruar një kontratë pa ndjekur hapat konform ligjit dhe rregullave të prokurimit publik duke vendosur vetë për përzgjedhjen e operatorit/shoqërisë që do të ofrojë shërbimin e ruajtjes së godinës së AAC dhe duke nënshkruar një kontratë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Vlera e kontratës së lidhur pa TVSH është 5,514,048 lekë vlerë e cila krahasuar me kontratën e mëparshme me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat kushte, është 3,344,857.7 lekë më e lartë. Për arsye se deri në këto momente, nuk u konstatua asnjë likuidim në favor të shoqërisë “IG” SHPK, grupi i auditimit nuk mund të shprehet për ndonjë vlerë të shpenzuar me efekt negativ</p>			kontrata vetëm me ata operatorë ekonomikë që janë shpallur fitues nga një procedurë prokurimi në konformitet të plotë me ligjin e AAC dhe të prokurimit publik.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

GJETJA NR:	PËRMBLEDHJE E GJETJES.	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR.	RËNDËSIA.	REKOMANDIMI.
	financiar për AAC.			

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH me nr. 600/1 prot., datë 09.09.2019, nga data 10.09.2019 deri më datën 08.11.2019, në subjektin “Autoriteti i Aviacionit Civil”, për periudhën nga data 01.01.2018 deri me datë 31.08.2019, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.C, Përgjegjës grupi;
2. E.M, Auditues;
3. M.H, Auditues;
4. A.T, Auditues.

a. Titulli:Raport Përfundimtar mbi auditimin e përputhshmërisë së aktivitetit të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar.

b. Marrësi: Autoriteti i Aviacionit Civil, me Drejtor Ekzekutiv z. KK.

c. Objektivat dhe qëllimi: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që Autoriteti i Aviacionit Civil, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së shoqërisë. Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet në aktet ligjore. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjessëm mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).

d. Identifikimi i çështjes: Insitucioni duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj operatorëve të transportit ajror, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: AAC-ja është përgjegjëse për zbatimin e Kodit Ajror. Ministri është autoriteti mbikëqyrës i AAC-së. AAC-ja ushtron funksionet e autoritetit kombëtar të mbikëqyrjes në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

f. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

g. Kriteret e vlerësimit: Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së; Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr. 791, datë 14.11.2012 “Për miratimin e strukturës e të organikës, si dhe të strukturës e të niveleve të pagave të Autoritetit të Aviacionit Civil”, i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”; “Rregulloren e Brendshme të Autoritetit”; Ligjin nr. 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”; Ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10479, datë 10.11.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa” në Ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”; Ligjin nr. 168/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa” në Ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”; Ligjin nr. 9551, datë 05.06.2006; Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Garancitë Ndërkombëtare në Pajisjet e Lëvizshme” dhe në Protokollin e saj; Ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit European dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të përbashkët të Aviacionit European”; Ligjin nr. 10435, datë 23.06.2011 “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 8278, datë 15.01.1998 “Për ratifikimin nga Republika e Shqipërisë të Protokollit në lidhje me një Amendament të Konventës për Aviacionin Civil ndërkombëtar, nënshkruar në Montreal më 1980”; Ligjin nr. 9586, datë 20.07.2006 “Për ratifikimin emarrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European për aspekte të caktuara të shërbimeve Ajrore”; Ligjin nr. 34/2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë së Shtetit të Katarit për shërbimet Ajrore”; Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”; Ligjin nr. 8150, datë 11.09.1996 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për unifikimin e disa rregullave të transportit Ajror ndërkombëtar”, nënshkruar në Varshavë në datën 12.10.1920; Ligjin nr. 9312 datë 11.11.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së Koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Koncesionare “Tirana Airport Partners” SHPK, “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj Shoqërie Koncesionare”, i ndryshuar, etj; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për këshillat



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11, datë 06.05.2016 dhe nr.20, datë 17.11.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Udhëziminr.318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”; Ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”.

h. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 - *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik).*
- ISSAI 400 - *(Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).*
- Kodi etik i KLSH.

i. Përmbledhje e punës së kryer.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit janë konstatuar mangësi në hartimin e dokumentave standarte të tenderit, në vlerësimin e ofertave të ardhura dhe në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale sipas kushteve të përcaktuara në kontratat përkatëse.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Autoriteti i Aviacionit Civil (këtu e më poshtë AAC) është person juridik publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit që mbulon çështjet e transportit ajror. Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

Drejtor Ekzekutiv i Institucionit është z. KK ndërsa Këshilli Drejtues aktualisht përbëhet nga 5 anëtarë dhe konkretisht z. SL-Kryetar për periudhën 01.01.2018-31.10.2018, z. AS-Kryetar për periudhën 01.12.2018-31.08.2019 e në vazhdim, z. HC-Antar për periudhën 01.01.2018-31.09.2018, znj. BL-Antare për periudhën 01.01.2018-31.08.2019 e në vazhdim, znj. EK-Antare për periudhën 01.12.2018-31.08.2019 e në vazhdim, z. VA-Antar për periudhën 01.01.2018-31.08.2019 e në vazhdim dhe znj. EK-Antare për periudhën 01.01.2018-31.08.2019 e në vazhdim. Autoriteti i Aviacionit Civil ka funksionuar deri në datën 13.06.2019, me rregulloren e brendëshme për “Rregullat e Brendshme të Autoritetit të Aviacionit Civil”, e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 23.04.2013. Me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 5, datë 13.06.2019, është miratuar Rregullorja e re për “Rregullat e Brendshme të Autoritetit të Aviacionit Civil”.

AAC-ja është përgjegjëse për zbatimin e Kodit Ajror. Ministri është autoriteti mbikëqyrës i AAC-së. AAC-ja ushtron funksionet e Autoritetit Kombëtar të mbikëqyrjes në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është rregullshmëria e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga data 01.01.2018 deri në datën 31.08.2019.

Qëllimi i auditimit është hartimi i Raportit Përfundimtar të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjeteve, si dhe dhënia e Rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të shoqërisë.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Është audituar aktiviteti i institucionit për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Janë audituar shpenzime për personelin dhe paga për një periudhë afro 20 mujore me vlerë rreth 299,634,000 lekë. Janë audituar procedurat e prokurimit në masën 100 % si në sasi, ashtu edhe në vlerë, me vlerë kontrate 68,052.669 lekë. Është audituar zbatimi i të gjitha kontratave përkatëse. Është audituar hartimi i pasqyrave financiare, programi i zhvillimit, dhënia dhe marrja me qira e ambienteve në dispozicion të shoqërisë etj.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Mbi realizimin e Rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

1.1 Titulli i gjetjes: Situata e realizimit të Rekomandimeve të lëna në auditime mëparshëm.

Situata: Nga auditimi i mëparshëm janë rekomandur:

- 2 (dy) masa për përmirësim legjislacioni të cilat janë realizuar pjesërisht;
- 11 (njëmbëdhjetë) masa organizative nga të cilat 3 (tre) masa të realizuara, 3 (tre) masa realizuar pjesërisht dhe 5 (pesë) masa në proces;
- 21 (njëzetë e një) masa për shpërblim dëmi në vlerën 259,424 mijë lekë, nga të cilat 4 (katër) masa nuk janë pranuar, 10 (dhjetë) masa në proces dhe 7 (shtatë) masa të pa zbatuara;
- 7 (shtatë) masa për Eliminimin e efekteve negative, nga të cilat 1 (një) masë nuk është pranuar dhe 6 (gjashtë) masa në proces;
- 6 (gjashtë) masa disiplinore, nga të cilat 5 (pesë) masa të realizuara dhe 1 (një) masë në proces.

-Aneksi nr. 1

Kriteri: Neni 15 pika c, e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Ndikimi: Mos zbatimi i plotë i Rekomandimeve.

Shkaku: Nuk është vepruar nga AAC për zbatimin e Rekomandimeve.

Rëndësia: Elartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masat e duhura për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e kaluar.

Afati: Në vazhdimësi.

Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Drejtori i AAC z.KK.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK është paraqitur observacioni me nr. 2047/7 prot., datë 15.11.2019 ku pretendohet se:

Në aktkonstatimin nr. 1, datë 08.11.2019 grupi i auditimit mbi zbatimin e Rekomandimeve nuk ka vlerësuar saktë.

Qëndrimin i grupit të auditimit:

Sa i përket pretendimit të bërë nga përfaqësuesit e AAC, ju sjellim në vëmendje se: Në programin e auditimit nr. 600/1 prot., datë 09.09.2019 një prej angazhimeve të këtij procesi është pika 1 me objekt “Mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm”, në lidhje me këtë çështje institucioni juaj ka gjithë detyrimin ligjor për të vënë në dispozicion brenda aftit të auditimit të gjithë dokumentacionin e duhur për realizimin e tyre, në këto kushte grupi i auditimit ka gjykuar mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion. Ndryshime dhe



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

përmirësimeLegjislacioni: 1.Duhet të kryhet shfuqizimi i udhëzimit. Masa organizative: 2. Zbatimi i tij nënkupton jo vetëm këshillim ligjor për nxjerrjen e urdhrave por për zbatimin e akteve. 8. Për zbatimin e këtij Rekomandimi nuk keni vendosur asnjë dokumentacion në dispozicion dhe vlerësimi jepet vetëm për arkëtimin e vlerës. 9. Opinioni dhe vlerësi jepet vetëm për pjesën e akrëtimin të vlerës. 10. Copëzime fondi janë evidentuar dy raste të shprehura në aktkonstatim “Materiale kancelarie” “Printime për nevojat e AAC-së”. Masa shpërblim dëmi: 3 masa të cilat jeni shprehur në observacion nuk pronohen grupi i auditimit i tillës është shprehur në aktkonstatim. Mbi 10 masa nuk mund të mjaftoheni vetëm me përcaktimin e personave përgjegjës, si dhe nuk mund të justifikoheni vetëm me nxjerrjen e urdhërave për njoftimin e personave për arkëtimin e vlerës.Në kushte të tilla nuk mund të shpreheni nuk pranojmë Rekomandimin sepse është e pamundur të njoftohen personat përgjegjës, sipas zbatimit të Rekomandimeve keni detyrim ligjor të ndiqni të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion në subjekt nuk janëevidentuar këto pretendime, si dhe në observacione nuk është bashkëngjitur ky plan masash të cilin pretendoni. “Masa për eliminimin e efekteve...” 5 masa, së pari shpreheni se grupi i auditimit duhet të vlerësoj jo në proces por e realizuar, më pas nuk e pranojmë Rekomandimin për sa i përket pjesës së vlerës së dëmit. Në observacion nuk mund të shpreheni në dy konkluzione në të cilinbien ndesh me njëra tjetrën, dhe e realizuar dhe nuk pranohet. Konkluzioni në të cilin ka dalë grupi i auditimit shprehet vetëm për dokumentacionin në të cilën keni vendosur në dispozicion.

Pra pretendimet e paraqitura janë të të pa mbështetura në fakte dhe prova .

Sa më sipër observacionet nuk merren parasys.

2. Mbi hartimin dhe realizimin e buxhetit sipas strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe raportimi i tyre.

2.1 Titulli i gjetjes: Formalizëm në miratimin e buxhetit vjetor të AAC.

Situata:Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues nuk kanë bashkëpunuar paraprakisht për studimin e Projekt Programit Ekonomik të vitit 2018 pasi Këshilli Drejtues e ka marrë relacionin e Drejtorit Ekzekutiv për këtë çështje në të njëjtën ditë që edhe e ka aprovuar.**Aneksi nr. 2**

Kriteri:Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar, neni 27, pika 1.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për hartimin e një buxheti jo efektiv, jo optimal dhe mundësinë e ndryshimit të objektivave ekonomiko - financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Shkaku:Mosshqyrtim paraprak për një periudhë të nevojshme të përcaktuar të projekt buxhetit të AAC.

Rëndësia:E lartë.

Rekomandimi:Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masa që të përcaktojnë në Rregulloren e tyre afatin, brenda një date të caktuar, për dorëzimin e Projekt Buxhetit në Këshillin Drejtues, disa ditë përpara se ai të mblidhet për shqyrtimin e tij.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil z. KK.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

2.2 Titulli i gjetjes: Mos arkëtim në buxhetin e shtetit të fitimit të ngelur pas mbylljes së vitit financiar të AAC për vitin 2017 dhe vitin 2018.

Situata: Fondi prej 181,846 mijë lekë i ngurtësuar dhe i mbartur deri në muajin mars 2018 është një tejkallim prej 74,846,000 lekë të ngurtësuar në llogaritë e AAC. Gjithashtu, AAC në llogaritë e saj bankare, ka mbajtur pas muajit mars 2019, në kundërshtim me ligjin, një shumë prej 279,917,654 lekë ose 172,917,654 lekë më shumë sesa shuma e lejuar. **Aneksi nr. 3.**

Kriteri: Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar, neni 18, pika 3.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për shpenzime të jashtëligjshme të këtij fondi nga AAC, kur këto arkëtime i takojnë buxhetit të shtetit, mbas datës 01 prill të vitit pasardhës.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të përcaktuara qartësisht në ligjin e cituar më lart si edhe në Rekomandimet e auditimeve të KLSH.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, pas muajit mars të vitit pasardhës, të arkëtojnë në buxhetin e shtetit shumën e detyrimit ligjor.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil z. KK dhe Drejtori ekonomik z. FG (larguar nga detyra më 30.11.2018) dhe përgjegjësja e sektorit të financës dhe buxhetit (në detyrë nga shtatori i vitit 2018).

Observacion i AAC:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, Drejtor Ekzekutiv i AAC dhe znj. ED, përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr.2047/10 dhe 2047/21 datë 15/11/2019 kërkohet të pranohet si i drejtë mbajtja e fondit rezervë të trajtuar në gjetjet më sipër numër 2 dhe 3 të trajtuara tek Akt konstatimi numër 6 i KLSH i protokolluar në AAC me numër 2023/6 datë 08.11.2019. Në të dyja këto observacione pretendohet në mënyrë të pa argumentuar se mbajtja e këtij fondi rezervështë e justifikuar dhe e mbështetur në vendime të KD.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Së pari, në observacion nuk ka dokumenta shtesë që të vërtetojnë se shumata e mbajtura si fond rezervë në numrat e llogarive të AAC janë kryer mbi vendime të tjera të KD, përveç një vendimi të cituar në gjetjet 2 dhe 3 për Vendimin e KD nr. 80 datë 21.12.2017 me nr. Prot. 352 datë 21.12.2017 në pikën 2 të Programit ku thuhet: “Krijimin dhe mbajtjen e një fondi rezervë për vitin 2018 në shumën 107,000,000 lekë...”

Së dyti, edhe ky vendim i KD nuk është i mbështetur në ndonjë ligj dhe KD nuk ka kompetencë të caktojë shumata për fond rezervë të AAC pasi këtë e ka përcaktuar Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, neni 18, pika 3, ku cilësohet shprehimisht se: “3. Veprimtaria e Autoritetit financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai. Të ardhurat e realizuara, por të pashpërndara në fund të vitit të parë buxhetor të veprimtarisë, mbarten për vitin pasardhës dhe reflektohen në nivelin e tarifave. Në vitet në vazhdim, të ardhurat e realizuara e të papërdorura, deri në fund të vitit, mbarten e përdoren për shpenzime të angazhuara deri për një periudhë 3-mujore të vitit pasardhës e më pas derdhen në Buxhetin e Shtetit”.

AAC e ka shkelur këtë kërkesë të paekuivok të Ligjit “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” për të ardhurat e vitit 2017 duke mos i derdhur në buxhetin e shtetit fitimet e ngelura gjatë gjithë vitit 2018 dhe fitimet e realizuara gjatë vitit 2018 nuk i kanë derdhur ende gjatë gjithë periudhës së



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

auditimit në vitin 2019. Duhet theksuar fakti se KD nuk ka asnjë kopetencë të caktojë mbajtjen e ndonjë fondi rezervë në llogaritë e AAC.

Në observacion ka kontradiktë sepse, ndërsa kundërshtohet ky konstatim i grupit të auditimit, nga ana tjetër thuhet se AAC i ka kërkuar KD të marrë një vendim për transferimin e kapitalit financiar qëështë i arkëtuar në numrat e llogarive të Autoritetit në thesarin e shtetit. AAC nuk ka nevojë për një vendim të KD pasi ligji e përcakton qartë se si duhet vepruar. Njëkohësisht, grupi i auditimit gjatë punës së tij bazohet vetëm tek zbatimi i ligjeve të shtetit shqiptar dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe jo nga kërkesat e ndonjë institucioni ndërkombëtar në marrëdhënie me AAC, sic është pretenduar në observacion për Eurocontrol-in. Nëse kjo është e nevojshme, AAC dhe MIE duhet të amendojnë dhe harmonizojnë ligjin e AAC me kërkesat e Eurocontrol.

Pra, si rrjedhojë e arsytimit më lart, ky observacion i AAC mbi këtë çështje nuk do të merret parasysh nga grupi i auditimit të KLSH.

3. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, Bordit të Administrimit e Këshillit Drejtues si edhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.

3.1 Gjetje nga auditimi: Likuidimi nga AAC në vlerëne 152,600 Euro, për llogari të konsulentit “RB” GMBH, në zbatim të kontratës për shërbime konsulence të nënshkruar midis Shtetit Shqiptar dhe Kompanisë Konsulente në datën 28.04.2018.

Situata: Nga Auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me likuidimet e kryera nga AAC në llogari të Konsulentit “RB” GMBH, u konstatua:

a). Likuidimi i vlerës së paradhënies prej 76,300 Euro sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 10.08.2018 sipas urdhër xhirimit të Union Bank. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura mban firmën e Konsulentit, ka të specifikuar arsyen e pagesës “Paradhënie” dhe vlerën e saj prej 76,300 Euro.

b). Likuidimi i vlerës së dytë prej 76,300 Euro, pagesë finale sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 25.07.2019 sipas urdhër xhirimit të BKT. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura për pagesën finale, është e njëjtë me faturën për pagesën e paradhënies. Pra, nuk vërtetohet se operatori e ka lëshuar faturën finale pasi ka përfunduar kryerjen e shërbimit. Nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë shërbimet e kryera nga Konsulenti në përputhje me pikën 6.1 të kontratës së lidhur. Si rezultat, vlera e investuar nga AAC prej **152,600 euro**, nuk është e justifikuar me dokumenta dhe fakte sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. **Aneksi nr. 4.**

Kriteri:

a). Kontrata bazë, me datë 28.04.2018, midis MIE dhe “RB” GMBH;

a1). Neni 6, Pagesat e Konsulentëve, pika 6.1, Shpërblimi i Shërbimit të Konsulencës;

a2). Neni 1.6, tarifa fikse do të paguhet sipas kësteve, pika 2;

b). VKM nr. 914, me ndryshime, neni 37, shërbimet e konsulencës, pika 4, gërma a).

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për kryerjen e likuidimeve për llogari të Konsulentëve pa u vërtetuar kryerja e shërbimit.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të LPP-së dhe kushteve të kontratës.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithëshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e investuar nga AAC dhe të përfituar nga operatori ekonomik “RB” GMBH, dhe vetëm nëse nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës, të konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 152,600 Euro nga operatori ekonomik “RB” GMBH, si vlerë që i përket zërave të pa argumentuar në kundërshtim me nenin 6.1 të kontratës së lidhur.

Rekomandimi 2: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori Financës dhe Buxhetit, të marrin masat që në të ardhmen, përpara kryerjes së pagesave për “Shërbimet e Konsulencës”, të plotësojnë dokumentacionin financiar sipas kriterëve të vendosura në DST dhe kontratë duke dokumentuar shpenzimet e drejtpërdrejta dhe ato të rimbursueshme, konform grafikut të miratuar.

Afati: Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/14, datë 15.11.2019, protokolluar pranë AAC, ku:

Tek paragrafi i tretë, pretendohet se: “AAC është autorizuar nga MIE për kryerjen e pagesave.....dhe jo për të konfirmuar punën e tij”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në akt-konstatimin e mbajtur nga grupi i auditimit, janë të cilësuara të gjitha shkresat që kanë lidhje me konstatimin e gjetjes. Një nga shkresat që vlen të përmendet në këtë përgjigje të observacionit tuaj, është ajo me nr. 8607/1 prot., datë 20.06.2018 MIE dhe nr. 1167 prot., datë 21.06.2018 AAC. Bashkangjitur kësaj shkrese, MIE ju dërgon: **Kontratën bazëbashkë me atë shtesë.**

3.2 Gjetje nga auditimi: Nënshkrimi i kontratës së qirasë midis AAC dhe TBP, me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018 dhe pagesa e garancisë deri në marrjen në dorëzim të ambienteve nga AAC, në vlerën e 20,252.96 Euro, në kundërshtim me interesat ekonomik të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurën e marrjes me qira të ambienteve tek TBP, u konstatua se:

1. AAC me përfaqësues z. KK, dhe TBP me përfaqësues znj. SA, kanë nënshkruar një kontratë për marrje ambienteve me qira në total 973.7 metra katror (sipërfaqe bruto) sipas nenit 1.1.1 të kontratës me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018;

2. Në vazhdim është shkresa me nr. 74 prot., datë 13.06.2019 TBP dhe nr. 1176 prot., datë 17.06.2019 AAC, Propozim për zgjidhjen e kontratës së qirasë datë 19.11.2018, ku TBP propozon që të zgjidhet kontrata me mirëkuptim duke mbajtur vetëm pagesën e garancisë që është depozituar nga AAC me lidhjen e kontratës.

3. Me shkresën me nr. 1176/1 prot., datë 18.06.2019 AAC i kërkon takim TBP-së për të negociuar kushtet e zgjidhjes së kontratës. Me shkresën nr. 1176/2 prot., datë 21.06.2019, janë dokumentuar minutat e takimit lidhur me negociimin e zgjidhjes së kontratës nga ku bihet dakord që nga qiramarrësi të mbahet vlera e garancisë e paguar nga AAC në datën e lidhjes së kontratës së qirasë, prej 20,252.96 Euro.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

-Sa më sipër, referuar gjetjeve dhe konkluzioneve të grupit të auditimit, vlera e likuiduar nga AAC, në favor të TBP prej 20,252,96 Euro, konsiderohet dëm ekonomik për AAC/Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga personat përgjegjës të cilët kanë vepruar në kundërshtim me interesat ekonomike të institucionit. Aneksi nr. 5.

Kriteri: Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010, Për Autoritetin e Aviacionit Civil, i ndryshuar, Neni 3, Statusi i Autoritetit, Neni 17, Të ardhurat e AAC, pika 5 dhe Neni 20, Raportimi nga AAC, pika 2.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për mos respektim të hierarkisë në marrjen e vendimeve nga AAC.

Shkaku: Mosrespektim i ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 për AAC.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Ministri i Industrisë dhe Energjisë, Këshilli Drejtues i Autoritetit të Aviacionit Civil, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithëshme, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masat për të analizuar shkaqet dhe personat përgjegjës për dëmin ekonomik që i kanë sjellë AAC/Buxhetit të Shtetit dhe në vazhdim, nga personat përgjegjës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 20,252,96 Euro, vlerë e konsideruar dëm ekonomik dhe që i përket garancisë të likuiduar nga AAC në favor të TBP.**

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/14, datë 15.11.2019, protokolluar pranë AAC, ku:

Tek paragrafi i dhjetë, pretendohet se: “...Në këtë gjetje janë përdorur **koncepte të gabuara të referencimit në përdorimin e citimeve me thonjëza, ku në bazë të rregullave të drejtshkrimit ato duhet të përmbajnë vetëm përmbajtjen e ekstraktit të dokumentit....**”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në akt-konstatimin e mbajtur nga grupi i auditimit, të gjitha gjetjet dhe konkluzionet, bazohen në evidencat e marra nga AAC. Ju në këtë observacion, nuk keni paraqitur asnjë dokument ligjor apo fakt të ri bashkangjitur observacionit. Nuk merren në konsideratë pretendimet tuaja verbale edhe pse të printuara në shkresë zyrtare që në vetvete përbëjnë një relacion dhe vetëm mendime personale pa asnjë dokumentacion ligjor bashkangjitur. Grupi i auditimit, ka audituar Autoritetin e Aviacionit Civil bazuar në legjislacionin në fuqi (referuar bazës ligjore të programit të auditimit) duke dhënë edhe opinione apo cilësuar shprehjet e relacioneve tuaja si institucion që në thelb kanë vetëm kuptimin e fjalive të përdorura bazuar në dokumentacionin që ju si institucion keni vënë në dispozicion të grupit të auditimit.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga znj. AP, është paraqitur observacioni me nr. 2047/28, datë 15.11.2019, protokolluar pranë AAC, ku:

Tek paragrafi i tretë, pretendohet se: “...sqaroj se konstatimi i audituesit, është i pasaktë dhe i bazuar në mungesë evidencash përsa kohë gjatë periudhës së auditimit **nuk ka kërkuar asnjë informacion për çështjen në fjalë....**”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në akt-konstatimin e mbajtur nga grupi i auditimit, të gjitha gjetjet dhe konkluzionet, bazohen në evidencat e marra nga AAC. Shkresa që keni paraqitur bashkangjitur observacionit, është e përshtetur shumë qartë në akt-konstatim duke cilësuar edhe shprehje të përdorura në materialet



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

që na janë vënë në dispozicion si grup auditimi. Informacioni që na është dhënë nga ana juaj, është i përshkruar në akt-konstatim me numër protokollit, me datë, me objekt duke evidentuar edhe fraza ose fjali nga relacionet tuaja, pikërisht për mos të krijuar keqkuptime në interpretim dhe për ta bërë akt-konstatimin të mbështetur në prova dhe fakte shkresore. Pretendimi juaj se nuk kemi kërkuar asnjë informacion për çështjen në fjalë, nuk është i saktë, pasi nëse nuk do kishim kërkuar informacion, nuk do të cilësonim aktet apo shkresat tuaja tek akt-konstatimi i mbajtur nga grupi i auditimit. Për më tepër, observacioni juaj, tek i cili përcaktoni se: “.....Gjithsesi, bashkalidhur gjeni VKD nr. 18, datë 07.11.2018 dhe relacionin përkatës”, konstatohet se nuk ka prova të reja ose fakte që nuk janë trajtuar në akt-konstatim. Relacioni që keni sjellë bashkangjitur observacionit, është pikërisht ai që është trajtuar në akt-konstatim (si tekst/përmbajtje), pra gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit, janë të bazuara në shkresat/aktet administrative që ju si AAC keni vënë në dispozicion të audituesve. Audituesit, nuk janë të detyruar që gjatë mbajtjes së akt-konstatimit, domosdoshmërisht ti mbajnë ato në prezencë të subjektit që auditohet ose përfaqësuesve të subjektit. Akt-konstatimi është dokument i njëanshëm në të cilin evidentohen shkresërisht se çfarë është konstatuar gjatë auditimit. Si rezultat, gjetja e cilësuar në akt-konstatim, është e bazuar në evidenca të plota dhe pas një gjykimi profesional dhe objektiv. Sa më sipër, observacioni juaj lidhur me këtë çështje, është i pa bazuar në prova dhe fakte ligjore e si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Projekt-Raporti.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. BH, është paraqitur observacioni me nr. 2047/1, datë 13.11.2019, protokolluar pranë AAC, kuptohet se:

“...Nuk i përkas sektorit të prokurimeve....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Observacioni juaj për këtë pikë, merret në konsideratë duke ju shkarkuar nga përgjegjësia.

Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve.

4.1 Titulli i gjetjes: Paqartësi ligjore në lidhje me nivelin e pagave në AAC.

Situata: Në Ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010 i ndryshuar, “Për Aviacionin Civil”, konstatohet se ka paqartësi mbi çështjen e nivelit të pagave për arsye se AAC e ka vetë kompetencën e vendosjes së nivelit të tyre, ndërsa marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me legjislacionin e shërbimit civil. Nga kjo ka rezultuar që niveli i pagave të AAC është i lartë, krahasuar me nivelin e pagave të institucioneve të tjera që përfshihen në legjislacionin e shërbimit civil. **Aneksi nr. 6.**

Kriteri: Ligji nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” me gjithë ndryshimet përkatëse dhe pika 2 e nenit 16, të Ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, neni 7/h, neni 34/2 i ligjit nr. 152, “Për nëpunësin civil”, datë 26.02.2013.

Ndikimi: Jep efekt negativ në financat e shtetit duke qenë i zbalancuar me pagat e pjesës tjetër të administratës që gëzon statusin e nëpunësit civil.

Shkaku: Tejkallim i nivelit të pagave referuar trajtimit të ligjit nr. 152, “Për nëpunësin civil”, datë 26.02.2013.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masat që në të ardhmen, të propozojnë ndryshime ligjore, me qëllim përshtatjen e nivelit të pagave të punonjësve



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

të AAC me nivelin e pagave të punonjësve të institucioneve të tjera të ngjashme me AAC, konform me ligjin nr. 152, datë 26.02.2013 “Për nëpunësit civil”, ose të përshtaten në ligjin funksional të AAC-së.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, KK.

4.2 Titulli i gjetjes: Punonjës për të cilët Akti i Deklarimit të Statusit është i parregullt.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se janë 3 punonjës për të cilët Akti i Deklarimit të Statusit është i parregullt, në pozicionet e organigramës së AAC për të cilët duhet të revokohet akti i deklarimit të punësimit dhe konkretisht:

Nr.Emërtimi sipas organikës

- 1.Specialist në Sektorin e Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë.
- 2.Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore.
- 3.Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë.

Kriteri: Ligji nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” me gjithë ndryshimet përkatëse dhe pika 2 e nenit 16, të Ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, neni 7/h, neni 34/2 i ligjit nr. 152, “Për nëpunësin civil”, datë 26.02.2013.

Ndikimi: Është një shembull i keq se si mund të shkelet ligji i rekrutimit të punonjësve dhe ndikon negativisht në veprimtarinë e pjesës tjetër të administratës së AAC.

Shkaku: Mosveprim i KD dhe drejtorisë së AAC, sipas kërkesave ligjore të përmendura më lart.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat, që në të ardhmen, për të gjitha rastet, të revokohet akti i mëparshëm i deklarimit të statusit të punësimit dhe të nxirret akti i deklarimit të punësimit si Nëpunës Civil në periudhë prove.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, KK dhe drejtori i drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, SR.

4.3 Titulli i gjetjes: Ndryshimi i strukturës pa miratim.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën e auditimit 01.01.2018- 31.08.2019, u konstatuan 2 raste të ndryshimit të strukturës, respektivisht me 69 dhe 73 punonjës. Ndërsa para shkurtit të vitit 2018 në strukturën e AAC ka pasur 83 punonjës me organigramë duke tejkuluar në mënyrë të parregullt me 17 punonjës numrin e përcaktuar me VKM nr.100 datë 26.02.2014. Nuk ka relacione shpjeguese se përse bëhen këto ndryshime strukturore në numër dhe në përmbajtje. **Aneksi nr. 7.**

Kriteri: VKM nr. 893, datë 17.12.2014, neni 30 ku cilësohet:

Ndikimi: Mund të ndikojë në administratë dhe të shkaktojë shpenzime të pakontrolluara.

Shkaku: Mosveprim i drejtorisë së AAC, sipas kërkesave ligjore të përmendura më lart.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa, që në të ardhmen, të kërkojnë miratimin e strukturës nga Departamenti i Administratës Publike dhe nga Ministria e Financave.

Afati: Në vazhdimësi.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, KK.

Observacion i AAC:

Prendimi i subjektit: Në observacionin nr. 20147/11 datë 15.11.2019, nga z. KK, Drejtor Ekzekutiv i AAC pretendohet se në lidhje me strukturën e ndryshuar dy herë në AAC gjatë periudhës 20 mujore të auditimit janë marrë të gjitha miratimet e nevojshme ligjore dhe janë plotësuar të gjitha kushtet për ndërmarjen e ristrukturimi, duke cituar dhe bashkëlidhur këtëj observacioni edhe një fotokopje relacion të firmosur nga z. KK me numër protokollit të AAC 2256/1 datë 27.12.2018 “Relacion mbi strukturën organizative të Autoritetit të Aviacionit Civil”, ku nuk kuptohet se kujt i drejtohet. Gjithashtu, në këtëj observacion kundërshtohet citimi i grupit të auditimit në ligj, mbi nevojën e miratimit të ndryshimit të strukturës edhe nga DAP dhe Ministri i Ekonomisë e Financave.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit e pranon **pjesërisht** këtëj observacion të AAC për pjesën e komunikimit të saj me KD dhe Ministrin e linjës për nevojën e ristrukturimit të Autoriteti por i qëndron pjesës tjetër të konstatimit që kjo strukturë e re duhej të miratohej edhe nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, bazuar tek VKM nr. 893, datë 17.12.2014, neni 30 ku cilësohet se “Ndërtimi i strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore përgatitet për Kryeministrin nga Departamenti i Administratës Publike, në bazë të propozimit të marrë nga ministri propozues. Në rastet kur, mbështetur në një ligj të veçantë, struktura organizative miratohet nga një organ tjetër, merret në mënyrë të detyrueshme mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe i Ministrisë së Financave.”

Gjithashtu prej grupit të auditimit, nga ky observacion pranohet heqja e përgjegjësisë së Drejtorit Ekzekutiv të Aviacionit Civil z. KK në pjesën e trajtimit financiar, në Akt konstatimin nr. 7, nga ana e AAC të shpenzimeve të përgjithshme për Aeroportin e Kukësit për periudhën 20 mujore të auditimit.

Pikat e tjera të këtëj observacioni nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.

4.4 Titulli i gjetjes: Rritje e shpenzimeve të AAC nga shlyerjet e titujve ekzekutivë.

Situata: AAC ka shpenzuar nga humbja e proceseve gjyqësore në total për periudhën 20 mujore të auditimit, **6,112,547 lekë** gjithësej, të ndarë në dy periudhat e ndryshme vjetore përkatësisht në **528,396 lekë** (viti 2018) dhe **5,584,151 lekë** (8 muajt e parë të vitit 2019). **Aneksi nr. 8.**

Kriteri: Neni 31, 32, i K.Pr.Civile, nenet 12,141,143, 144, 145, 155 të Kodit të Punës, neni 109 K.Pr.A, Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar.

Ndikimi: Rrit shpenzimet dhe detyrimet e AAC duke ulur fitimin e Autoritetit.

Shkaku: Mosveprim i drejtorisë së AAC, sipas kërkesave dhe standarteve të përcaktuara në ligj për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me punonjësit e larguar.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa, që në të ardhmen të mos i shkaktojnë Autoritetit efekte negative financiare nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës me punonjësit, prej mos respektimit të të gjitha kriterëve ligjore në fuqi.

Afati: Në vazhdimësi.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil z. KK.

4.5 Titulli i gjetjes: Rregullorja e pa përditësuar.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit dhe Rregulloreve me të cilat ka funksionuar AAC, u konstatua se Autoriteti nuk i ka pasqyruar (deri në miratimin e Rregullores në fuqi në datën 12.06.2019 në këtë dokument) ndryshimet strukturore të realizuara pas 2 vendimeve përkatëse të KD dhe Ministrisë të MIE. Nga auditimi u konstatua se ndërhyrja në Rregulloren e parë nuk ishte bërë në harmonizim me strukturën e saj, duke përshtatur në disa raste vetëm përshkrimin e vendit të ri në strukturë tek Aneksat, pa respektuar hierarkinë e ligjit për të përshtatur së pari Rregulloren dhe pastaj anekset e saj. **Aneksi nr. 9.**

Kriteri: Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar, neni 27, pika 1.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për shmangie nga detyrat e punonjësve të pa përcaktuar në Rregulloren e brendshme ose mbivendosje të detyrimeve dhe përgjegjësi të tyre.

Shkaku: Mosveprim i drejtorisë së AAC, sipas kërkesave dhe standarteve për përgatitjen e Rregullores dhe pastaj të anekseve të saj, sa herë që ndryshon struktura e Autoritetit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masa që në të ardhmen, para se të miratojnë e zbatojnë një strukturë të re duhet të përshtatin Rregulloren e brendshme me vendet e reja në organigramë.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Këshilli Drejtues i AAC dhe Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, z. KK.

4.6 Titulli i gjetjes: Shpërblime të parregullta.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se AAC ka dhënë për periudhën e auditimit dy shpërblime të vecanta për punonjësit e saj, përkatësisht një në dhjetor të vitit 2018, në vlerën 7,487,204 lekë dhe në vitin 2019 ka pasur një shpërblim në vlerën 7,147,932 lekë. Për të gjithë periudhën e auditimit vlera totale e shpërblimeve llogaritet në vlerën 14,995,136 lekë. Këto shpërblime janë paguar vetëm me urdhra të brendshëm të Drejtorit Ekzekutiv, pa marrëmiratim nga Këshilli Drejtues dhe as nga Ministri, si dhe janë përballuar nga fondi i mbetur iplanifikuar i zërit “Shpërblime personeli”.

Kriteri: Ligji nr. 10233 nenin 18, pika 3, datë 11.2.2010, Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 4, pika 2, gërma c, nenin 6, pika 2.

Ndikimi: Dëmton buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mosveprim i drejtorisë së AAC, sipas kërkesave dhe standarteve në zbatim të disiplinës financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në dhënien e shpërblimeve të veçanta punonjësve, të marrin paraprakisht miratimin nga Këshilli Drejtues dhe Ministri i MIE.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, KK si edhe hartuesja e relacionit për të dy rastet e shpërblimeve znj. SR.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Observacion i AAC:

Pretendimi i subjektit: Nga znj. SR, Drejtor Drejtorie i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në AAC ka sjellë observacionin me numër 2047/23 ku kundërshton pikën 4/2 të Akt konstatimit nr. 7 të grupit të auditimit të KLSH ku pretendon për pasaktësi në lidhje me konstatimin mbi çështjen e shpërblimeve të trajtuara më lart në Gjetjen nr. 9. Ajo pretendon se shpërblimet janë miratuar nga KD me Vendimin nr. 62, datë 21.11.2016.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Ky observacion nuk merret parasysh nga grupi i auditimit pasi nuk sillen fakte të dokumentuara të reja, veç fakteve të cituara edhe në Akt konstatimin nr. 7 pika 4/2. Në këtë observacion nuk ka ndonjë document ku të vërtetohet se shpërblimet janë miratuar paraprakisht edhe nga ministri i MIE-s siç parashikon edhe Ligji nr. 10233 nenin 18, pika 3, datë 11.2.2010, Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 4, pika 2, gërma c, nenin 6, pika 2, ku cilësohet se: - “1. Organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: b) masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.”, ashtu sic janë shpjeguar edhe më hollësisht më lart tek pika Kriteri.

4.7 Titulli i gjetjes: Mospërfshirje në skemën për sigurimin suplementar të punonjësve të Aeroportit të Kukësit.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i listpagesave të vëna në dispozicion nga sektori i financës së AAC, rezultoi se për Drejtuesin dhe punonjësit e Aeroportit të Kukësit, nuk janë paguar kontributet për sigurimin suplementar për periudhën objekt auditimi.

Kriteri:

-Ligji nr.10233, datë 11.2.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, i ndryshuar;

-Ligji nr, 104/2014, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

-VKM 343 datë 04.6.2006 neni 1 dhe 2;

-Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave nr.2127/4, datë 07.7.2014, “Për administrimin e Aeroportit të Kukësit”;

-Rregulloren “Për pensionet vullnetare të punëdhënësit”, miratuar me vendimin nr. 57, datë 03.08.2016.

Ndikimi: Mos likuidimi i kontributeve suplementare të punonjësve.

Shkaku:Mostrajtim i barabartë midis punonjësve.

Rëndësia:E ulët.

Rekomandimi:Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të shqyrtojnë të gjitha rastet e mos përfshirjes në skemën e kontributeve për sigurimin suplementar të punonjësve duke i përfshirë ata sipas rastit në këtë skemë, si dhe të marrë masat për derdhjen e këtyre kontributeve të munguara.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Këshilli Drejtues i Autoritetit të Aviacionit Civil.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Observacion i AAC:

Pretendimi i subjektit: Nga znj. SR, Drejtor Drejtorie i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në AAC ka sjellë observacionin me numër 2047/23 ku kundërshton pikën 4/2 të Akt konstatimit nr. 7 të grupit të auditimit të KLSH ku pretendon për pasaktësi në lidhje me konstatimin mbi çështjen e shpërblimeve të trajtuara më lart në Gjetjen nr. 9. Ajo pretendon se shpërblimet janë miratuar nga KD me Vendimin nr. 62, datë 21.11.2016.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Ky observacion nuk merret parasysh nga grupi i auditimit pasi nuk sillen fakte të dokumentuara të reja, veç fakteve të cituara edhe në Akt konstatimin nr. 7 pika 4/2. Në këtë observacion nuk ka ndonjë dokument ku të vërtetohet se shpërblimet janë miratuar paraprakisht edhe nga ministri i MIE-s siç parashikon edhe Ligji nr. 10233 nenin 18, pika 3, datë 11.2.2010, Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 4, pika 2, gërma c, nenin 6, pika 2, ku cilësohet se: - “1. Organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: b) masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.”, ashtu sic janë shpjeguar edhe më hollësisht më lart tek pika Kriteri.

5 Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

5.1 Titulli i Gjetjes: Mos derdhje e të ardhurave në buxhetin e Shtetit.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare rezultoi se, fitimi neto i vitit 2018 paraqitet në shumën 98,071,375 lekë dhe fitimi i vitit të mëparshëm paraqitet në shumën 51,189,279 lekë. Këto të ardhura në vlerën totale 149,260,654 lekë përbëjnë tepricat e mbetura në fund të viteve buxhetore, të cilat duhet të derdheshin në Buxhetin e Shtetit. Në lidhje me këtë konstatim, nga strukturat drejtuese të AAC, nuk janë marrë masa për kalimin e këtyre fondeve për llogari të Buxhetit të Shtetit, duke i mbajtur ato në llogari rrjedhëse të institucionit, në bankat e nivelit të dytë.

Kriteri: Ligji nr. 10233, datë 11.0.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, neni 18, pika 3.

Ndikimi: Të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën 149,260,654 lekë.

Shkaku: Mos respektim nga Drejtimi Institucional, në zbatimin e dispozitës ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa, për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të **shumës prej 149,260,654 lekë**, të konstatuara të pa derdhura për vitin 2017 dhe vitin 2018. Gjithashtu nga AAC të merren masa për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të detyrimeve të mbajtura në llogari të institucionit, që janë jo vetëm të periudhës së auditimit por, të akumuluar nga vitet e mëparshme të cilat sëbashku me vlerën e mësipërme në total shkojnë në shumën **279,917,654 lekë**.

Afati: Menjëherë.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e AAC z.KK.

Observacion i AAC:

Pretendimi i subjektit: Nga znj. SR, Drejtor Drejtorie i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në AAC ka sjellë observacionin me numër 2047/23 ku kundërshton pikën 4/2 të Akt konstatimit nr. 7 të grupit të auditimit të KLSH ku pretendon për pasaktësi në lidhje me konstatimin mbi çështjen e shpërblimeve të trajtuara më lart në Gjetjen nr. 9. Ajo pretendon se shpërblimet janë miratuar nga KD me Vendimin nr. 62, datë 21.11.2016.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Ky observacion nuk merret parasysh nga grupi i auditimit pasi nuk sillen fakte të dokumentuara të reja, veç fakteve të cituara edhe në Akt konstatimin nr. 7 pika 4/2. Në këtë observacion nuk ka ndonjë dokument ku të vërtetohet se shpërblimet janë miratuar paraprakisht edhe nga ministri i MIE-s siç parashikon edhe Ligji nr. 10233 nenin 18, pika 3, datë 11.2.2010, Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 4, pika 2, gërma c, nenin 6, pika 2, ku cilësohet se: - “1. Organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: b) masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.”, ashtu sic janë shpjeguar edhe më hollësisht më lart tek pika Kriteri.

5.2 Titulli i Gjetjes: Kryerja e inventarit të aktiveve të Aeroportit Kukës pa vlerësim kontabël.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit rezultoi se inventarizimi i Aeroportit të Kukësit për vitin 2018 është bërë në funksion të anës sasiore pa vlerat kontabël përkatëse. Sikurse është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme, përsëri rezulton se nuk është kryer asnjëherë një vlerësim i aseteve të tij, edhe pas relacionit të hartuar nga komisioni përkatës i cili ka kryer procesin e inventarizimit, nga titullari i AAC nuk ka asnjë vendimmarrje për vlerësimin e tyre.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, neni 57.

Ndikimi: Paraqitje jo e saktë dhe e besueshme e gjendjes së aktiveve të AAC.

Shkaku: Mos zbatim i kompetencave nga ana e titullarit për vlerësimin e aktiveve në dispozicion.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masat e duhura që aktivet e Aeroportit të Kukësit, të vlerësohen dhe të evidentohen me vlerën e duhur në kontabilitet në të ardhmen pasi, aktualisht ky aeroport është dhënë me konçension.

Afati: Në vazhdimësi.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e AAC z.KK, ish-përgjegjësin dhe përgjegjësin e sektorit të financës dhe buxhetit, z.FG e znj.ED.

5.3 Titulli i Gjetjes: Nuk ka regjistër kontabël të aktiveve të përditësuar.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare për vitin 2018, rezulton se Autoriteti i Aviacionit Civil, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, i cili në varësi të llojit të përmbajë kërkesat minimale si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit,



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33.

Ndikimi: Paraqitje jo e plotë e pozicionit financiar.

Shkaku: Kjo vjen si pasojë e respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi, nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Buxhetit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masat e duhura për krijimin dhe përditësimin e regjistrit të aktiveve të AAC, në përputhje me kuadrin regullativ ligjor.

Afati: Në vazhdimësi.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e AAC z.KK, ish-përgjegjës dhe përgjegjës të sektorit të financës dhe buxhetit, z.FG e znj.ED.

5.4 Titulli i Gjetjes: Është krijuar komision për inventarizimin e aktiveve në kushtet e konfliktit të interesit.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të kryerjes së procesit të inventarizimit për vitin 2018, rezultoi se, në komisionin e ngritur nga Titullari i AAC në cilësinë e nëpunësit Autorizues, janë caktuar persona të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë nënshkruar në procesin e kryerjes së inventarizimit, në kushtet e konfliktit të interesit.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 81-82.

Ndikimi: Cënim i paanshmërisë së procesit të inventarizimit.

Shkaku: Mosnjohje e legjislacionit nga titullari dhe punonjësit që kanë marrë pjesë në procesin e inventarizimit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në procesin e inventarizimit, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, përbërja e komisioneve të jetë në përputhje me kuadrin regullativ ligjor.

Afati: Në vazhdimësi.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e AAC z.KK.

5.5 Titulli i Gjetjes: Mos plotësim i formateve të pasqyrave financiare.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare për vitin 2018, konstatohet se, mungon formati i pasqyrës nr. 5 relacioni dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare. Mungojnë tërësisht shpjegimet dhe analiza e pasqyrës së flukseve monetare, gjithashtu mungojnë pasqyrat statistikore nr. 1, për investimet dhe burimet e financimit, pasqyra nr. 2/1, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), pasqyra nr. 2/2, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), pasqyra statistikore nr. 3, numri i punonjësve dhe fondi i pagave si dhe shënimet shpjeguese të këtyre pasqyrave.

Kriteri:

-Ligji nr. 10233, datë 11.0.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, nenin 19;

-Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 1 “Kudri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare”, pika 67;



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kreu III, pika 25, Aneksi 2.

Ndikimi: Strukturat drejtuese nuk kanë marrë shpjegimet e duhura në lidhje me ndryshimet e zërave të pasqyrave financiare.

Shkaku: Kjo vjen si pasojë emos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masat që, gjatë hartimit të pasqyrave financiare, ato të përfshijnë të gjitha formatet e tyre sipas përcaktimeve ligjore, duke siguruar të dhëna dhe informacione të plota shpjeguese për përdoruesit e tyre.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi znj.ED në cilësinë e përgjegjës të sektorit të financës dhe buxhetit.

5.6 Titulli i Gjetjes: Nuk ka procedurë për vlerësimin dhe ndikimin që kanë në mjedis, të materialeve elektronike që janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe nuk dokumentohet mënyra e asgjësimit të tyre.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me aktivet e nxjerra jashtë përdorimit dhe asgjësimit të tyre, u konstatua se në përbërje të listës së aktiveve të cilat rezultojnë që nuk janë në përdorim dhe që duhet të dalin nga regjistri i aktiveve të Institucionit, ka materiale elektronike të cilat konsiderohen të dëmshme dhe nuk duhet të hidheshin apo të asgjësoheshin, pa një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre, me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuar për asgjësim, si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga Titullari i AAC nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre, nuk ka asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe grososjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet. ***Aneksi nr. 10.***

Kriteri:

-Ligji nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 19.12.2012, “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, kreu I, pika 1 dhe pika 2.;

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

-Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 35 dhe 36.

Ndikimi: Ndikim negativ në përmirësimin e cilësisë së performancës mjedisore.

Shkaku: Mos njohje e legjislacionit nga Drejtori Ekzekutiv dhe strukturat mbështetëse.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa në të ardhmen që, në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve, të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit, gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi titullari i AAC në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe nëpunësin zbatues të AAC.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Observacion i AAC:

Pretendimi i subjektit: Nga znj. SR, Drejtor Drejtorie i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në AAC ka sjellë observacionin me numër 2047/23 ku kundërshton pikën 4/2 të Akt konstatimit nr. 7 të grupit të auditimit të KLSH ku pretendon për pasaktësi në lidhje me konstatimin mbi çështjen e shpërblimeve të trajtuara më lart në Gjetjen nr. 9. Ajo pretendon se shpërblimet janë miratuar nga KD me Vendimin nr. 62, datë 21.11.2016.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Ky observacion nuk merret parasysh nga grupi i auditimit pasi nuk sillen fakte të dokumentuara të reja, veç fakteve të cituara edhe në Akt konstatimit nr. 7 pika 4/2. Në këtë observacion nuk ka ndonjë dokument ku të vërtetohet se shpërblimet janë miratuar paraprakisht edhe nga ministri i MIE-s siç parashikon edhe Ligji nr. 10233 nenin 18, pika 3, datë 11.2.2010, Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 4, pika 2, gërma c, nenin 6, pika 2, ku cilësohet se: - “1. Organet kolegjiale drejtuese të njësisë të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: b) masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.”, ashtu sic janë shpjeguar edhe më hollësisht më lart tek pika Kriteri.

5.7 Titulli i Gjetjes: Transferime kapitale pa aktet e konfirmimit nga institucioni marrës.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të transferimeve kapitale të AAC, konstatohet se: Janë kryer dy transferime kapitale (automjete), konkretisht automjeti me nr. TMBAG6NE1E0161696 të shasisë, ngjyra e zezë, viti i prodhimit 2014, me kapacitet 4+1 vende, me targë AA415IZ, me vlerë kontabël 3,214,800 lekë i cili është transferuar në Institucionin e Avokatit të Shtetit dhe automjeti menr. TMBA6NEXE0162829 të shasisë me targë AA527IZ me ngjyrë të zezë, vit prodhimi 2014, me naftë, me kapacitet 4+1 vende, me vlerë kontabël 3,214,800 lekë. Në të dy rastet për transferimin kapital të automjeteve, rezulton se, në dosjet e transferimit nuk ka akte rrespektive të konfirmimeve, të cilat duhet të bëheshin për dërguesin brenda datës 20 të muajit pasardhës të cilat duhet të nënshkruheshin nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i njësisë pritëse. Gjithashtu nga Organet drejtuese të Autoritetit nuk është kryer ndonjë vlerësim për to, të cilat të jenë konsideruar të panevojshme për kohësisht për njësinë apo të jenë të papërdorshme nga AAC, për më tepër që gjatë vitit 2019 institucioni ka kryer procedurë prokurimi për blerjen e dy automjete të reja.

Kriteri:

-Ligji nr. 10296, datë 10.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

-Urdhri i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35/a/b, pika 36, pika 56 dhe pika 108.

Ndikimi: Nuk ka efekt/ndikim.

Shkaku: Kjo vjen si pasojë emos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në rastet e transferimeve kapitale, të kërkohet dhe plotësohet praktika me dokumentacionin përkatës sipas kuadrit ligjor.

Afati: Në vazhdimësi.

Veprime dhe mosveprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AAC z.KK dhe ED.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Observacion i AAC:

Pretendimi i subjektit: Nga znj. SR, Drejtor Drejtorie i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në AAC ka sjellë observacionin me numër 2047/23 ku kundërshton pikën 4/2 të Akt konstatimit nr. 7 të grupit të auditimit të KLSH ku pretendon për pasaktësi në lidhje me konstatimin mbi çështjen e shpërblimeve të trajtuara më lart në Gjetjen nr. 9. Ajo pretendon se shpërblimet janë miratuar nga KD me Vendimin nr. 62, datë 21.11.2016.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Ky observacion nuk merret parasysh nga grupi i auditimit pasi nuk sillen fakte të dokumentuara të reja, veç fakteve të cituara edhe në Akt konstatimit nr. 7 pika 4/2. Në këtë observacion nuk ka ndonjë dokument ku të vërtetohet se shpërblimet janë miratuar paraprakisht edhe nga ministri i MIE-s siç parashikon edhe Ligji nr. 10233 nenin 18, pika 3, datë 11.2.2010, Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 4, pika 2, gërma c, nenin 6, pika 2, ku cilësohet se: - “1. Organet kolegjiale drejtuese të njësisve të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: b) masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.”, ashtu sic janë shpjeguar edhe më hollësisht më lart tek pika Kriteri.

6 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave.

Për auditimin e kësaj çështje u morrën në shqyrtim praktikat e procedurave të prokurimit, përsa i përket përllogaritjes së nevojave, specifikimeve teknike, fondit limit, kriterëve të kualifikimit, nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, ngritjes së komisioneve dhe mbajtjes së procesverbaleve përkatëse, gjithashtu këqyrja e dokumentacionit të ofertuesve në SPE. Procedurat e prokurimit të audituara, i përkasin periudhës 01.01.2018 deri 31.08.2019 (Afati auditimit).

6.1 “Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO”. Zhvilluar në vitin 2018 me fond limit 6,966,189 lekë pa TVSH.

6.1.1 Gjetje nga auditimi: Dokumentat standarte të procedurës së prokurimit të rishpallur pas anulimit të procedurës së mëparshme, kanë pësuar ndryshime të cilat nuk janë të argumentuara/justifikuara nga njësia e prokurimit.

Situata: Procedura e prokurimit me objekt “Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO”, është iniciuar për herë të parë me urdhrin e prokurimit nr. 698 prot., datë 28.03.2018. Në vazhdim, është anuluar për arsye se 2 (dy) ofertat e ardhura kanë pasur mangësi në dokumentacionin e dorëzuar. Pas anulimit, procedura e prokurimit, me të njëjtin objekt, është rishpallur sipas urdhrin të prokurimit me nr. 1261 prot., datë 05.07.2018. Nga auditimi i dokumentacionit të publikuar në SPE nga AAC, u konstatua se dokumentat standarte të tenderit të shpallur për herë të parë, atë me nr. REF-62681-04-16-2018, nuk janë identike me ato të hedhura në SPE për procedurën e përsëritur (rishpallur) atë me nr. REF-78854-07-11-2018. Njësia e prokurimit, nuk ka dokumentuar arsyet e ndryshimeve të kriterëve të vendosura në DST e



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

procedurës së rishpallur në SPE. Duke mos analizuar shkaqet e anulimit, nuk ka pasqyruar e as justifikuar arsyet e ndryshimeve të kriteve të kualifikimit të bëra në DST.

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, Neni 57, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësitë e prokurimit”, Neni 73, “Mungesa e Konkurrencës”, pika 2.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për përsëritje të procedurave të prokurimit me qëllim shmangien e konkurrencës.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të LPP-së.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, për procedurat e prokurimit të anuluar, të analizojnë shkaqet e dështimit të procedurës së prokurimit duke reflektuar ndryshimet në dokumentat standarte të tenderit, me qëllim rritjen e konkurrencës.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi KS me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga znj. AP dhe z. OA është paraqitur observacioni me nr. 2047/25, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

“...Për periudhën që është zhvilluar kjo procedurë prokurimi nuk kam qenë personi përgjegjës.....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, konkludohet se shkarkoheni nga përgjegjësia duke marrë në konsideratë observacionin tuaj për këtë pikë.

6.1.2 Gjetje nga auditimi: Kualifikim i padrejtë nga KVO i operatorit ekonomik “TC” SHPK.

Situata: Procedura e prokurimit me objekt “Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO”, është iniciuar për herë të dytë me urdhrin e prokurimit nr. 1261 prot., datë 05.07.2018. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik i shpallur fitues “TC” SHPK, u konstatuan mangësi në dokumentacionin e dorëzuar. propozimi teknik i dorëzuar nga operatori ekonomik, nuk është në përputhje me propozimin teknik dhe kushtet e ekzekutimit të kontratës të kërkuara tek DST. Si rrjedhojë, Operatori ekonomik i kualifikuar, duhej të vihej në dijeni nga KVO lidhur me gabimet në ofertën e dhënë me qëllim korrigjimin e tyre ose s’kualifikimin e tij në rast se nuk do të pranonte gabimet në ofertë.

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4, neni 37 “Shërbimet e konsulencës”, pika 4, gërma (gj).

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për kualifikimin e operatorëve ekonomik që nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të LPP-së.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa që në të ardhmen, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, të kualifikojnë vetëm ata Konsulentë, oferta e të cilëve, plotëson kërkesat e ligjit për “Shërbimet e Konsulencës” dhe kriteret e vendosura në DST.

Afati: Në vazhdimësi.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. AS, z. RA dhe z. FN është paraqitur observacioni me nr. 2047/2, datë 13.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

“...Pretendimi për kualifikimin e padrejtë nuk qëndron.....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, konkludohet se veprimet tuaja edhe pse me shkelje administrative, nuk i kanë sjellë institucionit dëme materia e si rrjedhojë ju shkarkoheni nga përgjegjësia personale por jo institucionale. Si rezultat, observacioni juaj për këtë pikë merret në konsideratë në hartimin e këtij projekt-raporti auditimi.

6.1.3 Gjetje nga auditimi: Kryerja e shpenzimit në vlerën e 7,774,200 lekë për procedurën e prokurimit me objekt “Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO për nevojat e AAC”, mund të shmangej pasi AAC këtë detyrë, e kryente prej vitesh me strukturat e saj pa patur nevojë të kryente procedurë prokurimi.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me fillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO për nevojat e AAC”, lloji procedurës “Shërbim Konsulencë”, me fond limit 6,966,189 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se kjo procedurë është iniciuar nga AAC në të njëjtën kohë që institucioni ka pasur struktura të ngritura për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë, të cilat, referuar rregullores së brendëshme me nr. 549 prot., datë 23.04.2013, kanë pasur si detyrë parësore, monitorimin e përmbushjes së vazhdueshme të standarteve të cilësisë ISO. Si rezultat, vlera e investuar për procedurën e prokurimit me objekt “Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO”, prej 7,774,200 lekë, konsiderohet investim me efekt financiar negativ për AAC dhe buxhetin e shtetit dhe një dëm ekonomik i mundshëm në të ardhmen nëse AAC nuk do të përfitojë certifikatën ISO nga institucionet kompetente në momentin e aplikimit.

Kriteri:

-Ligji nr.10233, datë 11.2.2010, Për Autoritetin e Aviacionit Civil, me ndryshime, ku cilësohet:

-Rregullore e brendëshme e AAC nr. 549 prot., datë 23.04.2013, Aneksi I, “Organizimi i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë dhe përshkrimet e punës për drejtorinë dhe sektorët përkatës”.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për investime të pa nevojshme.

Shkaku:Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të ligjit të AAC.

Rëndësia:E lartë.

Rekomandimi:Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë, të bashkëpunojnë me menaxherët e cilësisë dhe organet standardizuese për akreditimin, çertifikimin e institucionit me standardet ISO.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil z. KK.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/12, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

1. “...Pretendimin se këtë standard AAC e kryente prej vitesh nënkupton se AAC duhet të ishte certifikuar minimalisht sipas standardit ISO 9001:2008 por **kjo është e pavërtetë**.....”;
2. “...Cilësimi në akt-konstatim se punonjësit kanë qenë të certifikuar, **është i pavërtetë**...”;
3. “.....**Nuk është i saktë referimi** i bërë mbi përshkrimet e punës në rregullore”;
4. “...dhe në asnjë vend nuk përmendet detyra për certifikimin apo hartimin. Krijimin e një sistemi menaxhimi cilësie”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, në asnjë rresht në aktin e mbajtur nuk është cituar se ju keni detyra dhe përgjegjësi për certifikimin e AAC. Në asnjë rresht të aktit të mbajtur nuk citohet se ju si institucion keni përfituar çertifikatën ISO 9001:2008. Janë jashtë deklaratat tuaja në këtë observacion dhe të pa mbështetura në dokumentacion ligjor. Si rrjedhojë, ky observacion, nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij projekt-raporti auditimi.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. AB, është paraqitur observacioni me nr. 2047/3, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

1. “...kundërshtojmë gjetjet e audituesve të KLSH që lidhen me zbatimin e kontratës....”;
2. “...Vlera e likuiduar nga AK në favor të TBI, nuk përbën dëm ekonomik.....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se ju është lënë mundësia për të plotësuar dokumentacion vërtetues lidhur me udhëtimin/akomodimin. Si rrjedhojë, observacioni juaj është i pa mbështetur me dokumentacion ligjor dhe fakte e si i tillë, nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij projekt-raporti auditimi.

6.2 “Blerje Automjete”. Zhvilluar në vitin 2019 me fond limit 6,216,575 lekë pa TVSH.

6.2.1 Gjetje nga auditimi: Mos argumentim i nevojave të institucionit për fillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, zhvilluar në vitin 2019 me fond limit 6,216,575 lekë pa TVSH.

Situata: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, Titullari i institucionit, ka nxjerr urdhrin e prokurimit pa u kryer më parë argumentimi nga strukturat përkatëse lidhur me nevojën e blerjes së automjeteve të reja. Shkresa e parë e identifikuar në dosjen e prokurimit, është ajo me nr. 762 prot., datë 17.04.2019, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike. Përpara kësaj shkrese, njësia e prokurimit, nuk ka në dosjen e prokurimit, asnjë argumentim lidhur me arsyet e fillimit të procedurës së prokurimit. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe konkretisht të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2019, programit ekonomik financiar lidhur me investimet e vitit 2019 të AAC, apo relacioneve të mbledhjeve të zhvilluara nga Këshilli Drejtues, nuk u konstatua asnjë analizë ekonomike lidhur me arsyetimin ose justifikimin e blerjes së 2 automjeteve për nevojat e AAC. Nga verifikimet e kryera pranë AAC, tek strukturat përkatëse u konstatua se institucioni, ka pasur në përdorim 5 automjete për vitin 2018 dhe konkretisht automjetet me targa: AA 415 IZ, AA 462 SU, AA 516 IZ, AA 404 DV dhe AA 527 IZ. Automjeti me targë AA 527 IZ, është transferuar tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 21.12.2018 dhe automjeti me targë AA 415 IZ, është transferuar tek Avokatura e Shtetit në datën



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

14.02.2019. Nga auditimi i veprimeve ark-bankë, u konstatua një shpenzim në vlerën 109,737 lekë për likuidim të operatorit ekonomik “A” SHPK për marrje me qira të një automjeti veturë me arsyetimin sipas shkresës me nr. 614 prot., datë 20.06.2019, se AAC “ka aktivitetet monitorues dhe kryen lëvizje të shpeshta drejt operatorëve dhe subjekteve që veprojnë në fushën e aviacionit civil, vizitat dhe shoqërimi i ekspertëve të huaj...”. Pra në një hark kohor prej afro 6 muaj pasi AAC dhuron dy automjete, pretendon se ka nevojë për automjete për arsye të lëvizjeve të shpeshta. Pas datës 14.02.2019, AAC ka pasur në funksion 3 automjetet e mbetura. Si rezultat, nuk është aspak e qartë se përse AAC transferon automjetet që ka në përdorim tek institucionet e tjera duke i falur ato, pa kryer paraprakisht një vlerësim të nevojave të saj dhe në të njëjtën kohë, kryen shpenzime në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të fondeve publike duke marr me qira automjete për përdorim apo duke i blerë ato. Si rezultat, vlera e likuiduar për blerjen e dy automjeteve referuar faturave me nr. 74 dhe nr. 75, datë 03.10.2019 që në total është 7,358,400 lekë, konsiderohet investim me efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit.

Kriteri:

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, kreu II, organizimi i prokurimit publik, neni 12, përgjegjësia e autoritetit kontraktor, pika 1 dhe pika 2 gërma (a);
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, e ndryshuar, neni 57, pika 3, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4;
- Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Neni 107, dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve dhe Neni 108, dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për investime të pa nevojshme.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, në fillim të kryhet vlerësimi i aktiveve dhe vetëm nëse aktivet konsiderohen të panevojshme për Autoritetin e Aviacionit Civil, atëherë mund të merret vendimi për dhurimin e tyre.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, KK dhe Përgjegjësi i Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve AP.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK është paraqitur observacioni me nr. 2047/13, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

“...**paragjykimin tuaj** mbi këtë procedurë nuk është relevant”;

“...**konkluzione paragjykuese** me shprehinë Përpara kësaj shkrese...”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se pretendimet e paraqitura në observacionin e mësipërm, nuk janë të argumentuara me dokumenta ligjorë e si të tilla, nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij projekt-raporti auditimi.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

6.2.2 Gjetje nga auditimi: Referencë ligjore e gabuar për fillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, zhvilluar në vitin 2019 me fond limit 6,216,575 lekë pa TVSH.

Situata: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, Titullari i institucionit, ka nxjerr urdhrin me nr. 762 prot., datë 17.04.2019, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 567 prot., datë 30.05.2019, grupi i ngritur, për justifikimin e blerjes së dy automjeteve tip “Hibrid”, i është referuar ligjit nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”. Kjo shkresë, i drejtohet Drejtorit të AAC i cili e ka nënshkruar me shënimin të veprohet “*Sipas propozimit dhe ligjit*”. Grupi i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike, nuk ka në përbërje të tij specialista me profesion jurist. Profesionet e antarëve të grupit të hartimit të specifikimeve teknike, janë inxhinier dhe ekonomist. Pra gjykimi për vendosjen e bazës ligjore në këtë procedurë, i takon njësisë së prokurimit e cila ka në përbërje të saj, specialista me profesion jurist. Ligji i përmendur në procesverbalin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike, ka si objekt monitorimin e cilësisë së ajrit nga institucionet përkatëse duke mbledhur informacione sipas zonave lokale, rajonale ose kombëtare me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Pra, ky ligj, nuk i referohet në asnjë rast Autoriteteve Kontraktore duke i detyruar ato që në blerjen e mallrave ti referohen atij dhe jo ligjit të prokurimit publik, sidomos në blerjen e automjeteve ku institucioni përgjegjës për kontrollin e shkarkimeve në atmosferë të automjeteve, është Societe Generale de Surveillanc ose shkurt SGS. Për më tepër, operatorët ekonomik që kanë në aktivitetin e tyre, shitjen e mjeteve të transportit, janë të detyruar që për çdo mjet të ri, të respektojnë standardet teknike të kufijve të lejuar të gazrave që shkarkojnë në atmosferë automjetet gjatë funksionimit të tyre.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1, objekti dhe qëllimi.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për shmangie të konkurrencës në procedurat e prokurimit publik.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të ligjit të prokurimit publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, në kryerjen e procedurave të prokurimit, ti referohen ligjit të prokurimit publik me qëllim rritjen e efikasitetit, për të nxitur pjesëmarrjen dhe konkurrencën.

Afati: Në vazhdimësi.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK dhe znj AP, janë paraqitur observacionet me nr. 2047/13 dhe nr. 2047/26, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

“...**Të pavend** e gjej edhe citimin se.....”;

“...**konkluzioni paragjykes** se.....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se argumentat e paraqitura në observacionin e mësipërm, janë të pranueshme. Ky observacion për këtë pikë, merret në konsideratë nga grupi i auditimit në hartimin e këtij projekt-raporti auditimivëtëm duke ju shkarkuar nga përgjegjësia si njësi prokurimi. Qëndron gjetja lidhur me bazën ligjore të gabuar.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

6.2.3 Gjetje nga auditimi: Kualifikim i gabuar i KVO në vlerësimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, zhvilluar në vitin 2019 me fond limit 6,216,575 lekë pa TVSH, duke sjellë pasoja negative ekonomike për buxhetin e shtetit.

Situata: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas raportit përmbledhës propozon të shpallet fitues oferta më e lartë me vlerë 6,132,000 lekë pa TVSH e operatorit ekonomik “AMC” SHPK. Të dhënat teknike të deklaruara nga operatori ekonomik i s’kualifikuar nga KVO, duhej të pranoheshin si devijime të vogla nga AK edhe për faktin se operatori i shpallur fitues ka mangësi. Diferencat e konstatuara në distanca të mjetit apo edhe fuqinë e tij, teknikisht nuk luajnë asnjë rol thelbësor në performancën e automjeteve. Pra fakti që automjeti do ishte 9 cm më i ngushtë nga aksi në aks, apo 29 cm më i shkurtër, ose 1 cm më i ngushtë por edhe sikur me fuqi më të ulët se ajo e kërkuar afro 20 kf (kuaj-fuqi) ose afro 15 kW, nuk përbën në vetvete arsye thelbësore për s’kualifikim për më tepër që operatori ekonomik i shpallur fitues, ka mangësi. KVO, pasi të argumentonte dhe të shqyrtonte në total performancën motorrike të automjetit të ofruar duke përcaktuar teknikisht se për cilat kushte specifikisht nuk plotësonte kriteret automjeti me fuqi 15 kW më të ulët duke iu referuar terrenit ose edhe shpejtësisë, atëherë mund ta s’kualifikonte ofertën më të ulët. KVO duhej ta kualifikonte operatorin ekonomik “HAA” SHPK me ofertën me vlerë 5,990,000 lekë si oferta më me leverdi ekonomike për institucionin ose të anulonte procedurën e prokurimit për mangësi të të dy ofertave të ardhura, pasi operatori ekonomik i shpallur fitues ka mangësi të theksuara madje thelbësore pasi nuk e disponon automjetin e kërkuar nga AK. Diferenca e ofertave prej 142,000 lekë, konsiderohet si shpenzim në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efikasitetit të administrimit dhe përdorimit të fondeve publike.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, Neni 1, objekti dhe qëllimi, gërma (b) dhe Neni 53, shqyrtimi i ofertave, pika 4.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për kualifikim të padrejtë me pasoja ekonomike negative për institucionin.

Shkaku: Mosveprim i komisionit të vlerësimit të ofertave.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, Komisionet e Vlerësimit të ofertave, të marrin masat që në të ardhmen, të kualifikojnë vetëm ato oferta që plotësojnë kriteret e vendosura në DST dhe që janë me leverdi ekonomike për institucionin.

Afati: Në vazhdimësi.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. ET, z. MH dhe z. AZ është paraqitur observacioni me nr. 2047/4, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

“...dhe kjo distancë është në kundërshtim me specifikimet teknike të DST”;

“.....JU SQAROJMË SE: konstatimi i juaji që nuk kanë paraqitur katalogun në sistemin e SPE dhe pastaj më poshtë shpreheni në kataloguan e paraqitur, janë fjali që bien në kundërshtim me njëra-tjetrën”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, janë rishikuar specifikimet teknike dhe janë bërë korrigjimet në aktin e mbajtur dhe konkretisht fjalia “nuk ka paraqitur katalogun e mjeteve që kërkohen” u bë “nuk ka paraqitur në katalogun e dorëzuar në SPE, të dhënat teknike për mjetet që kërkohen dhe as



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

specifikimet teknike të mjeteve sipas kriterëve të përcaktuara nga AK”. Lidhur me observimin tuaj ku pretendoni se 9 cm, 10 cm apo edhe 29 cm, nuk janë devijime të vogla, ju sugjerojmë të rilexoni aktin e mbajtur dhe ta vlerësoni atë pozitivisht për të reflektuar në të ardhmen. Sa më sipër, observacioni juaj për të hequr vlerën e efektit negativ financiar për institucionin tuaj, nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij projekt-raporti auditimi.

6.3. “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së koncesionit të TIA-s”. Zhvilluar në vitin 2018 me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH.

6.3.1 Gjetje nga auditimi: Kërkesa nga Organi Shtetëror i Autorizuar drejtuar Autoritetit të Aviacionit Civil për mbulimin e shpenzimeve nga AAC të ekspertit të pavarur për rishikimin e pozicionit ekonomik të koncesionit, në kundërshtim me kushtet e kontratës koncesionare.

Situata: Me shkresën nr.777 prot., datë 16.04.2018, Organi Shtetëror i Autorizuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga Ministri z. DG dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë e përfaqësuar nga Ministri z. AA, i dërgojnë Drejtorit të AAC z. KK, një kërkesë “Mbi mbulimin e shpenzimeve të këshilltarit financiar të kualifikuar, në kuadër të rishikimit të pavarur ekonomik të kontratës koncesionare me TIA SHPK” tek e cila midis të tjerash kërkohet **mbulimi i kostove të vlerësimit të pavarur nga një këshilltar i përshtatshëm financiar i kualifikuar** duke e urdhëruar AAC që **procedura e përzgjedhjes, duke përfshirë edhe njoftimet e nevojshme të ndiqen nga AAC në përputhje me legjislacionin në fuqi.** Referuar Ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004 Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “Tirana Airport Partners”, SHPK, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare”, Organi Shtetëror i Autorizuar nga Qeveria Shqiptare (MIE dhe MFE), sipas nenit 8 të kontratës koncesionare, është palë në kontratën koncesionare me koncesionarin “Tirana Airport Partners”, SHPK dhe asnjë institucion apo organ tjetër nuk është i autorizuar për mbulimin e kostove e sidomos të rishikimit të pozicionit ekonomik të koncesionit sipas klauzolës nr. 19.4, pika (a) të kontratës koncesionare ku përcaktohet se kostoja e një vlerësimi të tillë (Rishikimi i Pavarur) i ngarkohet **palës që e kërkon një Rishikim të tillë të Pavarur.** Për më tepër referuar dhe nenit 34 të kontratës koncesionare lidhur me konfidencialitetin apo nenit 37.15 lidhur me të drejtat e palëve, asnjë palë tjetër nuk mund të ketë akses në asnjë dokument apo pjesë që ka lidhje me kontratën koncesionare pa miratimin e palëve nënshkruese të kontratës. Organi Shtetëror i Autorizuar (MIE dhe MFE) duhej të mbulonin vetë koston për një rishikim të pavarur të kontratës koncesionare dhe jo të kërkonin mbulimin e koston nga AAC.

Kriteri: Ligji nr. 9312, datë 11.11.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit”, neni 19.4, Rishikimi Pavarur Ekonomik, pika (a), neni 34.1, Shtrirja e Konfidencialitetit, neni 35.1 Kalimi nga Qeveria e Shqipërisë dhe neni 37.15 Të drejtat e palëve të treta.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për shpenzime/investime në kundërshtim me ligjin.

Shkaku: Mosveprim i Strukturave të AAC, sipas përcaktimeve të ligjit të institucionit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të marrin masat që në të ardhmen, të analizojnë kërkesat e ardhura nga MIE dhe të konsiderohen të rregullta, vetëm nëse ato janë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, mos analizimin e kërkesës nga MIE dhe MFE, por marrjen e saj si të mirëqenë dhe të rregullt, mban përgjegjësi z. KK me detyrë Drejtor i AAC.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/15, datë 15.11.2019, ku cilësohet se: “...Pra, është detyrë direkte e AAC ndjekja dhe zbatimi i udhëzimeve dhe të kërkesave që burojnë nga Qeveria Shqiptare, në dobi të mirë rregullimit dhe mbarëvajtjes së fushës së Aviacionit Civil Shqiptar”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, në asnjë rast, në asnjë rresht apo paragraf të gjetjes nr. 1, të akt-konstatimit nr. 11, nuk cilësohet se nuk duhet të ndiqni urdhrat dhe udhëzimet në dobi të mbarëvajtjes së fushës së Aviacionit Civil Shqiptar. Përkundrazi, konstatimi i grupit të auditimit, ka për synim pikërisht këtë fakt, që AAC duhet të respektojë ligjin për realizimin e objektivit kryesor atë të “Rregullimit dhe mbikëqyrjes së të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”. Gjithsesi, lidhur me këtë gjetje, ju sqarojmë se ngarkoheni me përgjegjësi vetëm për mos analizimin e kërkesës së MIE dhe MFE. Pra, duhej që ju si Drejtor Ekzekutiv i AAC, në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit Ligjor dhe Sektorin e Kontratave dhe të Shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme të AAC, të analizonit paraprakisht kërkesën e MIE dhe MFE nëse ajo ishte në konformitet me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe në vazhdim mund të vendosnit për kryerjen e një procedure prokurimi ose jo. Sa më sipër, ky observacion lidhur me këtë pikë, nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij projekt-raporti auditimi.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. BH, është paraqitur observacioni me nr. 2047/1, datë 13.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

“...Nuk kam asnjë dijeni për kërkesën e MIE dhe MFE.....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, është rishikuar pozicioni i punonjësve të AAC dhe është konkluduar se z. BH është emëruar sipas shkresës nr. 299 prot., datë 19.02.2018, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Kabinetin e Drejtorit Ekzekutiv dhe jo në Sektorin e Shërbimit Ligjor të Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme. Si rrjedhojë, observacioni juaj për këtë pikë merret në konsideratë duke ju shkarkuar nga përgjegjësia. Gjithashtu, nuk u konstatua asnjë shkresë ku jëtë jeni vënë në dijeni për shprehje të mendimit lidhur me kërkesën nga MIE dhe MFE.

6.3.2 Gjetje nga auditimi: Ngritja e grupit të punës për hartimin e termave të referencës dhe kontraktimi i një eksperti të jashtëm në ndihmë të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe termave të referencës, për një procedurë prokurimi të paparashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik për vitin 2018, pa marrë miratimin e Këshillit Drejtues të AAC dhe në vijim publikimin e ndryshimit të regjistrin në APP.

Situata: Me shkresën nr. 777/5 prot., datë 26.04.2018, Titullari i AAC, urdhëron ngritjen e grupit të punës me përbërje SP, KK dhe IB, ky i fundit si ekspert i jashtëm i kontraktuar nga AAC me kontratën me nr. 777/4 prot., datë 26.04.2018. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se procedura e prokurimit me objekt “Rishikimi i pavarur ekonomik i



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

kontratës koncesionare të TIA”, nuk ka qenë e parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për AAC në vitin 2018, regjistër i cili është miratuar në programin ekonomik financiar nga Këshilli Drejtues i AAC me vendimin nr. 80, datë 21.12.2017, nr. 352 prot. Ndryshimet e programit ekonomik financiar të vitit 2018, janë miratuar me vendimin nr. 6, datë 24.05.2018, nr. 22 prot., tek i cili është shtuar nënçëri “*Konsulencë vlerësim i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare TIA*” tek zëri Aktive të patrupëzuara. Në vazhdim, regjistri i prokurimeve publike për vitin 2018 me ndryshimet e tij, është reflektuar në APP, në datën 26.06.2018. Kjo në fakt, duhej të ishte data, pas së cilës, AAC mund të ndërmerre ndonjë veprim për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit të shtuar në regjistër pas ndryshimeve të miratuara nga Këshilli Drejtues i AAC. Si rezultat, Drejtori i AAC, ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin e AAC dhe atë të prokurimit publik. Drejtori i AAC, ka filluar procedurën për përgatitjen e specifikimeve teknike duke lidhur edhe një kontratë me një ekspert të jashtëm në funksion të procedurës së prokurimit me objekt “*Konsulencë vlerësim i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare TIA*”, pa u miratuar më parë nga Këshilli Drejtues dhe APP.

Kriteri: Ligji nr. 10233, datë 11.2.2010, Për Autoritetin e Aviacionit Civil, me ndryshime, Neni 6, Kompetencat e Këshillit Drejtues, gërma (a) dhe Neni 13, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv, gërma a), gërma c) dhe gërma ç).

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për shpenzime/investime në kundërshtim me ligjin.

Shkaku: Mosveprim i Strukturave të AAC, sipas përcaktimeve të ligjit të institucionit dhe ligjit të prokurimit publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, procedurat e prokurimit të paparashikuara, të fillojnë vetëm pasi të merret miratimi përkatës nga KD e në vazhdim, publikimi i regjistrit të ndryshuar të parashikimeve të procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Z. KK, Drejtor i AAC.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/15, datë 15.11.2019, ku cilësohet se: “...Pra, rregullat e prokurimit publik e lejojnë të kryhet një procedurë prokurimi deri te njoftimi i fituesit **edhe pa e patur fondin në dispozicion**”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, në asnjë rast, në asnjë rresht apo paragraf të gjetjes, nuk cilësohet ajo që ju pretendoni në observacion. Nuk është konstatuar në aktin e mbajtur nga grupi i auditimit se keni filluar një procedurë prokurimi pa patur fondin në dispozicion. Konstatimi i grupit të auditimit, cilëson faktin se keni marrë të mirëqenë se do miratoheshin ndryshimet e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, duke nxjerrë urdhra që i përkasin një procedure prokurimi të pa miratuar as nga KD e as të raportuar në APP. Sa më sipër, observacioni juaj për këtë pikë, nuk ka asnjë lidhje me gjetjen e grupit të auditimit e si rrjedhojë nuk mund të merret në konsideratë në hartimin e këtij projekt-raporti auditimi.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

6.3.3 Gjetje nga auditimi: Kontraktimi i një eksperti të jashtëm për hartimin e termave të referencës pa qenë nevoja pasi AAC disponon në stafin e saj nëpunës të kualifikuar.

Situata: Me shkresën pa nr.protokolli dhe datë 16.04.2018, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme z. FG dhe Përgjegjësja e Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve znj. AP, i dërgojnë një relacion Drejtorit të AAC mbi nevojën për ekspert të jashtëm për hartimin e ToR të procedurës së prokurimit me objekt “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s*”. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe konkretisht të dosjeve të personelit, u konstatua se AAC në stafin e saj ka nëpunës të specializuar në shkencat ekonomike me profesion ekspert kontabël të regjistruar madje edhe auditues me eksperiencë në auditimin e programeve IPA pa përmendur këtu personelin permanent të AAC që ka kryer prej kohësh auditim në TIA. Konkretisht, znj. AP, me diplomë Master Shkencor nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik dhe eksperiencë të gjatë në Ministrinë e Transporteve, atë të Ekonomisë madje edhe si audituese tek Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga BE pa përmendur këtu çertifikatat e marra nga trajnimet në fushën e auditimit apo edhe në ekonomi. Znj. AS, larguar nga puna me urdhrin nr. 56, datë 04.02.2019. Znj. S, është gjithashtu e diplomuar në ekonomi-financë në Universitetin Sapienza në Romë me mastër në financat ndërkombëtare dhe menaxhim risku. Ka eksperiencë si konsulente financiare në Bankën Europiane, në institutin për politikat publike dhe mirëqeverisjes apo në Ministrinë e Punëve të Jashtëme. Znj. EM, e diplomuar në shkencat ekonomike në Universitetin European të Tiranës me titullin “Doktor”, mastër shkencor në biznes administrim, e diplomuar gjithashtu në juridik, ka licensë ekspert fiskal me nr. 210 dhe ka mjaftueshëm trajnime e çertifikata në fushën e aviacionit civil dhe atë ekonomik. Si rezultat, AAC nuk kishte pse të kërkonte ekspert të jashtëm me diplomë master në shkencat ekonomike apo edhe me çertifikata në të njëjtën kohë që në stafin e saj ka pasur specialistë të fushave përkatëse. Të paktën, AAC duhej të respektonte rradhën e përzgjedhjes së ekspertit të jashtëm duke kërkuar nga institucione të tjera pse jo nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Vlera e shpenzuar për kontraktimin e ekspertit të jashtëm, sipas urdhër xhirimit të Union Bank me nr.ref 117FTRQ183620008 dhe datë 28.12.2018, është 186,150 lekë dhe përbën shpenzim me efekt negativ financiar për AAC dhe buxhetin e shtetit.

Kriteri:

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime: Neni 57, Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, pika 2, paragrafi II dhe III.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për shpenzime/investime në kundërshtim me ligjin.

Shkaku: Mosveprim i Strukturave të AAC, sipas përcaktimeve të ligjit të institucionit dhe ligjit të prokurimit publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme, të marrin masat që në të ardhmen, të propozojnë kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për procedurat e prokurimit, vetëm pasi të jetë konkluduar se AAC ose dhe Autoritete të tjera Kontraktore, nuk kanë staf të specializuar në përbërje të tyre.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Z. KK, Drejtor i AAC.

Observacion:

Prendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/15, datë 15.11.2019, ku cilësohet se: “...Pra, rregullat e prokurimit publik e lejojnë të kryhet një procedurë prokurimi



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

deri te njoftimi i fituesit edhe pa e patur fondin në dispozicion”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, në asnjë rast, në asnjë rresht apo paragraf të gjetjes, nuk cilësohet ajo që ju pretendoni në observacion. Nuk është konstatuar në aktin e mbajtur nga grupi auditimit se keni filluar një procedurë prokurimi pa patur fondin në dispozicion. Konstatimi i grupit të auditimit, cilëson faktin se keni marrë të mirëqenë se do miratoheshin ndryshimet e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, duke nxjerrë urdhra që i përkasin një procedure prokurimi të pa miratuar as nga KD e as të raportuar në APP. Sa më sipër, observacioni juaj për këtë pikë, nuk ka asnjë lidhje me gjetjen e grupit të auditimit e si rrjedhojë nuk mund të merret në konsideratë në hartimin e këtij projekt-raporti auditimi.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. BH, është paraqitur observacioni me nr. 2047/1, datë 13.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

“...Nuk kam asnjë dijeni për këtë kontratë. Nuk kam asnjë delegim praktike për këtë çështje”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, është rishikuar pozicioni i punonjësve të AAC dhe është konkluduar se z. BH është emëruar sipas shkresës nr. 299 prot., datë 19.02.2018, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Kabinetin e Drejtorit Ekzekutiv dhe jo në Sektorin e Shërbimit Ligjor të Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme. Si rrjedhojë, observacioni juaj për këtë pikë merret në konsideratë duke ju shkarkuar nga përgjegjësia. Nuk u konstatua asnjë shkresë ku ju personalisht të jeni vënë në dijeni.

6.3.4 Gjetje nga auditimi: Fondi limit i përcaktuar tek urdhri prokurimit, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

Situata: Me shkresën nr. 1208 prot., datë 27.06.2018, Titullari i AAC, nxjerr urdhrin e prokurimit me objekt: “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s” të llojit “Shërbim Konsulencë”, me fond limit **29,542,841.28 lekë pa TVSH**. Në fakt, fond limit i përcaktuar nga grupi i përllogaritjes së vlerës së fondit limit, i përbërë nga znj. SP (AAC), z. IB (Eks/Jasht) dhe znj. KK (AAC), sipas procesverbalit të mbajtur për termat e referencës dhe përllogaritjen e fondit limit në datën 18.06.2018, është **29,029,513.12 lekë pa TVSH**. Pra Drejtori i AAC, ka urdhëruar kryerjen e procedurës së prokurimit me një fond limit për të cilin nuk është kryer asnjë testim tregu dhe që është **513,328.16 lekë** më i lartë se fondit i miratuar nga grupi i përllogaritjes së tij. Fondi limit i përllogaritur nga grupi i ngritur, nuk është marrë në konsideratë nga Drejtori i AAC, duke përcaktuar fondin limit në urdhrin e prokurimit pa ndjekur hapat e përcaktuara në ligj, aktet nënligjore dhe rregullat e prokurimit publik.

Kriteri:

-Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, pika 1;

-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1, objekti dhe qëllimi, gërma (b) dhe gërma (dh);

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, Neni 37 “Shërbimet e konsulencës”, pika 4, gërma (b), Neni 59 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës” dhe Neni 60 “Urdhri i prokurimit”.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për shpenzime/investime në kundërshtim me ligjin.

Shkaku: Mosveprim i Strukturave të AAC, sipas përcaktimeve të ligjit të prokurimit publik.

Rëndësia: E lartë.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, urdhrat e prokurimit, në përcaktimin e vlerës së fondit limit, ti referohen vlerës së përlogaritur nga grupi i përlogaritjes së vlerës së fondit limit.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, z. KK dhe znj. AP me detyrë përgjegjëse e sektorit të kontratave dhe shërbimeve në AAC.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga znj. AP dhe z. KK, janë paraqitur përkatësisht observacionet me nr. 2047/27 dhe nr. 2047/15 datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

1. “...Në njësinë e prokurimit të ngritur me urdhrin nr. 36, datë 27.06.2018, jemi 3 anëtarë dhe jo vetëm unë”;
2. “...Diferenca ndërmjet fondit të përlogaritur dhe atij të përcaktuar në urdhrin e prokurimit është si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit të monedhës Euro”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Nga grupi i auditimit, është lënë përgjegjësia edhe për njësinë e prokurimit pamvarësisht se në fund është shënuar vetëm emri juaj si përgjegjëse e sektorit të kontratave dhe shërbimeve apo edhe emri i Drejtorit të AAC. Gjithsesi, në hartimin e raportit përfundimtar, do të merret në konsideratë sygjërimi juaj për vendosjen nën përgjegjësi edhe të personave të tjerë anëtarë të njësisë së prokurimit.
2. Lidhur me pretendimin se diferenca e fondit limit të konstatuar nga grupi i auditimit është si rezultat i kursit të këmbimit, ju sqarojmë se të dhënat për kursin e këmbimit ndodhen në faqen e Bankës së Shqipërisë dhe se ju fare mirë mund të dokumentoni diferencën e konstatuar duke ju referuar datës së përlogaritjes dhe kursit të këmbimit në atë datë. Gjithsesi, dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, vëreteton atë që cilësohet edhe tek gjetja nr. 4 e akt-konstatimit nr. 11 të grupit të auditimit, pra vlera e përlogaritjes së fondit limit, është e dokumentuar me fakte nga grupi i përlogaritjes.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. BH, është paraqitur observacioni me nr. 2047/1, datë 13.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

“...Nuk i përkas sektorit ligjor dhe prokurimeve”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, është rishikuar pozicioni i punonjësve të AAC dhe është konkluduar se z. BH është emëruar sipas shkresës nr. 299 prot., datë 19.02.2018, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Kabinetin e Drejtorit Ekzekutiv dhe jo në Sektorin e Shërbimit Ligjor të Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme. Si rrjedhojë, observacioni juaj për këtë pikë merret në konsideratë duke ju shkarkuar nga përgjegjësia.

6.3.5 Gjetje nga auditimi: Kontraktimi i një eksperti të jashtëm si antar i KVO, pa ndjekur procedurat ligjore, pa transparencë dhe pa qenë nevoja pasi AAC disponon në stafin e saj nëpunës të kualifikuar.

Situata: Me shkresën nr. 1208/3 prot., datë 02.07.2018, Titullari i AAC, nxjerr urdhrin për pajtimin e një eksperti të jashtëm për antar të KVO për procedurën e prokurimit me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”. Me shkresën nr. 1208/4 prot.,



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

datë 04.07.2018, Titullari i AAC, nënshkruan kontratën me ekspertin e jashtëm z. RS. Në dosjen e procedurës së prokurimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion verifikues për mënyrën e përzgjedhjes së ekspertit të jashtëm si antar i KVO në ndryshim nga mënyra e përzgjedhjes së ekspertit për hartimin e DST për të cilin është shpallur vendi vakant në faqen web të AAC. Kontraktimi i ekspertit të jashtëm nga Drejtori i AAC duke nënshkruar kontratën është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, jo transparente dhe diskriminuese. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe konkretisht të dosjeve të personelit, u konstatua se AAC në stafin e saj ka nëpunës të specializuar në shkencat ekonomike me profesion ekspert kontabël të regjistruar madje edhe auditues. Si rezultat, AAC nuk kishte pse të kërkonte ekspert të jashtëm si antar të KVO duke rritur shpenzimet e procedurës së prokurimit. Të paktën, AAC duhej të respektonte hierarkinë e përzgjedhjes së ekspertit të jashtëm duke kërkuar nga institucione të tjera pse jo nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ashtu siç ka vepruar edhe me shkresën nr. 1189 prot., datë 26.06.2018 dërguar MIE. Vlera e shpenzuar për kontraktimin e ekspertit të jashtëm, sipas urdhër xhirimit të bankës BKT me kod 205/11552 dhe datë 15.02.2019, është 94,581 lekë dhe përbën shpenzim me efekte negativ financiar për AAC dhe buxhetin e shtetit.

Kriteri: Ligji nr.10233, datë 11.2.2010, Për Autoritetin e Aviacionit Civil, i ndryshuar, Neni 16, organizimi dhe detyrimet, pika 2 dhe Neni 17, Të ardhurat e AAC, pika 5.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për shpenzime/investime në kundërshtim me ligjin.

Shkaku: Mosveprim i Strukturave të AAC, sipas përcaktimeve të ligjit të institucionit dhe ligjit të prokurimit publik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, të propozojnë kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për procedurat e prokurimit, vetëm pasi të jetë konkluduar se AAC ose dhe Autoritete të tjera Kontraktore, nuk kanë në përbërje të strukturave të tyre, punonjës të specializuar.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Z. KK, Drejtor i AAC dhe znj. AP Përgjegjëse e Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve në AAC.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/15 dhe datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

1. “...Kriteri ligjor që ka përdorur audituesi është I papërshtatshëm për të vlerësuar apo matur çështjen në mënyrë të arsyeshme....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se baza për përzgjedhjen e një eksperti të jashtëm, në të dyja rastet si për nenin 57 ashtu edhe për nenin 58 të VKM nr. 914, ka të njëjtin qëllim, pra dhënien e mundësisë një institucioni për të përzgjedhur një ekspert të jashtëm si anëtar të njësisë së prokurimit apo edhe të KVO. Pretendimi juaj qëndron për faktin se neni i cilësuar nga grupi i auditimit i përket përzgjedhjes së anëtarit të njësisë së prokurimit dhe jo përzgjedhjes së anëtarit të KVO. Gjithsesi, mënyra juaj e të funksionuarit për përzgjedhjen e anëtarit të KVO, ka qenë arbitrare dhe pa transparencë. Ligji i prokurimit publik dhe rregullat për zbatimin e tij, në asnjë rresht nuk ju cilësojnë se mund të kryeni përzgjedhje të drejtpërdrejta pa asnjë konkurim. Edhe nëse i referohemi legjislacionit të shërbimit civil, do të konstatojmë se edhe atje ka procedura të



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

përzgjedhjes së stafit me kohë të reduktuar pra jo me kohë të plotë pune ose me kontratë provizore dhe jo me kontratë të përherëshme. Gjithsesi, lidhur me pretendimin tuaj se neni 57 i VKM nr. 914, nuk është relevant për këtë pikë, merret në konsideratë por pjesërisht pasi mënyra e përzgjedhjes së ekspertit të jashtëm, të paktën duhej të ishte transparente duke e shpallur vendin vakant në faqen tuaj ëeb-it.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. BH, është paraqitur observacioni me nr. 2047/1, datë 13.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

“...Nuk kam asnjë dijeni për këtë rast prokurimi. Nuk kam asnjë lidhje me këtë prokurim dhe prokurimet në përgjithësi dhe në asnjë fazë”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, është rishikuar pozicioni i punonjësve të AAC dhe është konkluduar se z. BH është emëruar sipas shkresës nr. 299 prot., datë 19.02.2018, në pozicionin e këshilltarit ligjor në Kabinetin e Drejtorit Ekzekutiv dhe jo në Sektorin e Shërbimit Ligjor të Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme. Si rrjedhojë, observacioni juaj për këtë pikë merret në konsideratë duke ju shkarkuar nga përgjegjësia.

6.3.6 Gjetje nga auditimi: Mos analizimi i shkaqeve të dështimit dy herë radhazi të procedurës së prokurimit me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare të TIA” të llojit “Shërbim Konsulence”.

Situata: Procedura e prokurimit me objekt “Rishikimi i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare me TIA” lloji “Shërbim Konsulence”, është iniciuar dhe anuluar dy herë radhazi. Konkretisht, është iniciuar për herë të parë me urdhrin e prokurimit nr. 1208 prot., datë 27.06.2018 dhe është anuluar për mungesë konkurrence. Është iniciuar përsëri me të njëjtin objekt dhe lloj procedure sipas urdhrin të prokurimit me nr. 1330 prot., datë 17.07.2018 dhe është anuluar përsëri për mungesë konkurrence. Njësia e prokurimit nuk ka analizuar/rishqyrtuar asnjë kriter të vendosur në DST por është shprehur **në procesverbalet e mbajtura** për të dyja anulimet me të njëjtin tekst, pra që nuk ka konkurrencë.

Kriteri:

-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 33, procedura me negociim pa shpallje pika 1 dhe gërma (c) e pikës 2;

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 73, “Mungesa e konkurrencës”, pika 2.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për përsëritje të procedurave të prokurimit me qëllim shmangien e konkurrencës.

Shkaku:Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të LPP-së.

Rëndësia:E lartë.

Rekomandimi:Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa që në të ardhmen, për procedurat e prokurimit të anuluar, të analizojnë shkaqet e dështimit të procedurës së prokurimit duke reflektuar ndryshimet në dokumentat standarte të tenderit, me qëllim rritjen e konkurrencës.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, z. KK dhe Përgjegjësja e Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve znj. AP.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK dhe znj. AP, janë paraqitur observacionet me nr. 2047/15 dhe nr. 2047/27, datë 15.11.2019, me të njëjtën përmbajtje ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

1. “...Të dyja këto procesverbale gjendeshin në dosjen përkatëse të procedurave të dorëzuar audituesit. Nga audituesi, gjatë periudhës së auditimit nuk është kërkuar asnjë rast paraqitja e evidencave të **konsideruara të munguara**....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se në asnjë rresht të aktit të mbajtur nuk cilësohet nga grupi i auditimit se mungojnë evidencat siç përcaktoni ju në observacion. Jeni jashtë kontekstit të gjetjes në fjalë e cila cilëson vetëm faktin se nuk keni kryer analizë dhe jo se nuk keni mbajtur procesverbal me titull “Analiza e shkaqeve të dështimit”. Është e cilësuar në aktin e mbajtur se i keni mbajtur procesverbalet për analizimin e shkaqeve por vetëm në titull se në përbërje nuk kanë asnjë analizë. Kjo është gjetja dhe jo ajo që pretendoni ju. Sa më sipër, jeni jashtë kontekstit të gjetjes dhe observacioni juaj për këtë pikë nuk merret në konsideratë.

6.3.7 Gjetje nga auditimi: Likuidim i një eksperti më shumë se numri i ekspertëve të kërkuar.

Situata: Në procedurën e prokurimit me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”, viti 2018, AAC ka likuiduar operatorin ekonomik “BA” SHPK për një ekspert më shumë krahasuar me numrin e ekspertëve të kërkuar për përmbushjen e kushteve të kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, referuar dosjes së zbatimit të kontratës, u konstatua se operatori ekonomik, ka dorëzuar faturën për likuidim në vlerën sipas strukturës së propozimit ekonomik të ofruar në procedurën e prokurimit. Tek ky propozim, tek pika 2 përcaktohen në total 9 ekspertë dhe konkretisht sipas pikës 3, kostot e drejtpërdrejta, 1 partner menaxhimi, 1 drejtues ekipi, 2 auditues dhe 5 ekspertë financiar kontabël. Tek DST, kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3, kapaciteti teknik, kriteret kualifikuese të stafit të domosdoshëm për këtë shërbim, kërkohet që: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në përbërje të stafit të tij, Partner Menaxhimi 1 (një punonjës), Drejtuesi i Ekipit 1 (një punonjës), Ekspertë të Kontrollit Financiar (Auditues Ligjor) 2 (dy punonjës) dhe Ekspertë Financiar & Kontabël 4 (katër punonjës). Në total, kërkohen 8 ekspertë mbi bazën e të cilëve është kryer dhe përlllogaritja e fondit limit nga grupi i ngritur me shkresën nr. 777/5 prot., datë 26.04.2018, të përbërë nga SP (AAC), IB (Eksp.Jashtëm) dhe KK (AAC). Në vazhdim, nuk është evidentuar ky fenomen as nga strukturat përkatëse për likuidimin e operatorit ekonomik. Konkretisht, tek pika 3 e kostove të drejtpërdrejta, nga operatori ekonomik i kualifikuar “BA” SHPK, është ofertuar për një ekspert financiar & kontabël më tepër nga sa kërkohet në DST dhe në kontratën e lidhur. Pagesa ditore e ekspertit financiar & kontabël është 590 Euro për 36 ditë pune= 21,240 Euro më tepër të deklaruar në preventiv të cilat i përkasin zërit “Kostot e drejtpërdrejta”. Operatori ekonomik, duhej të vihej në dijeni të gabimeve në preventivin/faturën e dorëzuar me qëllim korigjimin e faturës përfundimtare. Kjo vlerë, e likuiduar më tepër në favor të operatorit ekonomik prej 21,240 Euro, përbën investim me efekt negativ për buxhetin e shtetit.

Kriteri:Kontrata me nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018, Termat e referencës, pika 2, profili i operatorit ekonomik.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për likuidime të tepërta mbi ato të përlllogaritura.

Shkaku:Mosveprim i komisionit të vlerësimit të ofertave, sipas kriterëve të përcaktuara në DST.

Rëndësia:E lartë.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e shpenzuar me pasojë efekt negativ për institucionin duke evidentuar personat përgjegjës.

Afati: Në vazhdimësi.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. ET dhe z. RS, është paraqitur observacioni me nr. 2047/5, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

1. “...duhet të disponojë në stafin e tij tekniko-profesional minimumi 8 ekspertë....”;
2. “...operatori ekonomik nuk ka paraqitur të detajuar kostot e rimbursueshme....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se KVO duhej të analizonte zërat e preventivit dhe të kërkonte korigjimin e tyre. Është e vërtetë se janë kërkuar minimumi 8 ekspertë por fondi limit është përllëgaritur për egzaktësisht 8 ekspertë. Pra, vënia në dispozicion e operatorit ekonomik të më shumë se 8 ekspertëve nuk do të thotë se duhej të pranohet edhe më shumë ekspertë me pagesë. Me të njëjtën llogjikë, operatori ekonomik mund të ofertonte për 10 ekspertë mjafton që oferta mos të kalonte vlerën e fondit limit. Në fakt, ju duhej të korigjonit ofertën dhe të pranohet ofertë vetëm për 8 ekspertë në vlerë. Gjithsesi, strukturat përkatëse të AAC, duhej të mos kryhenin likuidimin e operatorit ekonomik për 9 ekspertë por për 8 ekspertë. Për këtë pikë, ju si KVO shkarkoheni nga përgjegjësia administrative. Për pretendimin e dytë, në akt-konstatimin e mbajtur, nuk cilësohet ajo që ju observoni. Cilësohet se shpenzimet e rimbursueshme janë konfuze dhe jo se nuk janë të detajuara. Si rrjedhojë, observacioni juaj, merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Nga z. Raimond Kristo, është paraqitur observacioni me nr. 2047/18, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

“...kjo edhe për faktin se rezulton se asnjë nga anëtarët e komisionit nuk e ka identifikuar këtë mospërputhje....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se observacioni juaj për këtë pikë, merret në konsideratë duke ju shkarkuar nga përgjegjësia.

Pretendimi i subjektit: Nga z. Limos Malaj BA SHPK, është paraqitur observacioni me nr. 2071, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

“.....Pra termat e referencës përcaktojnë se operatori ekonomik **nuk mund të angazhojë** më pak se 8 ekspertë....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se minimumi 8 ekspertë, nuk përjashton numrin 8 përkundrazi e përfshin atë. Gjithsesi, ju keni qenë në dijeni të plotë të DST dhe të numrit minimal të kërkuar të ekspertëve. Mund të ofronit edhe më shumë ekspertë por pagesa/oferta duhej të ishte vetëm për 8 ekspertë sepse edhe kalkulimet e vlerës së fondit limit janë bërë për 8 ekspertë e pasqyruar kjo kërkesë në numër tek DST. Si rezultat, observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

6.3.8 Gjetje nga auditimi: Vonesa në ekzekutimin e kontratës jashtë afateve të përcaktuara.

Situata: Në procedurën e prokurimit me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”, viti 2018, gjatë zbatimit të kontratës me nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018 të lidhur midis palëve, u konstatuan vonesa jashtë afateve të përcaktuara sipas nenit 4 të kontratës së lidhur. AAC, në datën 20.12.2018, datë në të cilën duhej të përfundonte kontrata bazë, ka lidhur



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

një kontratë shtesë duke e zgjatur afatin e kontratës bazë me 15 ditë pune ose me datë përfundimi datën 15.01.2019. Operatori ekonomik “BA” SHPK, ka dorëzuar raportin përfundimtar me 15 ditë vonesë referuar afateve të kontratës bazë. Zgjatja e afatit të kontratës bazë, sipas amendamentit me nr. 1609/15 prot., datë 20.12.2018, ka ardhur si rezultat i vonesave të dorëzimit të dokumentacionit nga TIA. AAC, referuar nenit 6 të kushteve të veçanta të kontratës bazë (*Në pikën 6 të termave të referencës, përcaktohet se “AK duhet të marrë masat për paisjen e kontraktorit me dokumentacionin, raportet dhe informacionet e nevojshme që lidhen me përmbushjen e misionit”*), duhej të merrte masat që brenda 3 ditëve nga data e lidhjes së kontratës bazë pra nga data 15.10.2018, të vinte në dispozicion të operatorit ekonomik, dokumentacionin dhe informacionet përkatëse për fillimin e zbatimit të kontratës me objekt “Rishikimi i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare”. Si rezultat, AAC ka pasur plot 10 muaj kohë për të marrë nga TIA informacionin e nevojshëm dhe ta vinte atë në dispozicion të operatorit ekonomik “BA” SHPK. Për më tepër, tek faqja web e Tirana International Airport, <http://opencorporates.al/sq/nuis/K51612012D>, koncesionari ka deklaruar me transparencë të plotë çdo të dhënë lidhur me tarifat që aplikohen nga TIA, pasqyrat financiare, bilancet në vite, transaksionet në thesar, fitimi para tatimit apo xhiro vjetore, etj. Këto të dhëna jepen për çdo vit të aktivitetit të Koncesionarit dhe AAC e ka pasur shumë të lehtë që të kërkonte dhe të merrte shumë shpejt “datat” zyrtare të faqes së internetit të TIA.

Kriteri: Neni 6 “Informacioni që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor”, pika 6.1, ku cilësohet:

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për zgjatje të afateve të ekzekutimit të shërbimeve duke mos arritur në kohë, objektivat e përcaktuar më parë.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, të respektohen kriteret e vendosura në DST dhe në kontratë dhe që kanë të bëjnë me afatet e ekzekutimit të shërbimit, me qëllim që ti paraprihet vonesave të paparashikuara të ekzekutimit të kontratave.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Titullari i Autoritetit të Aviacionit Civil z. KK.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/15 dhe datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, pretendohet se:

“...Audituesi duke mos e cituar të plotë nenin 6 të kushteve të veçanta të kontratës....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, në akt-konstatimin e mbajtur, nëse do ta kishit lexuar me vëmendje, do të konstatohet se është cilësuar neni 6 i TERMAVE TË REFERENCËS. Pra, fjalia e cilësuar në aktin e mbajtur, është e plotë dhe eksplicite e pa më të voglin devijim. Referojuni saktësisht në pikën 1 të pikës 6 të TERMAVE TË REFERENCËS ose për më lehtë, referojuni shtojcës 13, të DST, pika 6, Informacioni Administrativ. Në vazhdim mund të konstatohet se keni favorizuar operatorin ekonomik duke bërë shtesa dhe ndryshime tek kushtet e veçanta të kontratës siç e cilësoni dhe vetë në observacionin tuaj të cilat janë të ndryshme nga kushtet e përcaktuara në tender. Sa më sipër, observacioni juaj për këtë pikë nuk merret në konsideratë.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

6.3.9 Gjetje nga auditimi: Kryerja e shpenzimit në vlerën e 33,186,387 lekë për rishikimin e pozicionit ekonomik të kontratës koncesionare të Aeroportit Nënë Tereza Tiranë, mund të shmangej pasi AAC këtë detyrë, për zërat më të shumtë të kërkuar, mund ta kryente me strukturat e saj pa patur nevojë të kryente procedurë prokurimi.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me fillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së koncesionit të TIA-s*”, lloji procedurës “*Shërbim Konsulente*”, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se kjo procedurë është iniciuar nga AAC pasi i është kërkuar përzgjedhja e konsulentit dhe mbulimi i shpenzimeve nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) sipas shkresës dërguar AAC me nr. 777 prot., datë 16.04.2018. Drejtori i AAC, përpara se të nxirrte urdhrin për hartimin e termave të referencës apo urdhrin e prokurimit, duhej që të kërkonte mendim nga sektori i përfaqësimit ligjor dhe i prokurimeve të institucionit, duke analizuar detyrat e AAC sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi. Konkretisht, nga auditimi i ligjit të AAC dhe rregullores së brendëshme të institucionit, nga grupi i auditimit, konstatohet se AAC e ka pasur si detyrë të përcaktuar në rregulloren e brendëshme, monitorimin e performancës së Marrëveshjeve Koncesionare. Këtë detyrë, AAC e ka zbatuar prej vitesh aq më tepër që procedura e prokurimit kërkon rishikimin e pozicionit ekonomik për vitet e kaluara pra kontrata do ketë fuqi paravepruese dhe ndryshimi i strukturës në vazhdimësi pas vitit 2018, nuk ka luajtur rol në humbjen e aftësisë së AAC për të monitoruar Koncesionarët gjë që e ka bërë vazhdimisht në të kaluarën. Qëllimi final i kontratës së lidhur midis AAC dhe operatorit ekonomik “BA” SHPK, nuk është dorëzimi i një raporti lidhur me “Rishikimin e pavarur të pozicionit ekonomik të Koncesionit” por rikthimi i ekuilibrit ekonomik i konstatuar nga “BA” SHPK (nëse ka pasur disekuilibër) sipas gërmës (b) dhe gërmës (c) të klauzolës nr. 19.4 të ligjit nr.9312, datë 11.11.2004 (Kontrata Koncesionare) duke zbatuar një ose më shumë nga Rekomandimet e dhëna nga operatori ekonomik pas kryerjes së rishikimit të pavarur ekonomik të koncesionit.

Kriteri: Ligji nr.10233, datë 11.2.2010, me ndryshime “Për Autoritetin e Aviacionit Civil.

Ndikimi: Mund të mos sjellë uljen e tarifave aeroportuale dhe mosvendosjen e një ekuilibri ekonomik në favor të publikut.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë duke mos kërkuar nga MIE sqarime lidhur me arritjen e qëllimit final atë të vendosjes së një ekuilibri ekonomik.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Këshilli Drejtues i AAC, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të analizojnë vlerën e investuar prej 33,186,387 lekë për kryerjen e rishikimit të pavarur ekonomik, duke verifikuar nëse me kryerjen e këtij shpenzimi, janë zbatuar Rekomandimet e Konsulentit “BA” SHPK për arritjen e objektivave të përcaktuara më parë për “Rikthimin e ekuilibrit ekonomik të Koncesionit të TIA-s”. Në të kundërt, të nxirren përgjegjësitë për Drejtorin Ekzekutiv të AAC dhe Sektorin e Kontratave dhe Shërbimeve, lidhur me fillimin e një procedure prokurimi dhe kryerjen e një investimi në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve të fondeve publike.

Afati: Menjëherë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil z. KK.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/6, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur cilësohet se:

“...Në lidhje me panevojshmërinë e kryerjes së shërbimit të jashtëm...”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se pretendimet tuaja janë jashtë kontekstit të gjetjes pasi në asnjë rresht të gjetjes nuk citohet se mund ta kryenit ju rishikimin ekonomik. Gjetja insiston në faktin se mund ta kishit shmangur pasi keni kryer gjatë gjithë vitetve të kaluara, auditime dhe mund të shmangnit investimin për më tepër që duhej paraprakisht të kryenit verifikimet përkatëse me profesionalizëm dhe duke e parë çështjen nga interesi ekonomik në favor të Shtetit Shqiptar. Konkretisht, nëse do ti referoheshit ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004, me ndryshime, do të konstatonit gjithashtu se tek klauzola 19.2, Vlerësimi Periodik i Pagesave të Shërbimeve të Aeroportit, OSHA-së, i jepej mundësia që të negocionte me TIA çdo tre vjet ose ekzaktësisht në muajin Janar 2019. Pra nëse do kishit analizuar me seriozitet ligjin e mësipërm, mund të sygjeronit ju si AAC, tek MIE dhe MFE se mund të prisnin afatin deri në Janar 2019 për një negociim me Koncesionarin edhe pse detyrimisht në favor të Koncesionarit por të paktën kishit shansin që në respekt të ligjit, të kërkonit dokumentacion në muajin e negociimit të cilin vetë Koncesionari duhet ta paraqiste për pretendimet e tij. Si rezultat, ky observacion për këtë pikë nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit pasi është i pa bazuar në dokumentacion ligjor.

6.3.10 Gjetje nga auditimi: Likuidimi i operatorit ekonomik, është kryer nga AAC, pa u vërtetuar se konsulentët e huaj të kontraktuar, kanë kryer detyrat dhe shpenzimet e tyre sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se operatori ekonomik “BA” SHPK, nuk ka dorëzuar pranë AAC, dokumentacion që vërteton angazhimin e ekspertëve të huaj të deklaruar në formularin e ofertës sipas ditëve dhe kohës së tyre të punës por edhe shpenzimet e rimbursueshme të likuiduara nga AAC lidhur me kostot e transportit ndërkombëtar dhe hotelet apo dietat. Nuk ka në dosjen e zbatimit të kontratës, asnjë dokumentacion që vërteton se ekspertët e huaj të angazhuar në zbatimin e kontratës me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”, kanë qenë prezent në Shqipëri gjatë ekzekutimit të kontratës, kanë udhëtuar, akomaduar në hotel dhe punuar në ambientet e përcaktuara sipas kontratës së lidhur dhe konkretisht kontratës me nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018, nenit nr. 5 të Kushteve të Veçanta, pika 5.1 ku cilësohet se: “Shërbimet do të kryhen në zyrat e administratës Tirana International Aeroport Rinas, Tiranë, pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1, P.O Box 205, Tiranë, Shqipëri ose zyrat e kontraktuesit sipas rastit” dhe pikës 3.2, të seksionit “Profili i operatorit ekonomik” të kontratës së lidhur, vendndodhja dhe ekzekutimi ku cilësohet se: “Ekipi i ekspertëve të kontraktorit, do të kryejë detyrën në Tiranë, Republika e Shqipërisë”. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik në SPE, dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik pranë sektorit të financës së AAC, konkludohet se:

-Janë likuiduar sipas pozicioneve dhe ditëve të angazhimit në ambientet e cilësuar në nenin 5 të kontratës së lidhur, ekspertët e huaj si më poshtë:



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

- Për pozicionin “Drejtues Ekipi”, për 36 ditë pune, për ekspertin Moti Dattelkramer, në vlerën e 890 Euro/dita x 36 ditë pune = 38,448 EURO me TVSH.
- Për pozicionin “Auditues Ligjor”, për 36 ditë pune, për ekspertin Keren Korsunsky, në vlerën e 620 Euro/dita x 36 ditë pune = 26,784 EURO me TVSH.
- Për pozicionin “Ekspert Finance & Kontabiliteti”, për 36 ditë pune, për ekspertin Adva Balmas, në vlerën e 590 Euro/dita x 36 ditë pune = 25,488 EURO me TVSH.
- Për pozicionin “Ekspert Finance & Kontabiliteti”, për 36 ditë pune, për ekspertin Asaf Yovel, në vlerën e 590 Euro/dita x 36 ditë pune = 25,488 EURO me TVSH.
- Janë likuiduar në favor të operatorit ekonomik “BA” SHPK, vlera prej 5,760 EURO me TVSH, si vlerë që i përket shpenzimeve të rimbursueshme për “Kosto transporti ndërkombëtar” pa paraqitur boarding pass dhe bileta udhëtimi për të vërtetuar kryerjen e udhëtimeve drejt Tiranës.
- Janë likuiduar në favor të operatorit ekonomik “BA” SHPK, vlera prej 12,960 EURO me TVSH, si vlerë që i përket shpenzimeve të rimbursueshme për “Hotele dhe dieta” për të vërtetuar akomodimin e ekspertëve në Tiranë sipas ditëve të përcaktuara në kontratë.
- Në total, vlera e likuiduar prej 134,928 EURO, në favor të operatorit ekonomik “BA” SHPK, që i përket zërave të preventivit të ofertës (Për ekspertët e huaj) së dhënë nga operatori ekonomik i shpallur fitues konform shtojcës nr. 4 të Dokumentave standarde të Tenderit dhe nenit 37 Shërbimet e Konsulencës të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, pika 4, gërma a), duhet të analizohet nga AAC dhe vetëm nëse nuk vërtetohet me dokumentacion ligjor, atëherë AAC të kërkojë kthimin e shumës së investuar në kundërshtim me rregullat dhe ligjet në fuqi.

Kriteri:

- VKM nr. 914, me ndryshime, neni 37, shërbimet e konsulencës, pika 4, gërma a);
- DST, Shtojca 4 dhe formulari ofertës së dorëzuar, Struktura e propozimit ekonomik;
- Kontrata me nr. 2024/1 prot., datë 23.11.2018, Neni 5, vendndodhja e shërbimeve.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për likuidime pa u vërtetuar më parë, ofrimi i shërbimit të konsulencës.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të LPP-së.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithëshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e investuar nga AAC dhe të përfituar nga operatori ekonomik “BA” SHPK, dhe vetëm nëse nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës, të konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, **arkëtimi i vlerës 134,928 EURO nga operatori ekonomik “BA” SHPK.**

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil z. KK.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/6, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

1. “...keqinterpretimi dhe disinformimi juaj për këtë çështje rrezikon të vendos në vështirësi negociatat e pritshme me TIA.....”;

Oëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se në observacionin tuaj, përveç pretendimeve tuaja verbale me shkresë, nuk keni paraqitur asnjë provë, dokument zyrtar apo shkresë ligjore ku të vërtetohet pretendimi se TIA është në dijeni të rikthimit të 90 Mil Euro për vendosjen e ekuilibrit ekonomik (nëse ka ekzistuar disekuilibri pasi TIA nuk e ka pranuar kurrë, të paktën referuar dokumentacionit në dispozicion). Si rezultat, observacioni juaj për këtë pike, nuk merret në konsideratë.

6.4. “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC”, zhvilluar në vitin 2019 me fond limit 5,514,048 lekë pa TVSH.

6.4.1 Gjetje nga auditimi. Drejtori i AAC, ka lidhur një kontratë me objekt “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC” me “IG” SHA, pa procedurë prokurimi duke shmangur konkurrencën.

Situata: Me shkresën nr. 1023 prot., datë 22.05.2019, drejtori i AAC i dërgon kërkesën për mundësinë e ofrimit të shërbimit me roje të godinës së AAC-së, administratorit të shoqërisë “IG” SHA, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm të MB. Me shkresën nr. 1378 prot., datë 12.07.2019, Drejtori i AAC, nxjerr urdhrin për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit duke u drejtuar tek shoqëria “IG” SHA, për ofrimin e shërbimit si organ i ngarkuar me VKM. Përlllogaritja e vlerës së fondit limit, është kryer nga KK dhe vlera e fondit limit të përlllogaritur është 5,514,048 lekë pa TVSH. Në vazhdim, është nënshkruar kontrata me objekt “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC”, në datën 17.07.2019 midis AAC me përfaqësues KK dhe “IG” SHPK me përfaqësues administratorin HE. Vlera e kontratës është 6,616,857 lekë me TVSH me afat 1 vit nga data e lidhjes. Si rezultat, Drejtori i AAC KK, ka nënshkruar një kontratë pa ndjekur hapat konform ligjit dhe rregullave të prokurimit publik duke vendosur vetë për përzgjedhjen e operatorit/shoqërisë që do të ofrojë shërbimin e ruajtjes së godinës së AAC dhe duke nënshkruar një kontratë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Vlera e kontratës së lidhur pa TVSH është 5,514,048 lekë vlerë e cila krahasuar me kontratën e mëparshme me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat kushte, është 3,344,857.7 lekë më e lartë. Për arsye se deri në këto momente, nuk u konstatua asnjë likuidim në favor të shoqërisë “IG” SHPK, grupi i auditimit nuk mund të shprehet për ndonjë vlerë të shpenzuar me efekt negativ financiar për AAC.

Kriteri:

-Ligji nr.10233, datë 11.2.2010, Për autoritetin e aviacionit civil, i ndryshuar, neni 17, Të ardhurat e AAC, pika 5, ku cilësohet se:

-Ligji nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 1, Objektiviteti, ku cilësohet se:

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa për shpenzime në kundërshtim me ligjin e AAC.

Shkaku: Mosveprim i strukturave të AAC, sipas kërkesave të ligjit nr.10233, datë 11.2.2010, “Për autoritetin e aviacionit civil”, i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa, që në të ardhmen, të nënshkruhen kontrata vetëm me ata operatorë ekonomikë që janë shpallur fitues nga një procedurë prokurimi në konformitet të plotë me ligjin e AAC dhe të prokurimit publik.

Afati: Në vazhdimësi.

Sa më sipër, mban përgjegjësi: Drejtori i AAC z. KK.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/16, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

1. “...pretimi dhe disinformimi juaj për këtë çështje rrezikon të vendos në vështirësi negociatat e pritshme me TIA.....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se është e cilësuar në mënyrë eksplicite tek Ligji nr.10233, datë 11.2.2010, Për autoritetin e aviacionit civil, i ndryshuar, neni 17, Të ardhurat e AAC, pika 5, ku cilësohet se: “**AAC PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË VETA, ZBATON DISPOZITAT LIGJORE DHE NËNLIGJORE NË FUQI PËR PROKURIMET PUBLIKE**”. Si rezultat, observacioni juaj për këtë pike, nuk merret në konsideratë.

7 Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël.

7.1 Titulli i Gjetjes: Shpenzime pa dokumentacionin e duhur ligjor.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi senë 32 raste shpenzimet e kryera për përballimin e shpenzimeve të punonjësve për shërbimet e udhëtimit jashtë vendit, faturat e hotelit të paraqitura nga punonjësit, janë pa vullë vërtetuese të subjektit i cili e ka lëshuar, çka bën që dokumentacioni i paraqitur të mos e justifikojë shpenzimin në shumën 24,601 euro.

Kriteri:

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar;

-VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”;

-Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi: Dëm ekonomik.

Shkaku: Mos respektimi legjislationit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, në koordinim me Këshillin Drejtues, të shqyrtojnë shumën 24,601 euro cilësuar si dëm ekonomik, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në pagesat e kryera me bankë për përballimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë vendit si dhe të plotësohen këto praktika me dokumente justifikuese në të ardhmen.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Afati: Menjëherë.

Sa më sipër, mban përgjegjësi: Drejtori Ekzekutiv z.KK, ish-përgjegjësi i sektorit të financës dhe buxhetit z.FG dhe përgjegjësi i sektorit të financës dhe buxhetit aktual.

7.2 Titulli i Gjetjes: Shpenzime të pajustificuara.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës, për kryerjen e shpenzimeve rezultoi se:

Me urdhër transfertën bankare të datës 23.11.2018, është likuiduar fatura tatimore nr. 32, datë 30.10.2018, për gërmime dheu, ndaj operatorit “Kola-B.M.E.” ShPK., në vlerën 66,000 lekë me TVSH, faturë e cila është nënshkruar nga vetë Drejtori Ekzekutiv dhe komisioni i blerjeve të vogla. Është mbajtur procesverbal nga z.KK, znj.Kejda Koshaj dhe z.Piro Rroga më datë 30.10.2018, në të cilin citohet se “...pas kontaktit me përfaqësues të Kryeministrisë të cilët kërkuan nga AAC-ja, në rolin e palës negociatore të asistojë ekspertët turq të Cengiz Holding Group si dhe të mbulojnë shpenzimet e verifikimit të përbërjes gjeologjike të tokës ku do të ndërtohet Aeroporti i Vlorës, nëse është në përputhje me të dhënat e fizibilitetit të Aeroportit të Jugut”. Ky shpenzim është i pa justifikuar pasi nuk ka asnjë dokumentacion vërtetues dhe justifikues, nuk ka asnjë kërkesë zyrtare për këtë veprim, nuk ka asnjë dokument për vendin ku është kryer verifikimi, nuk ka asnjë dokumentacion mbi planimetrinë, skicat apo vizatime për kryerjen e këtyre punimeve, nga të cilat dalin sasitë dhe volumet e punimeve.

Kriteri: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5, me ligjin nr. 10296, datë 10.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenet 2, 3, 8/1, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35/a/b, pika 36, pika 56.

Ndikimi: Dëm ekonomik.

Shkaku: Mos respektimi legjisllacionit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të kërkojnë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës 66,000 lekë, nga Drejtori i AAC z. KK.

Afati: Menjëherë.

Sa më sipër, mban përgjegjësi: Drejtori i AAC-së z.KK.

7.3 Titulli i Gjetjes: Shpenzime të kryera jo në përputhje me parimet e 3-E.

Situata: Me shkresën nr. 275 prot., datë 07.02.2019 është lëshuar Urdhër i brendshëm për kryerjen e procedurës të prokurimit me vlerë të vogël “Për blerje letër murale për ambient zyre”, me fond limit deri në vlerën 100,000 lekë. Kjo procedurë ka nisur bazuar në memon e bërë datë 07.01.2019 nga znj.KG, në të cilën citohet se në kuadrin e përgatitjes së ambienteve të zyrave të reja pranë TBP. Është e nevojshme planifikimi dhe arredimi i zyrave të administratës dhe për këtë arsye është e nevojshme dekorimi i një prej ambienteve me letër murale e cila duhet të jetë ekologjike dhe antibakteriale me përmasat 785cm*325cm dhe të jetë e printuar me bojë ekologjike. Me datë 08.02.2019 është mbajtur procesverbali nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe karakteristikat e letrës murale. Komisioni është drejtuar 3 operatorëve ekonomikë dhe ka mbajtur procesverbalin më datë 08.02.2019, duke përcaktuar si ofertë fitues operatorin ekonomik “KN”(person fizik), me vlerën e ofertës 65,000



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

lekë pa TVSH. Me datë 14.05.2019 nga AP është përcjellë për pagesë praktika ndaj sektorit të financës për likuidimi n e kësaj procedure. Është kryer likuidimi i faturës nr. 86, datë 08.02.2019, ndaj këtij operatori me transaksionin bankar, më datë 28.02.2019 në shumën 78,000 lekë. Letra është bërë hyrje në magazinë me FH nr. 7, datë 08.02.2019, dhe është bërë dalje me FD nr. 26, datë 08.02.2019. Ky shpenzim konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e AAC-së pasi, këto ambiente nuk janë marrë e vënë në funksion dhe AAC nuk ka ushtruar asnjëherë aktivitetin e saj në TBP, çka do të thotë se është një shpenzim i pa nevojshëm për ushtrimin funksional të institucionit.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenin 2, 3 e 8/1.

Ndikimi: Efekt financiar negativ në shumën 78,000 lekë.

Shkaku: Papërgjegjshmëri e Drejtimit të AAC.

Rëndësia: E ulët.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të marrin masa, që në të ardhmen, të mos kryhen investime në kundërshtim me parimet e ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në administrimin e fondeve publike.

Afati: Në vazhdimësi.

Sa më sipër, mban përgjegjësi: Drejtori i AK z.KK.

7.4 Titulli i Gjetjes: Shkelje të procedurave të prokurimit për blerjet me vlera të vogla.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit për procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla rezulton se, në të gjitha rastet e audituara procesverbalet e mbajtura nga komisioni i prokurimit, për procedurat blerje me vlera të vogla, të kryera me mjete elektronike, në lidhje me vijueshmërinë e kalimit nga operatori i renditur në vendin e parë dhe deri në përcaktimit të ofertës fituese, si dhe procesverbalet e mbajtura në procedurat e prokurimit për rastet emergjente, përcjelljet e praktikave për pagesë tek sektori i financës, nuk janë të protokolluara.

Kriteri: Ligji n nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 2, 3 e 8/1; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregulla të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 4 pika 1, neni 40 pika 1, 3 dhe 8, neni 57 pika 2 dhe 3, neni 64 pika 2, neni 77 pika 3; Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, neni 7 dhe 19; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi: Procedurat e prokurimit paraqesin një shmangie apo neglizhencë, duke mos respektuar rregullat e procedurave të Prokurimit Publik.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mosrespektimit të legjislacionit, nga komisioni i prokurimit të blerjeve me vlera të vogla.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që:*

-Në hartimin e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve, për të njëjtin grupmallrash apo shërbimesh;



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

- Përpara fillimit të procedurave të prokurimit me vlera të vogla, të argumentojnë dhe dokumentojnë nevojat e institucionit për mallra e shërbime;
- Për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve, komisionet të përbëhen nga specialistë të fushës;
- Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen sipas përcaktimeve ligjore,
- Për çdo procedurë, të hartohen deklaratat e konfliktit të interesit;
- Të gjitha aktet e hartuara në lidhje me procedurat e prokurimit, të kalojnë përmes arkivës së institucionit, me qëllim evidentimin e rrjedhshmërisë së veprimeve.

Afati: Në vazhdimësi.

Sa më sipër, mban përgjegjësi: Drejtori i AAC z.KK, përgjegjësjë e prokurimeve znj.AP dhe anëtarët e komisionit z.AN e z.OA.

7.5 Titulli i Gjetjes: Mangësi dokumentacioni në zhvillimin e procedurës “Blerje vegla pune për Aeroportin e Kukësit”.

Situata: Me shkresën nr. 62 prot., datë 09.01.2018 Drejtori i Aeroportit të Kukësit i drejtohet Drejtorit Ekzekutiv të AAC-së, kërkesë për vegla pune bashkëngjitur ndodhet lista dhe preventivi i këtyre veglave. Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor nuk ka nxjerrë urdhër prokurimi, për zhvillimin e kësaj procedure. Nga operatori ekonomik “HD” është lëshuar fatura e thjeshtë tatimore model 4, nr. 21, datë 31.08.2018 likuiduar me transaksionin bankar më datë 10.09.2018 në shumën 83,300 lekë. Për këtë procedurë konstatohet se nuk disponohet urdhër për ngritjen e grupit të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara në Aeroportin të Kukësit. Mallrat janë bërë hyrje në magazinën e Autoritetit të Aviacionit Civil me FH nr. 38, datë 31.08.2018 dhe dalje me FD nr. 125, datë 31.08.2018. Nga inventarizimi i dosjes së kësaj procedure prokurimi rezulton se konstatohet një procesverbal i pa protokolluar i cili është mbajtur në Aeroportin e Kukësit për marrjen në dorëzim të materialeve të furnizuara. Dokumentacioni i zhvillimit të kësaj procedure nuk justifikon shpenzimin e kryer.

Kriteri: Pika 6, e Udhëzimit nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar dhe pika 42, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” i ndryshuar.

Ndikimi: Mangësia e dokumentacionit në zhvillimin e kësaj procedure, nuk justifikon shpenzimin e kryer.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mosrespektimit të legjislacionit, nga Drejtori Ekzekutiv.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masat, që për procedurat e prokurimit me vlera të vogla, të plotësohet dokumentacioni vërtetues i kryerjes së procedurës, në mënyrë që të justifikohet shpenzimi i kryer.

Afati: Në vazhdimësi.

Sa më sipër, mban përgjegjësi: Drejtori i AAC z.KK.

7.6 Titulli i Gjetjes: Mos kryerje kontrolli për dokumentimin e shpenzimeve të karburantit.

Situata: Nga auditimi i shpenzimeve dhe konsumit të karburantit referuar verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se:



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

-Për automjetet që disponon AAC rezulton se nuk kanë kartela përkatëse, në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to ku, gjithashtu duhet të jetë evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime të cilat nuk mund të përlloragiten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

-Në varësi të konsumit të karburantit, të vendosur nga një komision i posaçëm, sasia e tërhequr nuk përputhet me kilometrat e përshkuara dhe nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës. Nga verifikimi dhe llogaritja e të dhënave të dokumentacionit rezulton se, janë tërhequr më tepër 6,270 litra benzinë në vlerën 970,118 lekë dhe 1,367 litra naftë në vlerën 221,090 lekë, të cilat nuk janë të plotësuar më dokumentacion. Nga ana e administrimit të AAC, Drejtori ekzekutiv në cilësinë e titullarit të njësisë publike e nëpunësit autorizues, drejtori i financës dhe buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe përgjegjësi i sektorit e caktuar për menaxhimin e aktiveve rezulton se, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të AAC-së, nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit.

Kriteri:

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

-Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 5 - 10, pika 35 dhe pika 36.

Ndikimi: Efekt financiar negativ në shumën 1,191,208 lekë.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mosmbajtjes të kartelave përkatëse të automjeteve dhe moskryerjes së kontrollove periodike mbi konsumin e karburantit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrë masat, për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të tij. Nga sektori i financës dhe buxhetit, të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

Afati: Në vazhdimësi.

Sa më sipër, mban përgjegjësi: Drejtori i AAC KK, FG dhe ED në cilësinë e nëpunësit zbatues, AP në cilësinë e mbikëqyrjes dhe menaxhimit të aktiveve, sipas periudhave respektive të konsumit të karburantit.

Observacion:

Pretendimi i subjektit: Nga z. KK, është paraqitur observacioni me nr. 2047/16, datë 15.11.2019, ku në mënyrë të përmbledhur, cilësohet se:

1. “...pretimi dhe disinformimi juaj për këtë çështje rrezikon të vendos në vështirësi negociatat e pritshme me TIA.....”;

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Nga grupi i auditimit, gjykohet se është e cilësuar në mënyrë eksplicite tek Ligji nr.10233, datë 11.2.2010, Për autoritetin e aviacionit civil, i ndryshuar, neni 17, Të ardhurat e AAC, pika 5, ku cilësohet se: “AAC PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË VETA, ZBATON DISPOZITAT LIGJORE DHE NËNLIGJORE NË FUQI PËR PROKURIMET PUBLIKE”. Si rezultat,



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

observacioni juaj për këtë pike, nuk merret në konsideratë.

8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

8.1 Titulli i gjetjes: Mangësi në menaxhimin e riskut.

Situata: Autoriteti i Aviacionit Civil nuk ka hartuar strategjinë e riskut. Për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që kanë në menaxhimin e riskut. Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatis raporte vjetore mbi problematikat e hasura. Për vitin 2018 nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive. Pra, nuk ekziston një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të risqeve, ku të adresohen personat përgjegjës për çdo risk. Për vitin 2019 konstatohet se ka një regjistër risku ku janë të hedhuara risqe të cilat janë adresuar nga drejtoritë përkatëse, është bërë dhe vlerësimi i tyre. I vetmi risk i hasur mangësia e burimeve njerëzore. Në këtë regjistër risku nuk janë të evidentuara objektivat, risku para kontrollit, risqet pas kontrollove, nevojat për kontrole të mëtejshme, masat për uljen e riskut, veprime për të autorizuar këto boshlliqe, zotëruesi i riskut, ndryshimet në risk që nga detyra e fundit jo sipas standartit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Kriteri:

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar;

-Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike”.

Ndikimi:Mund të shkaktojë premisa, për vënien e institucionin përball risqeve të mundshme.

Shkaku: Mos implementimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masat e duhura për hartimin e strategjisë së riskut, ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe krijimin e regjistrit të riskut sipas përcaktimeve ligjore, si dhe të marrë masat e duhura për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditit, në përputhje me kuadrin rregullativ ligjor.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, mban përgjegjësi: Drejtori i AACz. KK.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

8.2 Titulli i gjetjes: Mangësi në aktivitet e kontrollit.

Situata: Nëpunësi Autorizues i njësive publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjithë njësitet, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës. Duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuara të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit, pjesë e saj të jetë dhe përgatitja e gjurmës së auditit. Gjurma e auditit, përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare, prokurimeve dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të përshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil nuk ka nxjerrë urdhër, për hartimin e gjurmës së auditit, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme. Gjurma e auditit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumentave që përmban një proces.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, i ndryshuar.

Ndikimi: Mund të shkaktojë premisa, për evidentimin e risqeve nga institucioni.

Shkaku: Mos implementimi dhe hartimi i gjurmës së auditit.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Autoriteti i Aviacionit Civil të marrë masat e duhura për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditit, në përputhje me kuadrin rregullativ ligjor.

Afati: Në vazhdimësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, mban përgjegjësi: Drejtori i AAC z. KK.

VI GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se, Vendimi i KD nr. 80, datë 21.12.2017, për krijimin e një fondi rezervë të AAC prej 107,000,000 lekë, është në kundërshtim me nenin 18, pika 3 i Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010, “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, i cili nuk parashikon mbajtjen e një fondi rezervë për Autoritetin.

-Shuma e gjendur në llogaritë e AAC pas muajit mars 2018, është në vlerën **181,846,000 lekë**.

-Shuma e gjendur në llogaritë e AAC pas muajit mars 2019, është në vlerën **279,917,654 lekë**.

Gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare rezultoi se, fitimi neto i vitit 2018 paraqitet në shumën 98,071,375 lekë dhe fitimi i vitit të mëparshëm paraqitet në shumën 51,189,279 lekë. Këto të ardhura në vlerën totale 149,260,654 lekë përbëjnë tepricat e mbetura në fund të viteve buxhetore, të cilat duhet të derdheshin në Buxhetin e Shtetit. Në lidhje me këtë konstatim, nga strukturat drejtuese të AAC, nuk janë marrë masa për kalimin e këtyre fondeve për llogari të Buxhetit të Shtetit, duke i mbajtur ato në llogari rrjedhëse të institucionit, në bankat e nivelit të dytë, në mospërputhje me Ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, neni 18, pika 3. Kjo situatë (fakt) është konstatuar edhe nga



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

auditimet e mëparëshme, por përsëri rezultojnë se AAC nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, si detyrim ligjor. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 25 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 1.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masat, për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të shumës prej 149,260,654 lekë, të konstatuara të pa derdhura për vitin 2017 dhe vitin 2018. Gjithashtu nga AAC të merren masat për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të detyrimeve të mbajtura në llogari të institucionit, që janë jo vetëm të periudhës së auditimit por, të akumuluar nga vitet e mëparëshme të cilat sëbashku me vlerën e mësipërme në total shkojnë në shumën 279,917,654 lekë.*

Menjëherë

Rekomandimi 1.2: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, pas muajit mars të vitit pasardhës, të arkëtojnë në buxhetin e shtetit shumën e detyrimit ligjor.*

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: AAC ka shpenzuar nga humbja e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimi i detyruar i titujve ekzekutivë në total për periudhën 20 mujore të auditimit 6,112,547 lekë gjithsej, të ndarë në dy periudhat e ndryshme vjetore përkatësisht në 528,396 lekë (viti 2018) dhe 5,584,151 lekë (8 muajt e parë të vitit 2019). *(Trajtuar më hollësisht në faqen 22 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 2.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa, që në të ardhmen të mos i shkaktojnë Autoritetit efekte negative financiare nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës me punonjësit, prej mos respektimit me kujdes të të gjitha kriterëve ligjore në fuqi.*

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me Vendimin nr. 10, datë 31.07.2018, me anë të të cilit, Këshilli Drejtues i AAC miraton ndryshimet në programin ekonomik për vitin 2018 duke shtuar zërin investime në vlerën 23,300,000 lekë për pagesën e konsulentit të kompanisë “RB” GMBH, i cili do të asistojë për negocimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe shoqërive Çengiz Construction & Kalyon & Kolin Construction, sipas shkresës së MIE me nr. 8607/1 prot., datë 20.06.2018. Në relacionin e drejtorit të AAC bashkangjitur vendimit të KD, cilësohet se: *“...Duke patur parasysh që pagesa e këtij shërbimi nuk është parashikuar në programin buxhetor të MIE dhe duke qënë se AAC është pjesëmarrëse në këtë proces, përcaktohet se ky i fundit do të paguajë vlerën e kontratës prej 152,600 Euro pa TVSH”. Nga Auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me likuidimet e kryera nga AAC në llogari të Konsulentit “RB” GMBH, u konstatua se:*

a). Likuidimi i vlerës së paradhënies prej 76,300 Euro sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 10.08.2018 sipas urdhër xhirimit të Union Bank, dega Garda me kod 1114, nga llogaria bankare e AAC në lekë me nr. AL87214111060111320616030129 në llogarinë bankare të “RB” GMBH në Deutsche Bank, Munchen. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

08.08.2018. Fatura mban firmën e Konsulentit, ka të specifikuar arsyen e pagesës “Paradhënie” dhe vlerën e saj prej 76,300 Euro.

b). Likuidimi i vlerës së dytë prej 76,300 Euro, pagesë finale sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 25.07.2019 sipas urdhër xhimit të BKT, dega me kod 505, nga llogaria bankare e AAC në Euro me nr. 401612629 në llogarinë bankare të “RB” GMBH në Deutche Bank, Munchen. Bashkangjitur urdhër xhimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura për pagesën finale, është me të njëjtën datë me faturën për pagesën e paradhënies. Pra, nuk vërtetohet se operatori e ka lëshuar faturën pasi ka përfunduar kryerjen e shërbimit. Në dokumentacionin e dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë shërbimet e kryera nga Konsulenti në përputhje me pikën 6.1 të kontratës së lidhur. Si rezultat, vlera e investuar nga AAC prej 152,600 euro, nuk është e justifikuar me dokumenta dhe fakte sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. (Trajtuar më hollësisht në faqen 59-60 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 3.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori Financës dhe Buxhetit, të marrin masat që në të ardhmen, përpara kryerjes së pagesave për “Shërbimet e Konsulencës”, të plotësojnë dokumentacionin financiar sipas kriterëve të vendosura në DST dhe kontratë duke dokumentuar shpenzimet e drejtpërdrejta dhe ato të rimbursueshme, konform grafikut të miratuar.

Në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 1208 prot., datë 27.06.2018, Titullari i AAC, nxjerr urdhrin e prokurimit me objekt: “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s” të llojit “Shërbim Konsulencë”, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH. Në fakt, fondi limit i përcaktuar nga grupi i përlllogaritjes së kësaj vlere, sipas procesverbalit të mbajtur për termat e referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit në datën 18.06.2018, është 29,029,513.12 lekë pa TVSH. Pra Drejtori i AAC, ka urdhëruar kryerjen e procedurës së prokurimit me një fond limit për të cilin nuk është kryer asnjë testim tregu dhe që është 513,328.16 lekë më i lartë se fondi i miratuar nga grupi i përlllogaritjes së tij. Fondi limit i përlllogaritur nga grupi i ngritur, nuk është marrë në konsideratë nga Drejtori i AAC, duke përcaktuar fondin limit në urdhrin e prokurimit pa ndjekur hapat e përcaktuara në ligj, aktet nënligjore dhe rregullat e prokurimit publik. (Trajtuar më hollësisht në faqen 41-42 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 4.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, urdhrat e prokurimit, në përcaktimin e vlerës së fondit limit, ti referohen vlerës së përlllogaritur nga grupi i përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, me qëllim shmangien e praktikave formale.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt “Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO”, është iniciuar për herë të parë me urdhrin e prokurimit nr. 698 prot., datë 28.03.2018. Në vazhdim, është anuluar për arsye se 2 (dy) ofertat e ardhura kanë pasur mangësi në dokumentacionin e dorëzuar. Pas anulimit, procedura e prokurimit, me të njëjtin objekt, është rishpallur sipas urdhrin të prokurimit nr. 1261 prot., datë 05.07.2018. Nga auditimi i dokumentacionit të publikuar në SPE nga AAC, u konstatua se:

-Dokumentat standarte të tenderit të shpallur për herë të parë, me nr. REF-62681-04-16-2018, nuk janë identike me ato të hedhura në SPE për procedurën e përsëritur (rishpallur) me nr. REF-



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

78854-07-11-2018. Konkretisht, duke krahasuar DST nr. REF-78854-07-11-2018 (hera e dytë) me DST nr. REF-62681-04-16-2018 (hera e parë), konstatohet se kanë ndryshim kriteret e vendosura. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 30-31 të Raportit Përfundimtar).*

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik i shpallur fitues “TC” SHPK, u konstatuan mangësi lidhur me formularin e ofertës dhe kriteret e kualifikimit të cilat nuk ishin konform atyre të cilësuar në DST. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 31-32 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 5.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, për procedurat e prokurimit të anuluar, të analizojnë shkaqet e dështimit të procedurës së prokurimit duke reflektuar ndryshimet në dokumentat standarte të tenderit, me qëllim rritjen e konkurrencës.*

Rekomandimi 5.2: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa që në të ardhmen, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, të kualifikojnë vetëm ata Konsulentë, oferta e të cilëve, plotëson kërkesat e ligjit për “Shërbimet e Konsulencës” dhe kriteret e vendosura në DST.*

Në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, Titullari i institucionit, ka nxjerr urdhrin me nr. 762 prot., datë 17.04.2019, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 567 prot., datë 30.05.2019, grupi i ngritur, për justifikimin e blerjes së dy automjeteve tip “Hibrid”, i është referuar ligjit nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”. Kjo shkresë, i drejtohet Drejtorit të AAC i cili e ka nënshkruar me shënimin të veprohet “*Sipas propozimit dhe ligjit*”. Grupi i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike, nuk ka në përbërje të tij specialiste me profesion jurist. Profesionet e antarëve të grupit të hartimit të specifikimeve teknike, janë inxhinier dhe ekonomist. Pra gjykimi për vendosjen e bazës ligjore në këtë procedurë, i takon njësisë së prokurimit e cila ka në përbërje të saj, specialiste me profesion jurist. Ligji i përmendur në procesverbalin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike, ka si objekt veprimtarie përcaktimin dhe vendosjen e vlerave kufi, pragut të alarmit, pragut të informacionit dhe vlerave të synuara për disa lloje ndotësish në ajër, të listuar në aneksin I, bashkëlidhur këtij ligji. Referuar anekseve të ligjit të mësipërm, konstatohet se ky ligj, ka si qëllim, monitorimin e cilësisë së ajrit nga institucionet përkatëse duke mbledhur informacione sipas zonave lokale, rajonale ose kombëtare me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Pra, ky ligj, nuk i referohet në asnjë rast Autoriteteve Kontraktore duke i detyruar ato që në blerjen e mallrave ti referohen atij dhe jo ligjit të prokurimit publik, sidomos në blerjen e automjeteve ku institucioni përgjegjës për kontrollin e shkarkimeve në atmosferë të automjeteve, është Societe Generale de Surveillanc ose shkurt SGS. Për më tepër, operatorët ekonomik që kanë në aktivitetin e tyre, shitjen e mjeteve të transportit, janë të detyruar që për çdo mjet të ri, të respektojnë standardet teknike të kufijve të lejuar të gazrave që shkarkojnë në atmosferë automjetet gjatë funksionimit të tyre. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 35 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 6.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, në kryerjen e procedurave të*



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

prokurimit, ti referohen ligjit të prokurimit publik me qëllim rritjen e efikasitetit, për të nxitur pjesëmarrjen dhe konkurrencën.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 777 prot., datë 16.04.2018, Organi Shtetëror i Autorizuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga Ministri z. DG dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë e përfaqësuar nga Ministri z. AA, i dërgojnë Drejtorit të AAC z. KK, një kërkesë “Mbi mbulimin e shpenzimeve të këshilltarit financiar të kualifikuar, në kuadër të rishikimit të pavarur ekonomik të kontratës koncesionare me TIA SHPK” tek e cila midis të tjerash kërkohet mbulimi i kostove të vlerësimit të pavarur nga një këshilltar i përshtatshëm financiar i kualifikuar duke e urdhëruar AAC që procedura e përzgjedhjes, duke përfshirë edhe njoftimet e nevojshme të ndiqen nga AAC në përputhje me legjislacionin në fuqi. Referuar Ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004 Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “Tirana Airport Partners”, SHPK, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljve kësaj shoqërie koncesionare”, Organi Shtetëror i Autorizuar nga Qeveria Shqiptare (MIE dhe MFE), sipas nenit 8 të kontratës koncesionare, është palë në kontratën koncesionare me koncesionarin “Tirana Airport Partners”, SHPK dhe asnjë institucion apo organ tjetër nuk është i autorizuar për mbulimin e kostove e sidomos të rishikimit të pozicionit ekonomik të koncesionit sipas klauzolës nr. 19.4, pika (a) të kontratës koncesionare ku përcaktohet se kostoja e një vlerësimi të tillë (Rishikimi i Pavarur) i ngarkohet palës që e kërkon një Rishikim të tillë të Pavarur. Për më tepër referuar dhe nenit 34 të kontratës koncesionare lidhur me konfidencialitetin apo nenit 37.15 lidhur me të drejtat e palëve, asnjë palë tjetër nuk mund të ketë akses në asnjë dokument apo pjesë që ka lidhje me kontratën koncesionare pa miratimin e palëve nënshkruese të kontratës. Organi Shtetëror i Autorizuar (MIE dhe MFE) duhej të mbulonin vetë koston për një rishikim të pavarur të kontratës koncesionare dhe jo të kërkonin mbulimin e koston nga AAC. Mbulimi i shpenzimeve në këtë rast e kthen institucionin e AAC-së në rolin e një banke financuese që jep grante, duke sjellë rritje të shpenzimeve për institucionin. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 37-38 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 7.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të marrin masat që në të ardhmen, të analizojnë kërkesat e ardhura nga MIE dhe të konsiderohen të rregullta, vetëm nëse ato janë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.*

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Rishikimi i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare të TIA”, u konstatua se:

-Procedura e prokurimit me objektin e mësipërm, nuk ka qenë e parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për AAC në vitin 2018, regjistër i cili është miratuar në programin ekonomik financiar nga Këshilli Drejtues i AAC me vendimin nr. 80, datë 21.12.2017, nr. 352 prot. Ndryshimet e programit ekonomik financiar të vitit 2018, janë miratuar me vendimin nr. 6, datë 24.05.2018, nr. 22 prot., tek i cili është shtuar nënçëri “Konsulencë vlerësim i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare TIA” tek zëri Aktive të



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

patrupëzuara. Në vazhdim, regjistri i prokurimeve publike për vitin 2018 me ndryshimet e tij, është reflektuar në APP, në datën 26.06.2018. Kjo në fakt, duhej të ishte data, pas së cilës, AAC mund të ndërmerre ndonjë veprim për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit të shtuar në regjistër pas ndryshimeve të miratuara nga Këshilli Drejtues i AAC. Drejtori i AAC, ka filluar procedurën për përgatitjen e specifikimeve teknike duke lidhur edhe një kontratë me një ekspert të jashtëm në funksion të procedurës së prokurimit me objekt “Konsulencë vlerësim i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare TIA”, pa u miratuar më parë nga Këshilli Drejtues dhe APP. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 39 të Raportit Përfundimtar).*

-Procedura e prokurimit me objektin e mësipërm, lloji “Shërbim Konsulencë”, është iniciuar dhe anuluar dy herë radhazi. Konkretisht, është iniciuar për herë të parë me urdhrin e prokurimit nr. 1208 prot., datë 27.06.2018 dhe është anuluar për mungesë konkurrence. Është iniciuar përsëri me të njëjtin objekt dhe lloj procedure sipas urdhrin të prokurimit me nr. 1330 prot., datë 17.07.2018 dhe është anuluar përsëri për mungesë konkurrence. Njësia e prokurimit nuk ka analizuar/rishqyrtuar asnjë kriter të vendosur në DST por është shprehur në procesverbalet e mbajtura për të dyja anulimet me të njëjtin tekst, pra që nuk ka konkurrencë. Njësia e prokurimit, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të rritur konkurrencën por pa asnjë analizë dhe propozim të ndonjë ndryshimi në kriteret e kualifikimit, ka propozuar rishpalljen e të njëjtave kriteret që nuk dhanë asnjë rezultat dy herë radhazi si pasojë e mungesës së konkurrencës. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 44-45 të Raportit Përfundimtar).*

-Gjatë zbatimit të kontratës (së procedurës së mësipërme) nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018 të lidhur midis palëve, u konstatuan vonesa jashtë afateve të përcaktuara sipas nenit 4 të kontratës së lidhur. AAC, në datën 20.12.2018, datë në të cilën duhej të përfundonte kontrata bazë, ka lidhur një kontratë shtesë duke e zgjatur afatin e kontratës bazë me 15 ditë pune ose me datë përfundimi datën 15.01.2019. Operatori ekonomik “BA” SHPK, ka dorëzuar raportin përfundimtar me 15 ditë vonesë referuar afateve të kontratës bazë. Zgjatja e afatit të kontratës bazë, sipas amendamentit nr. 1609/15 prot., datë 20.12.2018, ka ardhur si rezultat i vonesave të dorëzimit të dokumentacionit nga TIA. AAC, referuar nenit 6 të kushteve të veçanta të kontratës bazë *(Në pikën 6 të termave të referencës, përcaktohet se “AK duhet të marrë masat për paisjen e kontraktorit me dokumentacionin, raportet dhe informacionet e nevojshme që lidhen me përmbushjen e misionit”)*, duhej të merrte masat që brenda 3 ditëve nga data e lidhjes së kontratës bazë pra nga data 15.10.2018, të vinte në dispozicion të operatorit ekonomik, dokumentacionin dhe informacionet përkatëse për fillimin e zbatimit të kontratës me objekt “Rishikimi i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare”. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 47 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 8.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, procedurat e prokurimit të paparashikuara, të fillojnë vetëm pasi të merret miratimi përkatës nga KD e në vazhdim, publikimi i regjistrin të ndryshuar të parashikimeve të procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.*

Rekomandimi 8.2: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa që në të ardhmen, për procedurat e prokurimit të anuluar, të analizojnë shkaqet e dështimit të procedurës së prokurimit duke reflektuar ndryshimet në dokumentat standarte të tenderit, me qëllim rritjen e konkurrencës.*



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Rekomandimi 8.3: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, të respektohen kriteret e vendosura në DST dhe në kontratë dhe që kanë të bëjnë me afatet e ekzekutimit të shërbimit, me qëllim që ti paraprihet vonesave të paparashikuara të ekzekutimit të kontratave.*

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi. Me shkresën nr. 1023 prot., datë 22.05.2019, drejtori i AAC i dërgon kërkesën për mundësinë e ofrimit të shërbimit me roje të godinës së AAC-së, administratorit të shoqërisë “IG” SHA, për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm të MB. Me shkresën nr. 1023/1 prot., datë 06.06.2019, “IG” SHA, i dërgon përgjigje Drejtorit të AAC duke cilësuar se shoqëria, do të jetë gati për ofrimin e shërbimit të ruajtjes fizike të godinës së AAC, në datën 15.06.2019. Me shkresën nr. 1378 prot., datë 12.07.2019, Drejtori i AAC, nxjerr urdhrin për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit duke u drejtuar tek shoqëria “IG” SHA, për ofrimin e shërbimit si organ i ngarkuar me VKM. Përlllogaritja e vlerës së fondit limit, është kryer nga KK dhe vlera e fondit limit të përlllogaritur është 5,514,048 lekë pa TVSH. Në vazhdim, është nënshkruar kontrata me objekt “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC”, në datën 17.07.2019 midis AAC me përfaqësues KK dhe “IG” SHPK me përfaqësues administratorin HE. Vlera e kontratës është 6,616,857 lekë me TVSH me afat 1 vit nga data e lidhjes. Si rezultat, Drejtori i AAC KK, ka nënshkruar një kontratë pa ndjekur hapat konform ligjit dhe rregullave të prokurimit publik duke vendosur vetë për përzgjedhjen e operatorit/shoqërisë që do të ofrojë shërbimin e ruajtjes së godinës së AAC dhe duke nënshkruar një kontratë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Vlera e kontratës së lidhur pa TVSH është 5,514,048 lekë vlerë e cila krahasuar me kontratën e mëparshme me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat kushte, është 3,344,857.7 lekë më e lartë. Për arsye se deri në këto momente, nuk u konstatua asnjë likuidim në favor të shoqërisë “IG” SHPK, grupi i auditimit nuk mund të shprehet për ndonjë vlerë të shpenzuar me efekt negativ financiar për AAC por, efekti i mundshëm është sa diferenca e vlerave midis dy kontratave. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 51-52 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 9.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa, që në të ardhmen, të nënshkruhen kontrata vetëm me ata operatorë ekonomikë që janë shpallur fitues nga një procedurë prokurimi në konformitet të plotë me ligjin e AAC dhe të prokurimit publik.*

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit rezultoi se; inventarizimi i aktiveve të Aeroportit të Kukësit për vitin 2018 është bërë në aspektin sasior pa vlerat kontabël përkatëse të tyre. Ky konstatim është evidentuar edhe nga auditimet e mëparshme por përsëri rezulton se nuk është kryer asnjëherë një vlerësim i asetëve të tij. Pas relacionit të hartuar nga komisioni përkatës i cili ka kryer procesin e inventarizimit, nga titullari i AAC nuk ka asnjë vendimmarrje për vlerësimin e tyre, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, neni 57. Gjithashtu vlen të përmendet që ky Aeroport është dhënë me konçension dhe asetet e tij janë dorëzuar në numër por pa vlerat përkatëse kontabël. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 26 të Raportit Përfundimtar).*



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Rekomandimi 10.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masat e duhura që aktivet e Aeroportit të Kukësit, të vlerësohen dhe të evidentohen me vlerën e duhur në kontabilitet në të ardhmen pasi, aktualisht ky aeroport është dhënë me konçension.*

Në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare për vitin 2018 rezultoi se, Autoriteti i Aviacionit Civil, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, i cili në varësi të llojit duhet të përmbajë kërkesat minimale në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 27 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 11.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masat e duhura për krijimin dhe përditësimin e regjistrit të aktiveve të AAC, në përputhje me kuadrin regullativ ligjor.*

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të kryerjes së procesit të inventarizimit për vitin 2018, rezultoi se, në komisionin e ngritur nga Titullari i AAC në cilësinë e nëpunësit Autorizues, janë caktuar nëpunës të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë nënshkruar në kushtet e konfliktit të interesit, aktet e mbajtura për procesin e kryerjes së inventarizimit, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 81-82. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 27 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 12.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në procesin e inventarizimit, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, përbërja e komisioneve të jetë në përputhje me kuadrin regullativ ligjor.*

Në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare për vitin 2018, konstatohet se, mungon formati i pasqyrës nr. 5 relacioni dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare pasi, në formatin nr. 1-4, të dhënat paraqiten thjeshtë, me informacion të përgjithshëm, mungojnë sqarime të nevojshme për ecurinë e zërave të pasqyrave financiare. Mungojnë tërësisht shpjegimet dhe analiza e pasqyrës së flukseve monetare, pasqyrat statistikore nr. 1, për investimet dhe burimet e financimit, pasqyra nr. 2/1, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), pasqyra nr. 2/2, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), pasqyra statistikore nr. 3, numri i punonjësve dhe fondi i pagave si dhe shënimet shpjeguese të këtyre pasqyrave. Veprime dhe mosveprime të cilat janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10233, datë 11.0.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar, nenin 19, me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 1 "Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare", pika 67, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kreu III, pika 25, Aneksi 2. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 28 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 13.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masat që, gjatë hartimit të pasqyrave financiare, ato të përfshijnë të gjitha formatet e tyre sipas*



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

përcaktimeve ligjore, duke siguruar të dhëna dhe informacione të plota shpjeguese për përdoruesit e tyre.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me aktivet e nxjerra jashtë përdorimit dhe asgjësimit të tyre, konstatohet se;

-Në përbërje të listës së aktiveve të cilat rezultojnë që nuk janë në përdorim dhe që duhet të dalin nga regjistri i aktiveve të Institucionit, *ka materiale elektronike të cilat konsiderohen të dëmshme dhe nuk duhet të hidheshin apo të asgjësoheshin, pa një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre, me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim, si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore.* Nga AAC nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e asgjësimit të tyre. Nuk ka korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut, impaktin që kanë në komunitet dhe nuk ka asnjë procedurë për vlerësimin dhe ndikimin që kanë në mjedis.

-Nuk vërtetohet kryerja e transportimit aktiveve nga AAC në vendin e përcaktuar për asgjësimin e tyre pasi, automjeti i caktuar për transportin, nuk rezulton të ketë përshkuar lëvizje në landfillin e Sharrës. Konkretisht në datat pas urdhrit nr. 412, datë 19.10.2018 të titullarit të AAC e deri në datën e hartimit të procesverbalit, itinerari i automjetit me të cilin do transportoheshin aktivet, sipas sistemit GPS, nuk rezulton të ketë qenë në landfillin e Sharrës. Gjithashtu për aktivet e dërguara në landfillin e Kukësit rezulton se ka një itinerar në datën 01.11.2018 por, nuk ka dokumentacion të mënyrës së asgjësimit të aktiveve. Veprime dhe mosveprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 19.12.2012, “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, kreu I, pika 1, pika 2, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 35 dhe 36. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 28 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 14.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa në të ardhmen që, në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve, të mbahet parasysht kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit, gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.*

Në vazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të transferimeve kapitale të AAC, konstatohet se: Janë kryer dy transferime kapitale (automjete), konkretisht automjeti me nr. TMBAG6NE1E0161696 të shasisë, ngjyra e zezë, viti i prodhimit 2014, me kapacitet 4+1 vende, me targë AA415IZ, me vlerë kontabël 3,214,800 lekë i cili është transferuar në Institucionin e Avokatit të Shtetit dhe automjeti menr. TMBA6NEXE0162829 të shasisë me targë AA527IZ me ngjyrë të zezë, vit prodhimi 2014, me naftë, me kapacitet 4+1 vende, me vlerë kontabël 3,214,800 lekë. Në të dy rastet për transferimin kapital të automjeteve, rezultoi se, në dosjet e transferimit, nuk ka akte rrespektive të konfirmimeve të cilat duhet të bëheshin për dërguesin brenda datës 20 të muajit pas ardhës të cilat dhe të nënshkruheshin nga nëpunësi autorizues e zbatues i njësisë pritëse. Gjithashtu nga Organet drejtuese të Autoritetit nuk është kryer ndonjë vlerësim për to, të cilat të jenë konsideruar të panevojshme përkohësisht për njësinë



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

apo të jenë të papërdorshme nga AAC, për më tepër që gjatë vitit 2019 institucioni ka kryer procedurë prokurimi për blerjen e dy automjete të tjera të reja me fond limit në vlerën 6,216,575 lekë pa TVSH, me argumentin si nevojë për aktivitetin e saj. Veprimet dhe mosveprimet janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 10.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Urdhri i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35/a/b, pika 36, pika 56, pika 108.(*Trajtuar më hollësisht në faqen 29 të Raportit Përfundimtar*).

Rekomandimi 15.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në rastet e transferimeve kapitale, të kërkohet dhe plotësohet praktika me dokumentacionin përkatës sipas kuadrit ligjor.*

Në vazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit për procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla rezulton se,

-Janë kryer 2 (dy) procedura duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat normale të prokurimit, në shumën totale të fondit limit në vlerën 921,666 lekë pa TVSH, pra këto procedura duhet të kryheshin me tenderim.

-Nga inventarizimi i dosjeve në arkivën e AAC-së, të procedurave për prokurimet me vlera të vogla konstatohet se: Në 11(njëmbëdhjetë) procedura deklaratat e konfliktit të interesit, nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit.

-Në 10(dhjetë) procedura të prokurimit me vlera të vogla, faturat tatimore nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit.

-Në 14(katërbëdhjetë) procedura të prokurimit me vlera të vogla, nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit, i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.

-Në 1(një) procedurë prokurimi me vlerë të vogël, e zhvilluar në sistemin elektronik në APP konstatohet se ftesa për ofertë nuk është dërguar 5 (pesë) operatorëve ekonomik.

-Në 1(një) procedurë prokurimi me vlerë të vogël konstatohet se, mallrat e zëvendësuara nuk janë bërë hyrje në magazinën rikupero, si dhe nga Drejtori i AAC, nuk është ngritur një komision për vlerësimin dhe asgjësimin e tyre.

-Janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla *duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat normale të prokurimit, në shumën totale të fondit limit në vlerën 1,466,666 lekë pa TVSH*, pra këto procedura duhet të kryheshin tenderim.

-Në të gjitha rastet e audituara procesverbalet e mbajtura nga komisioni i prokurimit, për procedurat blerje me vlera të vogla, të kryera me mjete elektronike, në lidhje me vijueshmërinë e kalimit nga operatori i renditur në vendin e parë dhe deri në përcaktimit të ofertës fituese, si dhe procesverbalet e mbajtura në procedurat e prokurimit për rastet emergjente, përcjelljet e praktikave për pagesë tek sektori i financës, nuk janë të protokolluara.

-Në 1(një) rast shpenzimi është kryer duke mos e justifikuar nevojën e kryerjes së tij.

-Në 2(dy) raste nuk ka urdhër nga titullari për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimeve.

-Në një rast preventivi i punëve dhe shërbimeve nuk është i argumentuar dhe i hartuar nga një specialist i fushës.

-Në një rast Operatori ekonomik i ofertuar nuk ka në fushën e veprimtarisë së tij, objektin e prokurimit.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

-Në 7(shtatë) raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit, i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.

-Në 5(pesë) raste konstatohet se, faturat tatimore nuk janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

Veprime të cilat janë në mospërputhje me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 2, 3 e 8/1; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregulla të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 4 pika 1, neni 40 pika 1, 3 dhe 8, neni 57 pika 2 dhe 3, neni 64 pika 2, neni 77 pika 3; Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, neni 7 dhe 19; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 55 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 16.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që:*

-Në hartimin e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike, me qëllim shmangien e copëzimit të fondeve, për të njëjtin grupmallrash apo shërbimesh;

-Përpara fillimit të procedurave të prokurimit me vlera të vogla, të argumentojnë dhe dokumentojnë nevojat e institucionit për mallra e shërbime;

-Për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve, komisionet të përbëhen nga specialistë të fushës;

-Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen sipas përcaktimeve ligjore,

-Për çdo procedurë, të hartohen deklaratat e konfliktit të interesit;

-Të gjitha aktet e hartuara në lidhje me procedurat e prokurimit, të kalojnë përmes arkivës së institucionit, me qëllim evidentimin e rrjedhshmërisë së veprimeve.

Në vazhdimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së prokurimit për procedurën me vlerë të vogël, me objekt “Blerje vegla pune për Aeroportin e Kukësit”, u konstatua se nga drejtori i AAC-së nuk është nxjerrë, urdhër prokurimi për fillimin e procedurës së prokurimit dhe urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave. Gjithësesi, mallrat janë bërë hyrje në magazinën e AAC-së, me fletë-hyrjen nr. 38, datë 31.08.2018 dhe dalje nga AAC me destinacion Aeroportin e Kukësit sipas fletë-daljes nr. 125, datë 31.08.2018. Për Aeroportin e Kukësit, mallrat janë marrë në dorëzim nga stafi i aeroportit. Vlera prej 83,300 lekë, është likujduar nga AAC për llogari operatorit ekonomik sipas faturës nr. 21, datë 31.08.2018. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 67 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 17.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masat, që për procedurat e prokurimit me vlera të vogla, të plotësohet dokumentacioni vërtetues i kryerjes së procedurës, në mënyrë që të justifikohet shpenzimi i kryer.*

Në vazhdimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për hartimin dhe miratimin e buxhetit të viteve 2018 dhe 2019, u konstatua se Drejtori i AAC dhe Këshilli Drejtues nuk kanë



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

bashkëpunuar paraprakisht, përpara datës së mbledhjes së KD, për studimin e Projekt Programit Ekonomik pasi, Këshilli Drejtues e ka marrë relacionin e Drejtorit të AAC-së për Projekt Buxhetin, në të njëjtën ditë që edhe e ka miratuar Vendimin për Buxhetin e Autoritetit për vitin 2018 me vendimin nr.80, datë 21.12.2017 duke mos respektuar kështu parimet e Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010, “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 68 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 18.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masa që të përcaktojnë në Rregulloren e tyre afatin, brenda një date të caktuar, për dorëzimin e Projekt Buxhetit në Këshillin Drejtues, disa ditë përpara se ai të mblidhet për shqyrtimin e tij.*

Në vazhdimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se niveli i pagave të AAC është i ndryshëm nga niveli i pagave të institucioneve të tjera të ngjashme që përfshihen në legjislacionin e shërbimit civil. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 20 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 19.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masat që në të ardhmen, të propozojnë ndryshime ligjore, me qëllim përshtatjen e nivelit të pagave të punonjësve të AAC me nivelin e pagave të punonjësve të institucioneve të tjera të ngjashme me AAC, konform me ligjin nr. 152, datë 26.02.2013 “Për nëpunësit civil”, ose të përshtaten në ligjin funksional të AAC-së.*

Në vazhdimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se për 3(tre) punonjës të AAC-së, nuk është revokuar akti i deklarimit të punësimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” me gjithë ndryshimet përkatëse dhe pika 2 e nenit 16, të Ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, neni 7/h, neni 34/2 i ligjit nr. 152, "Për nëpunësin civil", datë 26.02.2013. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 21 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 20.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat, që në të ardhmen, për të gjitha rastet, të revokohet akti i mëparshëm i deklarimit të statusit të punësimit dhe të nxirret akti i deklarimit të punësimit si Nëpunës Civil në periudhë prove.*

Në vazhdimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se ka pasur 2 raste të ndryshimit të strukturës së punonjësve të AAC. Konkretisht, me Vendimin nr.79, datë 21.12.2017, KD miraton strukturën me numër punonjësish në total, 69 punonjës dhe me Vendimin nr. 21, datë 28.12.2018, KD miraton strukturën me numër punonjësish në total, 73 punonjës. Këto vendime, janë miratuar nga Ministri i MIE përkatësisht me shkresat nr. 3868/5, datë 16.02.2018 dhe Urdhri nr. 2, datë 11.01.2019. Ndërsa para shkurtit të vitit 2018 në strukturën e AAC ka pasur 83 punonjës në organikë duke tejkaluar në mënyrë të parregullt me numrin e punonjësve me 17 punonjës. Struktura është ndryshuar pas arsyetimeve me Relacion nga ana e Drejtorit të AAC por të dy rastet nuk janë miratuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, në kundërshtim me VKM nr. 893, datë 17.12.2014, nenin 30. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 21 të Raportit Përfundimtar).*



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Rekomandimi 21.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa, që në të ardhmen, të kërkojnë miratimin e strukturës nga Departamenti i Administratës Publike dhe nga Ministria e Financave.*

Në vazhdimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe Rregulloreve me të cilat ka punuar AAC u konstatua se Autoriteti nuk i ka pasqyruar (deri në miratimin e Rregullores në fuqi në datën 12.06.2019) në këtë dokument ndryshimet strukturore të realizuara pas 2 vendimeve përkatëse të KD dhe Ministrisë të MIE të përmendura më lart. Nga auditimi u konstatua se ndërhyrja në Rregulloren e parë nuk ishte bërë në harmonizim me strukturën e saj, duke përshtatur në disa raste vetëm përshkrimin e vendit të ri në strukturë tek Aneksët, pa respektuar hierarkinë e ligjit për të përshtatur së pari Rregulloren dhe pastaj anekset e saj duke mos respektuar përcaktimet e sanksionuara në Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar, neni 27. AAC ka hartuar dhe miratuar Rregulloren në fuqi me Vendimin nr. 5, datë 13.06.2019 me një vonesë prej mbi 5 muajsh nga miratimi i strukturës në fuqi nga Ministri me Urdhrin nr. 2 datë 11.01.2019. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 23 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 22.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masa që në të ardhmen, para se të miratojnë e zbatojnë një strukturë të re duhet të përshtatin Rregulloren e brendshme me vendet e reja në organigramë.*

Në vazhdimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se AAC ka dhënë për periudhën e auditimit dy shpërblime të veçanta për punonjësit e saj, përkatësisht një në dhjetor të vitit 2018, në vlerën 7,487,204 lekë dhe në vitin 2019 ka pasur një shpërblim në vlerën 7,147,932 lekë. Për të gjithë periudhën e auditimit vlera totale e shpërblimeve llogaritet në vlerën 14,995,136 lekë. Këto shpërblime janë dhënë pa miratimin e Ministrisë të linjës ose pa respektuar ligjin nr. 10233, neni 18, pikën 3, datë 11.2.2010 dhe ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 23 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 23.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në dhënien e shpërblimeve të veçanta punonjësve, të marrin parapakisht miratimin nga Këshilli Drejtues dhe Ministri i MIE.*

Në vazhdimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave të vëna në dispozicion nga sektori i financës u verifikua se për drejtuesin dhe punonjësit e tjerë të Aeroportit të Kukësit, nuk janë paguar kontributet për sigurimin suplementar, në kundërshtim me Ligjin nr.10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, Ligjin nr, 104/2014, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, VKM 343 datë 04.6.2006 neni 1 dhe 2, Udhëzimi i përbashkët mes Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë të Financave nr. 2127/4, datë 07.7.2014, “Për administrimin e Aeroportit të Kukësit”, Rregulloren “Për pensionet vullnetare të punëdhënësit”, miratuar me vendimin nr. 57, datë 03.08.2016. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 24 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 24.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të shqyrtojnë të gjitha rastet e mos përfshirjes në skemën e*



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

kontributeve për sigurimin suplementar të punonjësve duke i përfshirë ata sipas rastit në këtë skemë, si dhe të marrë masat për derdhjen e këtyre kontributeve të munguara.

Në vazhdimësi

25. Gjetje nga auditimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e nëpunësit autorizues, nuk ka hartuar strategjinë e riskut. Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatis raporte vjetore mbi problematikat e hasura. Regjistrat e riskut janë mbajtur pjesërisht, jo në përputhje me formatin rregullativ ligjor.

Gjithashtu, Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil nuk ka nxjerrë urdhër, për hartimin e gjurmës së auditit, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme. Gjurma e auditit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumentave që përmban një proces. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 57-58 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 25.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masat e duhura për hartimin e strategjisë së riskut, ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe krijimin e regjistrat të riskut sipas përcaktimeve ligjore, si dhe të marrë masat e duhura për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditit, në përputhje me kuadrin rregullativ ligjor.*

Në vazhdimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të zbatimit të Rekomandimeve rezultoi se: Në lidhje me Ndryshime dhe Përmirësime Legjislacioni, janë rekomanduar 2 (dy) masa: 2 (dy) masa realizuar pjesërisht. Në lidhje me Masa Organizative, janë rekomanduar 11 (njëmbëdhjetë) masa, 3 (tre) masa të realizuara, 3 (tre) masa realizuar pjesërisht, 5 (pesë) masa në proces. Në lidhje me Masa për Shpërblim Dëmi, janë rekomanduar 21 (njëzetë e një) masa në vlerën 259,424 mijë lekë: 4 (katër) masa nuk janë pranuar, 10 (dhjetë) masa në proces, 7 (shtatë) masa të pa zbatuara. Përsa i përket masave për shpërblim dëmi nuk është arkëtuar asnjë vlerë.

-Në lidhje me Masa për Eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet të fondeve publike, janë rekomanduar 7 (shtatë) masa: 1 (një) masë nuk është pranuar, 6 (gjashtë) masa në proces.

-Në lidhje me Masat Displimore, janë rekomanduar 6 (gjashtë) masa: 5 (pesë) masa të realizuara, 1 (një) masë në proces. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 14 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 26.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masat e duhura për zbatimin e plotë të rekomandive të lëna nga KLSH në auditimin e kaluar.*

Në vazhdimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Prokurimet

Për auditimin e kësaj çështje u morrën në shqyrtim praktikat e procedurave të prokurimit, përsa i përket përlllogaritjes së nevojave, specifikimeve teknike, fondit limit, kritereve të kualifikimit, nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, ngritjes së komisioneve dhe mbajtjes së procesverbaleve përkatëse, gjithashtu këqyrja e dokumentacionit të ofertuesve në SPE.

Procedurat e prokurimit të audituara, i përkasin periudhës 01.01.2018 deri 31.08.2019 (Afati auditimit). Nga auditimi, rezultoi se janë zhvilluar në total për secilin vit përkatësisht procedurat



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

e prokurimit në numër si më poshtë vijon (referuar listës së dërguar nga subjekti AAC dhe verifikimit në SPE);

Periudha 01.01.2018 deri 31.12.2018:

3 Procedura të llojit “Kërkesë për Propozim”;

1 Procedura të llojit “Negociim pa Shpallje”;

1 Procedurë e llojit “E Hapur”;

2 Procedura të llojit “Shërbim Konsulence.

Vlera në total e kontratave të lidhura për procedurat e mësipërme e të realizuara në vitin 2018, është 57,576,069 lekë pa TVSH.

Periudha 01.01.2019 deri 31.08.2019

3 Procedura të llojit “E hapur”;

Vlera në total e kontratave të lidhura për procedurat e mësipërme e të realizuara në vitin 2019 deri në datën 31.08.2019, është 10,476,600 lekë pa TVSH.

Në lidhje me procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla rezultoi se;

Për vitin 2018, janë realizuar 23 procedura, me fond limit në shumën totale 7,436,499 lekë pa TVSH dhe në vlerë kontrate në shumën totale 5,107,733 lekë pa TVSH.

Për vitin 2019, deri në muajin gusht janë realizuar 21 procedura, me fond limit në shumën totale 5,717,297 lekë pa TVSH dhe në vlerë kontrate në shumën totale 3,673,053 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave:

Për periudhën e auditimit, janë audituar të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara, të anuluar dhe të realizuara ose e shprehur në përqindje, janë audituar 100 % e procedurave të prokurimit dhe janë mbajtur aktet përkatëse.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me Vendimin nr. 10, datë 31.07.2018, me anë të të cilit, Këshilli Drejtues i AAC miraton ndryshimet në programin ekonomik për vitin 2018 duke shtuar zërin investime në vlerën 23,300,000 lekë për pagesën e konsulentit të kompanisë RB GMBH, i cili do të asistojë për negociimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe shoqërive Çengiz Construction & Kalyon & Kolin Construction, sipas shkresës së MIE me nr. 8607/1 prot., datë 20.06.2018. Në relacionin e drejtorit të AAC bashkangjitur vendimit të KD, cilësohet se: “...Duke patur parasysh që pagesa e këtij shërbimi nuk është parashikuar në programin buxhetor të MIE dhe duke qënë se AAC është pjesëmarrëse në këtë proces, përcaktohet se ky i fundit do të paguajë vlerën e kontratës prej 152,600 Euro pa TVSH”. Nga Auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me likuidimet e kryera nga AAC në llogari të Konsulentit “RB” GMBH, u konstatua se:

a). Likuidimi i vlerës së paradhënies prej 76,300 Euro sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 10.08.2018 sipas urdhër xhirimit të Union Bank, dega Garda me kod 1114, nga llogaria bankare e AAC në lekë me nr. AL87214111060111320616030129 në llogarinë bankare të “RB” GMBH në Deutsche Bank, Munchen. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura mban firmën e Konsulentit, ka të specifikuar arsyen e pagesës “Paradhënie” dhe vlerën e saj prej 76,300 Euro.

b). Likuidimi i vlerës së dytë prej 76,300 Euro, pagesë finale sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 25.07.2019 sipas urdhër xhirimit të BKT, dega me kod 505, nga llogaria bankare e AAC në Euro me nr. 401612629 në llogarinë bankare të “RB” GMBH në



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Deutsche Bank, Munchen. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura për pagesën finale, është e njëjtë me faturën për pagesën e paradhënies. Pra, nuk vërtetohet se operatori e ka lëshuar faturën pasi ka përfunduar kryerjen e shërbimit. Gjithashtu, bashkangjitur urdhër xhirimit dhe faturës, është procesverbali i mbajtur nga grupi i negocimit. Në dokumentacionin e dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë shërbimet e kryera nga Konsulenti në përputhje me pikën 6.1 të kontratës së lidhur. Si rezultat, vlera e investuar nga AAC prej 152,600 euro, nuk është e justifikuar me dokumenta dhe fakte sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. (Trajtuar më hollësisht në faqen 17-18 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 1.1.: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithëshme, Sektori Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e investuar nga AAC dhe të përfituar nga operatori ekonomik “**RB**” **GMBH**, dhe vetëm nëse nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës, të konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 152,600 Euro nga operatori ekonomik “RB” GMBH**, si vlerë që i përket zërave të pa argumentuar në kundërshtim me nenin 6.1 të kontratës së lidhur.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurën e marrjes me qira nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të ambienteve për zyra tek TBP, u konstatua se AAC me përfaqësues z. KK, dhe TBP me përfaqësues znj. SA, kanë nënshkruar një kontratë për marrje ambientesh me qira në total 973.7 metra katror (sipërfaqe bruto) sipas nenit 1, pikës 1.1.1 të kontratës me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018. Për auditimin e kësaj çështjeje, grupi i auditimit, i është referuar vendimeve të marra nga KD, relacioneve nga Drejtori i AAC për KD dhe shkresave nga komunikimet e palëve të përfshira në këtë çështje.

-Relacioni nga Drejtori i AAC, drejtuar Këshillit Drejtues, është me nr. 781 prot., datë 16.04.2018. Tek ky relacion, Drejtori i AAC, në mënyrë të përmbledhur, cilëson: “AAC paraqet këtë propozim për mundësinë e transferimit të ambienteve të punës së AAC në një infrastrukturë më të përshtatshme duke konsideruar performancën e deritanishme të sektorit dhe zhvillimet e pritshme... **Sipërfaqja totale e ndërtimit, prarashikohet të jetë rreth 3600 m²**”.

-Këshilli Drejtues i AAC, me vendimin nr. 05, datë 17.04.2018, ka miratuar nismën **mbi nevojën e një godine të re** të AAC-së, pranë operatorëve dhe në një zone jo urbane.

-Sekretari i Përgjithshëm i MIE, z. GK, me shkresën nr. 1147/1 prot., datë 25.10.2018, e sqaron AAC lidhur me mundësinë e gjetjes së një toke për ndërtimin e një godine të re për institucionin, ku në vija të përgjithëshme, i cilëson se: “...Sa më sipër, ndodhur në këto kushte dhe duke pasur parasysh nevojat e AAC për ambiente të reja, **sygjerohet që deri në miratimin e projektvendimit, AAC të marrë parasysh zgjidhjen e situatës me burimet e veta financiare**”.

-Në vazhdim, në pamundësi për gjetjen e një toke në dispozicion të AAC për ndërtimin e një godine të re për institucionin, Drejtori i AAC, i dërgon një relacion Këshillit Drejtues, duke i kërkuar transferimin me zyra me qira në ambientet e TBP. Tek ky relacion, në vija të përgjithëshme, cilësohet: “...**nëpërmjet vendimit nr. 5, datë 18.04.2018 dhe shkresës nr. 8897/3 prot., datë 23.10.2018 nga MIE, ju paraqes kërkesën time me propozimin për lëvizje me zyra pranë Tirana International Airport**”. Me vendimin nr. 18, datë 07.11.2018, Këshilli Drejtues i



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

AAC, ka miratuar propozimin e Drejtorit, për transferim me zyra të Aviacionit Civil për një periudhë 2 vjeçare, në qendrën e biznesit “TBP” SHPK.

-Kontrata e nënshkruar midis AAC dhe TBP për marrje ambientesh me qira për zyra, është me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018. AAC, ka likuiduar vlerën prej 20,252.96 Euro për llogari të qiradhënësit TBP, si garanci e cila do ti kthehej AAC pasi institucioni të merrte në dorëzim ambientet me qira.

-Shkresa me nr. 22 prot., datë **13.02.2019** TBP dhe nr. 306 prot., datë 14.02.2019 AAC, me anë të së cilës shoqëria “TBP” SHPK, me shkresën nr. 306 prot., datë 14.02.2019, i kërkon AAC-së, që të merren në dorëzim zyrat sipas kontratës së qirasë së lidhur midis AAC dhe TBP me nr. 2054 Rep, nr. 419 Kol, datë 19.11.2018.

-Me shkresën nr. 1176/3 prot., datë **27.06.2019**, Drejtori i AAC, dërgon një relacion tek KD i AAC-së lidhur me kërkesat e TBP dhe parashtron si zgjidhje të vetme, mbajtjen e vlerës së garancisë prej **20,252.96 Euro** nga qiradhënësi. Me vendimin nr. 11, datë 28.06.2019, KD vendos miratimin e zgjidhjes së kontratës së qirasë nr. 2019/2, datë 19.11.2019, ndërmjet TBP dhe AAC.

-Sa më sipër, referuar gjetjeve dhe konkluzioneve të grupit të auditimit, vlera e likuiduar nga AAC, në favor të TBP prej 20,252,96 Euro, konsiderohet dëm ekonomik për AAC/Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga personat përgjegjës të cilët kanë vepruar në kundërshtim me interesat ekonomike të institucionit. (Trajtuar më hollësisht në faqen 18-19 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 2.1: *Ministri i Industrisë dhe Energjisë, Këshilli Drejtues i Autoritetit të Aviacionit Civil, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithëshme, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masat për të analizuar shkaqet dhe personat përgjegjës për dëmin ekonomik që i kanë sjellë AAC/Buxhetit të Shtetit dhe në vazhdim, nga personat përgjegjës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, **arkëtimi i vlerës 20,252,96 Euro, vlerë e konsideruar dëm ekonomik dhe që i përket garancisë të likuiduar nga AAC në favor të TBP.***

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt: “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s*”, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se operatori ekonomik “BA” SHPK, nuk ka dorëzuar pranë AAC, dokumentacion që vërteton angazhimin e ekspertëve të huaj të deklaruar në formularin e ofertës sipas ditëve dhe kohës së tyre të punës por edhe shpenzimet e rimbursueshme të likuiduara nga AAC lidhur me kostot e transportit ndërkombëtar dhe hotelet apo dietat. Nuk ka në dosjen e zbatimit të kontratës, asnjë dokumentacion që vërteton se ekspertët e huaj të angazhuar në zbatimin e kontratës me objekt “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s*”, kanë qenë prezent në Shqipëri gjatë ekzekutimit të kontratës, kanë udhëtuar, akomaduar në hotel dhe punuar në ambientet e përcaktuara sipas kontratës së lidhur dhe konkretisht kontratës me nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018, nenit nr. 5 të Kushteve të Veçanta, pika 5.1 ku cilësohet se: “*Shërbimet do të kryhen në zyrat e administratës Tirana International Aeroport Rinas, Tiranë, pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1, P.O Box 205, Tiranë, Shqipëri ose zyrat e kontraktuesit sipas rastit*” dhe pikës 3.2, të seksionit “Profilin e operatorit ekonomik” të kontratës së lidhur, vendndodhja dhe ekzekutimi ku cilësohet se: “*Ekipi i ekspertëve të kontraktorit, do të kryejë detyrën në Tiranë, Republika e*



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Shqipërisë”. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik në SPE, dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik pranë sektorit të financës së AAC, konkludohet se në total, vlera e likuiduar prej **134,928 EURO**, në favor të operatorit ekonomik “BA” SHPK, që i përket zërave të preventivit të ofertës (për ekspertët e huaj) së dhënë nga operatori ekonomik i shpallur fitues konform shtojcës nr. 4 të Dokumentave standarde të Tenderit dhe nenit 37 Shërbimet e Konsulencës të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, pika 4, gërma a), duhet të analizohet nga AAC dhe vetëm nëse AAC nuk vërteton kryerjen e shërbimit me dokumentacion ligjor, atëherë të nxirren përgjegjësitë dhe të kërkohet kthimi i vlerës së investuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 50-51 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 3.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithëshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e investuar nga AAC dhe të përfituar nga operatori ekonomik “BA” SHPK, dhe vetëm nëse nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës, të konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 134,928 EURO nga operatori ekonomik “BA” SHPK.*

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi në 32 raste shpenzimet e kryera për përballimin e shpenzimeve të punonjësve për shërbimet e udhëtimit jashtë vendit, faturat e hotelit të paraqitura nga punonjësit, janë pa vullë vërtetuese të subjektit i cili e ka lëshuar, çka bën që dokumentacioni i paraqitur të mos e justifikojë shpenzimin në **shumën 24,601 euro** dhe sipas kursit mesatar të euros=123.8 lekë, rezulton në **shumën 3,046,753 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e AAC, veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 52-53 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 4.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, në koordinim me Këshillin Drejtues, të shqyrtojnë shumën 3,046,753 lekë, cilësuar si dëm ekonomik, vlerë e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në pagesat e kryera me bankë për përballimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë vendit si dhe të plotësohen këto praktika me dokumente justifikuese në të ardhmen.*

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, me urdhër transfertën bankare të datës 23.11.2018, është likuiduar fatura tatimore nr. 32, datë 30.10.2018, për gërmime dheu, ndaj operatorit “KE” SHPK., në vlerën 66,000 lekë me TVSH, faturë e cila është nënshkruar nga vetë Drejtori Ekzekutiv dhe komisioni i blerjeve të vogla. Është mbajtur procesverbal nga z.KK, znj.KK dhe z.PR më datë 30.10.2018, në të cilin citohet se “...pas kontaktit me përfaqësues të Kryeministrisë të cilët kërkuan nga AAC-ja, në rolin e palës negociatore të asistojë ekspertët turq të *Cengiz Holding Group* si dhe të mbulojnë shpenzimet e verifikimit të përbërjes gjeologjike të tokës ku do të ndërtohet Aeroporti i Vlorës, nëse është në përputhje me të dhënat e fizibilitetit të Aeroportit të Jugut”. Ky shpenzim



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

është i pa justifikuar pasi nuk ka asnjë dokumentacion vërtetues dhe justifikues, nuk ka asnjë kërkesë zyrtare për këtë veprim, nuk ka asnjë dokument për vendin ku është kryer verifikimi, nuk ka asnjë dokumentacion mbi planimetrinë, skicat apo vizatime për kryerjen e këtyre punimeve, nga të cilat dalin sasi dhe volumet e punimeve, dhe shuma prej 66,000 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e AAC. Veprime këto në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5, me ligjin nr. 10296, datë 10.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenet 2, 3, 8/1, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35/a/b, pika 36, pika 56. (Trajtuar më hollësisht në faqen 53 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 5.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të kërkojnë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës **66,000 lekë**, nga Drejtori i AAC z. KK.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s*”, viti 2018, AAC ka likuiduar operatorin ekonomik “BA” SHPK për një ekspert më shumë krahasuar me numrin e ekspertëve të kërkuar për përmbushjen e kushteve të kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, referuar dosjes së zbatimit të kontratës, u konstatua se operatori ekonomik, ka dorëzuar faturën për likuidim në vlerën sipas strukturës së propozimit ekonomik të ofruar në procedurën e prokurimit, tek e cila ka deklaruar pagesën e një eksperimenti më shumë se numri i ekspertëve të kërkuar nga AAC. Paga ditore e ekspertit financiar & kontabël të deklaruar më tepër, është 590 Euro për 36 ditë pune= 21,240 Euro të cilat i përkasin zërit “*Kostot e drejtpërdrejta*”. Operatori ekonomik, duhej të vihej në dijeni të gabimeve në preventivin/faturën e dorëzuar me qëllim korrigjimin e faturës përfundimtare. Kjo vlerë, e likuiduar më tepër në favor të operatorit ekonomik prej **21,240 Euro**, **përbën investim me efekt negativ financiar për institucionin e AAC.** (Trajtuar më hollësisht në faqen 45-46 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 1.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e shpenzuar me pasojë efekt negativ për institucionin duke evidentuar personat përgjegjës.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Likuidimi i vlerës prej **7,774,200 lekë** për llogari të operatorit ekonomik “TC” SHPK për kontratën me objekt “*Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO për nevojat e AAC*”, mund të shmangej pasi AAC këtë detyrë, e kryente prej vitesh me strukturat e saj pa patur nevojë të kryente procedurë prokurimi. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me fillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “*Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO për nevojat e AAC*”, lloji procedurës “*Shërbim Konsulence*”, me fond limit 6,966,189 lekë pa



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se kjo procedurë është iniciuar nga AAC në të njëjtën kohë që institucioni ka pasur struktura të ngritura sipas rregullores së brendshme për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë. AAC ka pasur nën përgjegjësinë e saj, edhe zbatimin e detyrave të përcaktuara në termat e referencës sipas shtojcës nr. 14, të DST, REF-78854-07-11-2018, Shërbimi që kërkohet, ku cilësohet: “Objekti i Konsulencës është rritja, konsolidimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të AAC-së për të mbështetur ngritjen e një sistemi efikas të menaxhimit të cilësisë në AAC në përputhje me kërkesat e standardit ISO 9001:2015”. Objektivi i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë së AAC-së, ka qenë “**Monitorimi i përmbushjes së vazhdueshme të standarteve të cilësisë ISO 9001:2008**” duke nënkuptuar se përfshihen edhe standardet ISO 9001:2015, të cilat vetëm përmirësohen por nuk janë asnjëherë të ndryshme nga njëra tjetra. **Kjo vlerë e likuiduar nga AAC prej 7,774,200 lekë dhe që mund të shmangej, përbën investim me efekt negativ financiar për institucionin.** (Trajtuar më hollësisht në faqen 32-33 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 2.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë, të bashkëpunojnë me menaxherët e cilësisë dhe organet standardizuese për akreditimin, çertifikimin e institucionit me standardet ISO.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, viti 2019, me fond limit 6,216,575 lekë pa TVSH, u konstatua se:

a). Titullari i institucionit, ka nxjerr urdhrin e prokurimit pa u kryer më parë argumentimi nga strukturat përkatëse lidhur me nevojën e blerjes së automjeteve të reja. Shkresa e parë e identifikuar në dosjen e prokurimit, është ajo me nr. 762 prot., datë 17.04.2019, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike. Përpara kësaj shkrese, njësia e prokurimit, nuk ka në dosjen e prokurimit, asnjë argumentim lidhur me arsyet e fillimit të procedurës së prokurimit. Nga verifikimet e kryera pranë AAC, tek strukturat përkatëse u konstatua se institucioni ka pas në përdorim 5 automjete për vitin 2018 dhe konkretisht automjetet me targa: AA 415 IZ, AA 462 SU, AA 516 IZ, AA 404 DV dhe AA 527 IZ. Automjeti me targë AA 527 IZ, është transferuar tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 21.12.2018 dhe automjeti me targë AA 415 IZ, është transferuar tek Avokatura e Shtetit në datën 14.02.2019. Pra në një hark kohor prej afro 6 muaj pasi AAC dhuron dy automjete, pretendon se ka nevojë për automjete të reja. Pas datës 14.02.2019, AAC ka pasur në funksion 3 automjetet e mbetura. Si rezultat, nuk është aspak e qartë se përse AAC transferon automjetet që ka në përdorim tek institucionet e tjera duke i falur ato, pa kryer paraprakisht një vlerësim të nevojave të saj. Si rezultat, vlera e likuiduar për blerjen e dy automjeteve referuar faturave me nr. 74 dhe nr. 75, datë 03.10.2019 që në total është **7,358,400 lekë, konsiderohet investim me efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit.**

b). Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas raportit përmbledhës propozon të shpallet fitues oferta më e lartë me vlerë 6,132,000 lekë pa TVSH e operatorit ekonomik “AMC” SHPK. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i s’kualifikuar “HAA” SHPK, u konstatua se të dhënat teknike të deklaruara nga KVO si mangësi, duhej të pranoheshin si devijime të vogla nga KVO edhe për faktin se operatori i shpallur fitues ka mangësi. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues “AMK” SHPK, u konstatua se ky operator në sistemin e SPE, nuk ka paraqitur në katalogun e dorëzuar, mjetet që kërkohen dhe as specifikimet teknike sipas atyre të specifikuara nga AK. Gjithashtu, vlen të



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

përmendet se ky operator sipas tabelës së automjeteve që disponon, dhe përkatësisht në faqen 49 të katalogut të paraqitur, ka deklaruar se nuk disponon automjetet që kërkohet nga AK (HYBRID) dhe konkretisht përcaktohet se nuk disponohet automjeti: 2.0 l ivct 14 atk hev 187 PS, faza VI, hibrid elektrik, hf 35 ectv automatik. Pra, KVO, duhej ta s’kualifikonte operatorin ekonomik “AMK” SHPK, për mangësi thelbësore në dokumentacionin e dorëzuar dhe jo ta kualifikonte atë. KVO duhej ta kualifikonte operatorin ekonomik “HAA” SHPK me ofertën me vlerë 5,990,000 lekë si oferta më me leverdi ekonomike ose të anulonte procedurën e prokurimit për mangësi të të dy ofertave të ardhura. Diferenca e ofertave prej 142,000 lekë, konsiderohet si shpenzim në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efijensës së administrimit dhe përdorimit të fondeve publike. (Trajtuar më hollësisht në faqen 33-34 dhe faqen 36 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 3.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, në fillim të kryhet vlerësimi i aktiveve dhe vetëm nëse aktivet konsiderohen të panevojshme për Autoritetin e Aviacionit Civil, atëherë mund të merret vendimi për dhurimin e tyre.

Rekomandimi 3.2: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, Komisionet e Vlerësimit të ofertave, të marrin masat që në të ardhmen, të kualifikojnë vetëm ato oferta që plotësojnë kriteret e vendosura në DST dhe që janë me leverdi ekonomike për institucionin.

Në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Kontraktimi ekspertëve të jashtëm për hartimin e termave të referencës dhe për anëtar të KVO për procedurën e prokurimit me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”, ka qenë i panevojshëm pasi AAC disponon në stafin e saj, punonjës me kualifikimet dhe eksperiencat përkatëse.

a). Me shkresën pa nr. protokollit dhe datë 16.04.2018, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme z. FG dhe Përgjegjësja e Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve znj. AP, i dërgojnë një relacion Drejtorit të AAC mbi nevojën për ekspert të jashtëm për hartimin e ToR të procedurës së prokurimit me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”.

b). Me shkresën me nr. 1208/3 prot., datë 02.07.2018, Titullari i AAC, nxjerr urdhrin për pajtimin e një eksperti të jashtëm për antar të KVO për procedurën e prokurimit me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”. Me shkresën nr. 1208/4 prot., datë 04.07.2018, Titullari i AAC, nënshkruan kontratën me ekspertin e jashtëm z. RS. Në dosjen e procedurës së prokurimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion verifikues për mënyrën e përzgjedhjes së ekspertit të jashtëm si antar i KVO në ndryshim nga mënyra e përzgjedhjes së ekspertit për hartimin e DST për të cilin është shpallur vendi vakant në faqen web të AAC. Kontraktimi i ekspertit të jashtëm nga Drejtori i AAC duke nënshkruar kontratën është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, jo transparente dhe diskriminuese. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe konkretisht të dosjeve të personelit, u konstatua se AAC në stafin e saj ka punonjës të specializuar në shkencat ekonomike me profesion ekspert kontabël të regjistruar madje edhe auditues me eksperiencë në auditimin e programeve IPA pa përmendur këtu personelin permanent të AAC i cili ka kryer prej kohësh auditim në TIA. Si rezultat, AAC nuk kishte pse të kërkonte ekspert të jashtëm me diplomë master në shkencat



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

ekonomike apo edhe me çertifikata në të njëjtën kohë që në stafin e saj ka pasur specialistë të fushave përkatëse. Të paktën, AAC duhej të respektonte radhën e përzgjedhjes së ekspertit duke kontaktuar me institucione të tjera si p.sh me MFE. Vlera e shpenzuar për kontraktimin e ekspertit të jashtëm, për hartimin e termave të referencës, sipas urdhër xhimit të Union Bank me nr.ref 117FTRQ183620008 dhe datë 28.12.2018, është 186,150 lekë. Vlera e shpenzuar për kontraktimin e ekspertit të jashtëm, si anëtar i KVO, sipas urdhër xhimit të bankës BKT me kod 205/11552 dhe datë 15.02.2019, është 94,581 lekë. **Në total, vlera e shpenzuar prej 280,731 lekë, përbën shpenzim me efekt negativ financiar për AAC dhe buxhetin e shtetit.** (Trajtuar më hollësisht në faqen 40 dhe faqen 43 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 4.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, të propozojnë kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për procedurat e prokurimit, vetëm pasi të jetë konkluduar se AAC ose dhe Autoritete të tjera Kontraktore, nuk kanë në përbërje të strukturave të tyre, punonjës të specializuar.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Kryerja e shpenzimit në vlerën e **33,186,387 lekë** për rishikimin e pozicionit ekonomik të kontratës koncesionare të Aeroportit Nënë Tereza Tiranë, mund të shmangej pasi AAC këtë detyrë, për zërat më të shumtë të kërkuar, mund ta kryente me strukturat e saj pa patur nevojë të kryente procedurë prokurimi. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me fillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së koncesionit të TIA-s”, lloji procedurës “Shërbim Konsulence”, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se kjo procedurë është iniciuar nga AAC pasi i është kërkuar përzgjedhja e konsulentit dhe mbulimi i shpenzimeve nga MIE dhe MFE sipas shkresës dërguar AAC-së me nr. 777 prot., datë 16.04.2018. Autoriteti i Aviacionit Civil, përpara se të nxirrte urdhrin për hartimin e termave të referencës apo urdhrin e prokurimit, duhej që Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të analizonin detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve referuar rregullave në fuqi dhe vlerësimit 6 mujor të performancës së punonjësve. Konkretisht, nga auditimi i ligjit të AAC dhe rregullores së brendshme të institucionit, nga grupi i auditimit, konstatohet se AAC e ka pasur si detyrë të përcaktuar në rregulloren e brendshme, monitorimin e performancës së Marrëveshjeve Koncesionare. Këtë detyrë, AAC e ka zbatuar prej vitesh aq më tepër që procedura e prokurimit kërkon rishikimin e pozicionit ekonomik për vitet e kaluara pra kontrata do këtë fuqi paravepruese dhe ndryshimi i strukturës në vazhdimësi pas vitit 2018, nuk ka luajtur rol në humbjen e aftësisë së AAC për të monitoruar Koncesionarët gjë që e ka bërë vazhdimisht në të kaluarën. Si rrjedhojë, AAC ka pasur nën përgjegjësinë e saj, edhe zbatimin e detyrave të përcaktuara në termat e referencës sipas shtojcës nr. 13, të DST, REF-85444-09-12-2018, pika 1.2, Objektivat Specifikë, për procedurën e prokurimit me objekt “Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së koncesionit të TIA-s”. Si rezultat, vlera e investuar nga AAC për kryerjen e një procedure prokurimi me objektiva të cilat mund të realizoheshin nga strukturat e AAC sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi për funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, është vlerë e investuar në kundërshtim me ligjin e AAC, rregulloren e brendshme dhe fushën e veprimtarisë së AAC e cila të ardhurat e saj i përdor vetëm për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, të nevojshme për funksionimin normal të Autoritetit. Vlera e investuar në total prej 33,186,387 lekë, përbën investim me efekt financiar negativ për



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Autoritetin e Aviacionit Civil/Buxhetin e Shtetit dhe një dëm ekonomik i mundshëm në të ardhmen nëse nuk përmbushet objektivi i përgjithshëm i kontratës me nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018, rikthimi i ekuilibrit ekonomik të Koncesionit (nëse ka pasur disekuilibër ekonomik pasi TIA nuk e ka pranuar ekzistencën e tij) gjithmonë duke zbatuar një nga skenarët e propozuar nga operatori ekonomik “BA” SHPK, siç paraqiten në faqet 208 deri 231 të raportit përfundimtar, seksioni 16, Skenarët e Moderuar. Objektivi final i kontratës së lidhur midis AAC dhe operatorit ekonomik “BA” SHPK, nuk është dorëzimi i një raporti lidhur me “*Rishikimin e pavarur të pozicionit ekonomik të Koncesionit*” por rikthimi i ekuilibrit ekonomik i konstatuar nga “BA” SHPK (nëse ka pasur disekuilibër) sipas gërmës b) dhe gërmës c) të Klauzolës nr. 19.4 të ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004 (Kontrata Koncesionare) duke zbatuar një ose më shumë nga Rekomandimet e dhëna nga operatori ekonomik pas kryerjes së vlerësimit të pavarur ekonomik të koncesionit. **Sa më sipër, investimi në vlerën e 33,186,387 lekë, konsiderohet investim me efekte financiare negative për AAC dhe Buxhetin e Shtetit.**(Trajtuar më hollësisht në faqen 48-49 të Raportit Përfundimtar).

Rekomandimi 5.1: *Këshilli Drejtues i AAC, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të analizojnë vlerën e investuar prej 33,186,387 lekë për kryerjen e rishikimit të pavarur ekonomik, duke verifikuar nëse me kryerjen e këtij shpenzimi, janë zbatuar Rekomandimet e Konsulentit “BA” SHPK për arritjen e objektivave të përcaktuara më parë për “Rikthimin e ekuilibrit ekonomik të Koncesionit të TIA-s”. Në të kundërt, të nxirren përgjegjësitë për Drejtorin Ekzekutiv të AAC dhe Sektorin e Kontratave dhe Shërbimeve, lidhur me fillimin e një procedure prokurimi dhe kryerjen e një investimi në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efëçensës dhe efektivitetit të shpenzimeve të fondeve publike.*

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve dhe konsumit të karburantit referuar verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se:

-Për automjetet që disponon AAC rezulton se nuk kanë kartela përkatëse, në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to ku, gjithashtu duhet të jetë evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

-Në varësi të konsumit të karburantit, të vendosur nga një komision i posaçëm, sasia e tërhequr nuk përputhet me kilometrat e përshkuara dhe nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës. Nga verifikimi dhe llogaritja e të dhënave të dokumentacionit rezulton se, janë tërhequr më tepër 6,270 litra benzinë në vlerën 970,118 lekë dhe 1,367 litra naftë në vlerën 221,090 lekë, të cilat nuk janë të plotësuara më dokumentacion. Nga ana e administrimit të AAC, Drejtori ekzekutiv në cilësinë e titullarit të njësisë publike e nëpunësit autorizues, drejtori i financës dhe buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe përgjegjësi i sektorit e caktuar për menaxhimin e aktiveve rezulton se, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të AAC-së, nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 5-10, 35 dhe 36. Nga veprimet dhe mosveprimet konform procedurave që parashikohen nga ligji, shuma prej **1,191,208 lekë përbën**



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

efekt financiar negativ për buxhetin e AAC-së. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 56 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 6.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrë masat, për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe efizienz të tij. Nga sektori i financës dhe buxhetit, të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.*

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, me shkresën nr. 275 prot., datë 07.02.2019 është lëshuar Urdhër i brendshëm për kryerjen e procedurës të prokurimit me vlerë të vogël “Për blerje letër murale për ambient zyre”, me fond limit deri në vlerën 100,000 lekë. Kjo procedurë ka nisur bazuar në memon e bërë datë 07.01.2019 nga znj.KG, në të cilën citohet se në kuadrin e përgatitjes së ambienteve të zyrave të reja pranë TBP. Është e nevojshme planifikimi dhe arredimi i zyrave të administratës dhe për këtë arsye është e nevojshme dekorimi i një prej ambienteve me letër murale e cila duhet të jetë ekologjike dhe antibakteriale me përmasat 785cm*325cm dhe të jetë e printuar me bojë ekologjike. Me datë 08.02.2019 është mbajtur procesverbali nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla i cili ka hartuar specifikimet teknike dhe karakteristikat e letrës murale. Komisioni është drejtuar 3 operatorëve ekonomikë dhe ka mbajtur procesverbalin më datë 08.02.2019, duke përcaktuar si ofertë fitues operatorin ekonomik “KN”(person fizik), me vlerën e ofertës 65,000 lekë pa TVSH. Me datë 14.05.2019 nga AP është përcjellë për pagesë praktika ndaj sektorit të financës për likuidimin e faturës nr. 86, datë 08.02.2019, ndaj këtij operatori me transaksionin bankar, më datë 28.02.2019 në shumën 78,000 lekë. Letra është bërë hyrje në magazinë me FH nr. 7, datë 08.02.2019, dhe është bërë dalje me FD nr. 26, datë 08.02.2019. Ky shpenzim në **shumën 78,000 lekë konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e AAC-së pasi, këto ambiente nuk janë marrë e vënë në funksion dhe AAC nuk ka ushtruar asnjëherë aktivitetin e saj në TBP, çka do të thotë se është një shpenzim i pa nevojshëm për ushtrimin funksional të institucionit.** Veprime të cilat janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenin 2, 3 e 8/1. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 54 të Raportit Përfundimtar).*

Rekomandimi 7.1: *Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të marrin masa, që të mos kryhen në të ardhmen, investime në kundërshtim me parimet e ekonomicitet, efizencës dhe efektivitet në administrimin e fondeve publike.*

Në vazhdimësi

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi përfunduar auditimin e veprimtarisë ekonomiko financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil Tiranë në tërësi për periudhën nga data 01.01.2018 deri 31.08.2019, si dhe të pasqyrave financiare të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar të institucionit, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parasë, burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në aktivet e qëndrueshme si dhe amortizimin e tyre, pasqyra e lëvizjes së fondeve dhe shënimet shpjeguese.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Është audituar procesi i prokurimit publik, zbatimi i kontratave, arkëtimet, shpenzimet, paga dhe sigurime shoqërore, kreditorë dhe debitorë, largimet nga puna etj.

Baza për opinionin e kualifikuar.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4100¹ dhe ISSAI 4200². Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinionin e kualifikuar i grupit të auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Autoritetit të Aviacionit Civil Tiranë me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Në opinionin tonë, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për opinionin e kualifikuar, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një *opinionit të kualifikuar me theksim të çështjes*, për aspekte si më poshtë:

-Për miratimin e likuidimit të vlerës prej **152,600 Euro**, në favor të konsulentit “RB” GMBH e konsideruar **dëm ekonomik**, si vlerë që i përket zërave të pa argumentuar në kundërshtim me nenin 6.1 të kontratës së lidhur;

-Për miratimin e likuidimit të vlerës prej **134,928 Euro**, në favor të konsulentit “BA” SHPK e konsideruar **dëm ekonomik**, si vlerë që i përket zërave të pa argumentuar në kundërshtim me kontratën me nr. 2024/1 prot., datë 23.11.2018;

-Për miratimin e likuidimit të vlerës prej **20,252.96 Euro**, në favor të “TBP” SHPK, e konsideruar **dëm ekonomik** që i përket vlerës së garancisë të likuiduar nga AAC në favor të TBP;

-Për kryerjen e procedurave të prokurimit me objekte të cilat mund të mbuloheshin nga stafi i AAC duke shkatuar **efekte financiare negative në vlerën e 48,599,718 lekë**;

-Për nxjerrjen e urdhrin të prokurimit me fond limit të ndryshëm dhe më të lartë se fondi i përlogaritur;

-Për miratimin e shtesës në kohë të një kontrate, në favor të operatorit ekonomik dhe me pasoja negative për publikun;

-Për nënshkrimin e një kontrate në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa prokurim dhe në kundërshtim me ligjin e AAC;

-Nuk ka marrë masa për derdhjen në buxhet të fitimit për vitet 2017 dhe 2018, i cili paraqitet në **shumën 149,260,654 lekë**, dhe së bashku me vitet e mëparshme paraqitet në **shumën 279,917,654 lekë**.

¹ ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

² ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Shënim: Të gjithë punonjësve që atakohen në këtë raport auditimi duhet t'u bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t'u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta.

Rekomandime	Rekomanduar	Pranuar	Të pa pranuar	Realizuar	Realizuar pjesërisht	Në proces	Të pa zbatuara
Përmirësime ligjore	2	2	-	-	2	-	-
Masa organizative	11	11	-	3	3	5	-
Masa shpërblim dëmi	21	17	4	-	-	10	7
Masa për elimi.....	7	6	1	-	-	6	-
Masa disiplinore	6	6	-	5	-	1	-

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

VI ANEKSE

ANEKSI nr. 1

Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Totali	47	42	5	8	5	22	7
Totali në %	47 masa në 100%	89%	10.6%	17%	10.6%	46.8%	15%

ANEKSI nr. 2

Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues nuk kanë bashkëpunuar paraprakisht për studimin e Projekt Programit Ekonomik të vitit 2018 pasi nga sa kemi përshkruar më lart, Këshilli Drejtues e ka marrë relacionin e Drejtorit Ekzekutiv për këtë çështje të rëndësishme në të njëjtën ditë që edhe e ka aprovuar Vendimin për kthimin e Projekt Buxhetit në Buxhet të Autoritetit për vitin 2018 me vendimin nr.80, datë 21.12.2017. Sipas nenit 6/d të Ligjit 10233/2010 i ndryshuar me ligjin 10479/2011 dhe ligjit 168/2014 “Për autoritetin e Aviacionit Civil” thuhet se Këshilli Drejtues (d) “miraton programin financiar të Autoritetit dhe ndryshimet e tij, për të cilin informon ministrin si dhe mbikqyr realizimin e tij;” gjithashtu në nenin 13/c e këtij ligji kur flitet për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv, thuhet (c): “paraqet për miratim në këshillin drejtues programin ekonomik-financiar të Autoritetit dhe çdo ndryshim të tij”;

Bazuar tek neni 13 i sipërcituar, në Rregulloren e AAC, në nenin 7/b thuhet se Drejtori Ekzekutiv (b) “Propozon çështjet për shqyrtim në mbledhjet e Këshillit, të shoqëruar me materialin e përgatitur të cilin ja u paraqet të gjithë anëtarëve të tij” dhe në pikën (c) të këtij neni thuhet se Drejtori Ekzekutiv “Paraqet për miratim pranë Këshillit Drejtues Planin Strategjik të Autoritetit me objektiva dhe afate”. Nga citimi më lart i pikave të ligjit dhe i Rregullores, nuk ka një specifikim të vecantë sa ditë para shqyrtimit të tij dërgohet Projekt Buxheti në Këshilli Drejtues në muajin dhjetor i cili në nenin 6/6 i Rregullores së AAC të cituar më lart lihet si muaji kur Drejtori Ekzekutiv miraton planin vjetor të punës ku thuhet se: 6/6 “Në dhjetor të çdo viti, me propozim të Drejtorëve të Drejtorive të AAC, duke konsideruar mendimin e Sektorit të Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë mbi përmbushjen e standarteve, Drejtori Ekzekutiv miraton planin vjetor të punës”. Këtu nuk citohet shprehimisht se në cilën datë të muajit dhjetor duhet të aprovohet ky plan dhe sa ditë para marrjes së Vendimit duhet t’i paraqitet ai për shqyrtim Këshillit Drejtues i cili ka në përbërjen e vet edhe dy ekonomistë, bazuar tek neni 5/2 i ligjit 10233/2010 i ndryshuar, ku thuhet se: 2. “Këshilli drejtues është organ kolegjal, i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë, nga të cilët dy specialistë të fushës së transportit ajror, dy specialistë të fushës së financës dhe një specialist i fushës ligjore”.

Kriteri: Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar, neni 27, pika 1, ku cilësohet:

“Hartimi i rregulloreve të Autoritetit:

- 1. Ngarkohet këshilli drejtues që, brenda dy muajve nga emërimi i tij, të hartojë dhe të miratojë rregulloren e funksionimit të Autoritetit të Aviacionit Civil;*
- 2. Ngarkohet këshilli drejtues që, brenda tre muajve nga emërimi i tij, të miratojë rregulloret e tjera për funksionimin e përditshëm të institucionit, të propozuara nga drejtori ekzekutiv i Autoritetit.”*

ANEKSI nr. 3

Fondi prej **181,846** mijë lekë i ngurtësuar dhe i mbartur deri në muajin mars 2018 është një tejkallim prej 74,846,000 lekë të ngurtësuar në llogaritë e AAC nga vendimi i KD nr. 80 datë 21.12.2017 me nr. Prot. 352 datë 21.12.2017.

Situata: Në Vendimin e KD nr. 80 datë 21.12.2017 me nr. Prot. 352 datë 21.12.2017 në pikën 2 të Programit thuhet: “Krijimin dhe mbajtjen e një fondi rezervë për vitin 2018 në shumën



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

107,000,000 lekë (Referuar Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 39, datë 25.06.2014). Nga shqyrtimi i të dhënave të tabelës 1, pika 5, duket se tek zëri Fondi rezervë i miratuar nga KD ka një vlerë prej **181,846,279 lekë** çka është bashkimi i fondit të mbartur nga viti 2016 prej 130,657,000 lekë dhe fitimi i vitit 2017 prej 51,189,279 lekë. Nga analiza e mësipërme, AAC ka mbajtur të bllokuara në llogaritë e saj më tepër një shumë prej 78,846,279 lekë të cilat në muajin prill të 2019 duhej të dorëzoheshin në buxhet.

Kriteri: Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar, neni 18, pika 3, ku cilësohet:

“3. Veprimtaria e Autoritetit financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai. Të ardhurat e realizuara, por të pashpërndara në fund të vitit të parë buxhetor të veprimtarisë, mbarten për vitin pasardhës dhe reflektohen në nivelin e tarifave. Në vitet në vazhdim, të ardhurat e realizuara e të papërdorura, deri në fund të vitit, mbarten e përdoren për shpenzime të angazhuara deri për një periudhë 3-mujore të vitit pasardhës e më pas derdhen në Buxhetin e Shtetit”.

ANEKSI nr. 4

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me Vendimin nr. 10, datë 31.07.2018, me anë të të cilit, Këshilli Drejtues i AAC miraton ndryshimet në programin ekonomik për vitin 2018 duke shtuar zërin investime në vlerën 23,300,000 lekë për pagesën e konsulentit të kompanisë RB GMBH, i cili do të asistojë për negocimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe shoqërive Çengiz Construction & Kalyon & Kolin Construction, sipas shkresës së MIE me nr. 8607/1 prot., datë 20.06.2018. Në relacionin e drejtorit të AAC bashkangjitur vendimit të KD, cilësohet se: *“...Duke patur parasysh që pagesa e këtij shërbimi nuk është parashikuar në programin buxhetor të MIE dhe duke qënë se AAC është pjesëmarrëse në këtë proces, përcaktohet se ky i fundit do të paguajë vlerën e kontratës prej 152,600 Euro pa TVSH”.*

-Me shkresën nr. 8607/1 datë 20.06.2018 MIE dhe 116/7 datë 21.06.2018 AAC, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, z. GK, njofton AAC se është palë në kontratën shtesë të lidhur në datën 13.06.2018 midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Kompanisë “RB” GMBH për Shërbim Konsulencë. Në këtë kontratë shtesë, AAC është përcaktuar që të kryejë likuidimin e vlerës së kontratës bazë për llogari të “RB” GMBH për ofrimin e Shërbimit të Konsulencës që do ti ofrohet Shtetit Shqiptar dhe koncesionarit “CENGIZ CONSTRUCTION & KALYON & CONSTRUCTION” për lidhjen e kontratës koncesionare me objekt *“Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Aeroportit të Vlorës”.* Në kontratën shtesë, është riformuluar neni 6 i kontratës bazë të lidhur, duke autorizuar AAC **që të kryejë pagesat e konsulentit në llogarinë bankare të konsulentit, pas konfirmimit të klientit për kryerjen e shërbimit dhe skedulit të pagesave.** Në kontratën bazë, të lidhur në datën 28.04.2018, tek neni 6, Pagesat e Konsulentëve, pika 6.1, Shpërblimi i Shërbimit, përcaktohet se: **“Shpërblimi me një shumë të vetme i Konsulentit nuk do ta kalojë Çmimin e Kontratës dhe do të përfshijë; Përveç sa shprehet në kushtet e veçanta, Të gjitha Kostot e Personelit, kostot e Nënkonsulentëve, Printimeve, Komunikimeve, Udhëtimeve, Akomodimit dhe Kosto të Ngjashme si dhe të Gjitha Kostot e tjera që kanë pësuar Konsulentët në Kryerjen e Shërbimeve”.** Në relacionin dërguar Këshillit Drejtues të AAC, atë me nr. 1301 prot., datë 13.07.2018, Drejtori i AAC, në mënyrë të përmbledhur cilëson: *“...duke qënë se AAC është pjesëmarrës në këtë proces, përcaktohet se AAC do të paguajë vlerën e Kontratës prej 152,600 Euro (pa TVSH) ose nëse aplikohet do të shtohet TVSH prej 20%.* **Kjo vlerë, do të paguhet në llogarinë Bankare të**



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

Konsulentit pas konfirmimit të Klientit për kryerjen e shërbimit dhe skedulit të pagesave të përcaktuara në kushtet e veçanta të kontratës”.

-Nga Auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me likuidimet e kryera nga AAC në llogari të Konsulentit “RB” GMBH, u konstatua se:

a). Likuidimi i vlerës së paradhënies prej 76,300 Euro sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 10.08.2018 sipas urdhër xhirimit të Union Bank, dega Garda me kod 1114, nga llogaria bankare e AAC në lekë me nr. AL87214111060111320616030129 në llogarinë bankare të “RB” GMBH në Deutche Bank, Munchen. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura mban firmën e Konsulentit, ka të specifikuar arsyen e pagesës “Paradhënie” dhe vlerën e saj prej 76,300 Euro.

b). Likuidimi i vlerës së dytë prej 76,300 Euro, pagesë finale sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 25.07.2019 sipas urdhër xhirimit të BKT, dega me kod 505, nga llogaria bankare e AAC në Euro me nr. 401612629 në llogarinë bankare të “RB” GMBH në Deutche Bank, Munchen. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura për pagesën finale, është e njëjtë me faturën për pagesën e paradhënies. Pra, nuk vërtetohet se operatori e ka lëshuar faturën pasi ka përfunduar kryerjen e shërbimit. Gjithashtu, bashkangjitur urdhër xhirimit dhe faturës, është procesverbali i mbajtur nga grupi i negocimit. Në dokumentacionin e dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë shërbimet e kryera nga Konsulenti në përputhje me pikën 6.1 të kontratës së lidhur. Si rezultat, vlera e investuar nga AAC prej 152,600 euro, nuk është e justifikuar me dokumenta dhe fakte sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi e si e tillë do të konsiderohet dëm ekonomik (nëse nuk justifikohet) dhe duhet të dëmshpërblehet nga Konsulenti “RB” GMBH.

ANEKSI nr. 5

Nënshkrimi i kontratës së qirasë midis AAC dhe TBP, me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018 dhe pagesa e garancisë deri në marrjen në dorëzim të ambienteve nga AAC, në vlerën e 20,252.96 Euro, në kundërshtim me interesat ekonomik të Autoritetit të Aviacionit Civil. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurën e marrjes me qira të ambienteve tek TBP, u konstatua se AAC me përfaqësues z. KK, dhe TBP me përfaqësues znj. SA, kanë nënshkruar një kontratë për marrje ambientesh me qira në total 973.7 metra katror (sipërfaqe bruto) sipas nenit 1, pikës 1.1.1 të kontratës me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018. Për auditimin e kësaj çështjeje, grupi i auditimit, i është referuar vendimeve të marra nga KD, relacioneve nga Drejtori i AAC për KD dhe shkresave nga komunikimet e palëve të përfshira në këtë çështje të cilat pasqyrohen në vijim. Me Vendimin nr. 05, datë 17.04.2018, është miratuar nisma **mbi nevojën e një godine të re** të AAC-së, pranë operatorëve dhe në një zone jo urbane. Relacioni bashkangjitur vendimit të KD, është me nr. 781 prot., datë 16.04.2018. Tek ky relacion, në mënyrë të përmbledhur, cilësohet: *“AAC paraqet këtë propozim për mundësinë e transferimit të ambienteve të punës së AAC në një infrastrukturë më të përshtatshme duke konsideruar performancën e deritanishme të sektorit dhe zhvillimet e pritshme. ...Pritet që me dhënien me koncesion të aeroportit të Kukësit, ndërtimi dhe fillimi i operimit në aeroportin në Vlorë dhe licensimi i kompanive të reja ajrore Shqiptare, do ketë shtesë të aktivitetit të punës. Aktualisht, vlerësohet që ambientet e AAC janë të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme për të zhvilluar në tërësi dhe në nivel cilësie detyrat për të cilat institucioni është aktualisht i ngarkuar.*



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

*Vendndodhja e institucionit në një vend të populluar urban e bën të vështirë zhvillimin siç duhet të punëve ditore, qoftë nga aspekti fizik i parkimit të automjeteve, deri tek vështirësitë menaxheriale të prezencës së punonjësve për shkak të vendndodhjes pranë vendeve të banimit apo pikave të tjera me interes nga ana e tyre.Sipërfaqja totale e ndërtimit, prarashkohet të jetë rreth 3600 m², nga të cilat 2100 m² është sipërfaqe e zyrave (3 kate x 700 m²) dhe 1500 m² sipërfaqe mbështetëse katering dhe parkimi. Përsa më sipër, propozohet që pas miratimit nga KD i kësaj nisme, t'i drejtohem Ministrisë për miratim të nismës dhe të kërkohet hulumtimi në pronat në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave Ajrore, me qëllim që toka e nevojshme në afërsi të operatorëve, zonës së Rinasit, të merret me kalim kapitali nga pronat nën administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes”. Me vendimin nr. 18, datë 07.11.2018, është miratuar nga KD, **propozimi për transferim me zyra të Aviacionit Civil për një periudhë 2 vjeçare, në qendrën e biznesit “TBP” SHPK**. Bashkalidhur vendimit të mësipërm, është:*

-Shkresa nr. 8897/3 prot., datë 23.10.2018 MIE dhe nr. 1147/1 prot., datë 25.10.2018 AAC, e dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i MIE z. GK, cilëson: “MIE me shkresën nr. 8897/2 prot., datë 31.07.2018, i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes për të marrë konfirmim për vijimin me procedurat përkatëse, me qëllim realizimin e kalimit të përgjegjësive së administrimit të pronës pranë AAC....Sa më sipër, ndodhur në këto kushte dhe duke pasur parasysh nevojat e AAC për ambiente të reja, **sygjerohet që deri në miratimin e projektvendimit, AAC të marrë parasysh zgjidhjen e situatës me burimet e veta financiare**”.

Sqarim: Kjo shkresë, nuk ka lidhje me vendimin për transferim në ambiente me qira të AAC.

-Relacioni i Drejtorit të AAC, drejtuar KD tek i cili, në vija të përgjithshme, përcaktohet se: “Në vijim të nismës së ndërmarrë nga KD i AAC, **nëpërmjet vendimit nr. 5, datë 18.04.2018 dhe shkresës nr. 8897/3 prot., datë 23.10.2018 nga MIE, ju paraqes kërkesën time me propozimin për lëvizje me zyra pranë Tirana International Airport.....Gjithashtu, AAC përdori edhe metodologjinë krahasuese të kostove aktuale vjetore me alternativën më të pranueshme në zonën e Rinasit, duke kontaktuar direkt me “TBP”, si i vetmi entitet në zonë që plotëson kushtet dhe standardet e duhura për ambiente zyrash. Oferta e komunikuar nga TBP për periudhë 1 vjeçare, është 138,343 Euro.....Nëpërmjet vendosjes me qira në TBP, AAC ka këto avantazhe:.....Ambiente më të bollshme për punonjësit, duke marrë me qira rreth 950 m² zyra, këtu i jemi referuar standardit Europian 10m²/punonjës + 40% hapësira të përbashkëta. Si përfundim.....kërkoj miratimin tuaj për lidhjen e kontratës së qirasë për 2 vite me “TBP”.**

-Me shkresën nr. 2019 prot., datë 12.11.2018, Drejtori i AAC, nxjerr urdhrin nr. 449, me anë të të cilit, në zbatim të vendimit të mësipërm të KD për transferim të administratës së AAC, ngre grupin e punës për marrjen e të gjitha masave për negociimin e lidhjes së kontratës së qirasë të zyrave me shoqërinë TBP në qendrën e biznesit TBP për një periudhë 2 vjeçare.

-Me shkresën nr. 2019/1 prot., datë 16.11.2018, grupi i ngritur me shkresën e mësipërme dërgon një informacion tek Drejtori i AAC ku në vija të përgjithshme i parashtron: “Hapësira e ofruar, zyrë në katin e tretë, me sipërfaqe 973.70 m².....Ofrohet mundësi transporti për punonjësit sipas itinerarit Tiranë-TBP-Tiranë, çmimi 2500 lek (TVSH e përfshirë). Me vendimin nr. 03, datë 22.05.2019, KD vendos anulimin e vendimit nr. 18, datë 07.11.2018 “Për transferim me zyra të AAC-së në Qendrën e Biznesit TBP”. “Miraton negociimin e zgjidhjes së kontratës së qirasë të lidhur me datë 19.11.2018, midis AAC-së dhe shoqërisë TBP SHPK”. Në fillim të vendimit, tek përshkrimi i negociimit të zgjidhjes së kontratës së qirasë, në vija të përgjithshme cilësohet se: “...duke pasur parasysh shkresën e Ministres së Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka me lëndë kthim përgjigje shkresës nr. 10, datë 18.03.2018, ku ndër të tjera shprehej se MM, nuk ka shprehur dhe



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

nuk shpreh dakordësinë për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit dhe kalimin tek AAC, të pronave nr. 794, me emrin Detashmenti VIP (ish regjimenti 4020) dhe nr. 1122 me emërtimin Ish Bateri AKA, Radiodrita (ish regjimenti 4020).....kishte si qëllim transferimin e përkohshëm në ambientet pranë TIA..... Të ndodhur para faktit ku lëvizja e përkohshme në ambientet e TBP, nuk përkon me qëllimin e lidhjes së kontratës së qirasë, KD vendos..”. Bashkangjitur vendimit të mësipërm, është shkresa me nr. 10 prot., datë 18.03.2019, drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, ku Kryetari i KD, kërkon sqarime lidhur me pronat që ka në dispozicion MM dhe që janë deklaruar nga Major M. Jera dhe Kapiten S. Hasimllari.

*-Në vazhdim, është shkresa me nr. 1727/2 prot., datë **27.03.2019** MM dhe nr. 13 prot., datë **28.03.2019** AAC, me anë të së cilës, Ministria e Mbrojtjes, i dërgon KD të AAC, përgjigje ku i cilëson se: “Ministria e Mbrojtjes, nuk ka shprehur dhe nuk shpreh dakordësinë për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit dhe kalimin tek AAC të pronave nr.”.*

*-Me shkresën nr. 1714 prot., datë **08.02.2019** MIE dhe nr. 276 prot., datë 08.02.2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë znj. Belinda Balluku, i kërkon informacion AAC ku i cilëson: “Në zbatim të nenit 3 dhe 20 të ligjit 10233, datë 11.02.2010 për AAC, i ndryshuar, kërkojmë dërgimin e një informacioni të detajuar në Ministri, në lidhje me vendimmarrjen dhe procedurën e ndjekur nga AAC për nënshkrimin e kontratës së qirasë me TBP, si dhe veprimet e kryera deri tani për zbatimin e saj, duke përfshirë edhe dërgimin (në MIE) të kontratës së nënshkruar. Deri në informimin nga Ministria për masat e mëtejshme që do të merren, nga ana juaj të pezullohet zbatimi i kontratës dhe çdo procedurë apo veprime të mëtejshme lidhur me marrjen e ambienteve me qira nga AAC pranë TBP”.*

*-Shkresa me nr. 22 prot., datë **13.02.2019** TBP dhe nr. 306 prot., datë 14.02.2019 AAC, me anë të së cilës shoqëria TBP, kërkon nga AAC që të merren në dorëzim zyrat në datën 14.02.2019, sipas kontratës së qirasë së lidhur midis AAC dhe TBP me nr. 2054 Rep, nr. 419 Kol, datë 19.11.2018.*

*-Shkresa me nr. 306/1 prot., datë **14.02.2019** nga AAC drejtuar TBP, në përgjigje të shkresës më sipër të gërmës (a), ku cilësohet se: “Në vijim të shkresës suaj me nr. 22 prot., datë 13.02.2019, me anë të së cilës njoftoni mbi datën dhe modalitetet e marrjes në dorëzim të zyrave me qira pranë TBP, dëshirojmë t’ju bëjmë me dije se procedura e vendimmarrjes e ndjekur nga AAC për nënshkrimin e kontratës së qirasë me TBP është në proces vlerësimi nga MIE”*

*-Shkresa me nr. 306/2 prot., datë **21.02.2019** nga TBP drejtuar AAC, në përgjigje të shkresës më sipër të gërmës (b), për dijeni MIE, ku në mënyrë të përmbledhur cilësohet se: “.....Përsa më sipër, kërkojmë mirëkuptimin tuaj që brenda 2 (dy) javëve të ardhëshme, brenda datës 4 Mars 2019, ne presim që ju të merrni në dorëzim zyrën sipas kontratës së lidhur ndërmjet palëve”.*

*-Shkresa me nr. 306/3 prot., datë **25.02.2019** nga AAC drejtuar znj. Stephanie Sieg Administratore e TBP, ku në mënyrë të përmbledhur cilësohet se: “.....Përsa më sipër, kërkojmë pezullimin e detyrimeve të qiramarrësit deri në një përgjigje nga MIE”.*

*-Në vazhdim është shkresa me nr. 37 prot., datë **18.03.2019** TBP dhe nr. 306/4 prot., datë 19.03.2019 AAC, për dijeni MIE znj. Belinda Balluku dhe Ambasadës Gjermane znj. Susanne Schutz, me anë të së cilës shoqëria TBP, kërkon korigjimin e gabimeve të kontratës së qirasë duke cilësuar: “Ka kaluar më shumë se 1 muaj që afati i qirasë ka filluar dhe ju akoma nuk jeni futur në ambientet e marra me qira. Me shkresën nr. 306/3 prot., datë 25.02.2019, ju keni kërkuar që të pezullojmë detyrimet e qiramarrësit deri në marrjen e një përgjigje nga MIE.ju lutemi brenda datës 1 prill 2019, të merrni në dorëzim zyrën në të kundërt kontrata e qirasë do të zgjidhet dhe do të fillojnë procedurat ligjore”.*



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

- Në vazhdim është shkresa me nr. 74 prot., datë **13.06.2019** TBP dhe nr. 1176 prot., datë 17.06.2019 AAC, Propozim për zgjidhjen e kontratës së qirasë datë 19.11.2018, ku TBP propozon që të zgjidhet kontrata me mirëkuptim duke mbajtur vetëm pagesën e garancisë që është depozituar nga AAC me lidhjen e kontratës.
- Me shkresën me nr. 1176/1 prot., datë **18.06.2019** AAC i kërkon takim TBP-së për të negociuar kushtet e zgjidhjes së kontratës. Me shkresën nr. 1176/2 prot., datë 21.06.2019, janë dokumentuar minutat e takimit lidhur me negociimin e zgjidhjes së kontratës nga ku bihet dakord që nga qiramarrësi të mbahet vlera e garancisë e paguar nga AAC në datën e lidhjes së kontratës së qirasë, **prej 20,252.96 Euro**.
- Me shkresën nr. 1176/3 prot., datë **27.06.2019**, Drejtori i AAC, dërgon një relacion tek KD i AAC-së lidhur me kërkesat e TBP për zgjidhjen e kontratës dhe parashtron si zgjidhje të vetme, mbajtjen e vlerës së garancisë prej **20,252.96 Euro** nga qiradhënësi.
- Me vendimin nr. 11, datë 28.06.2019, KD vendos miratimin e zgjidhjes së kontratës së qirasë nr. 2019/2, datë 19.11.2019, ndërmjet TBP dhe AAC.
- Drejtori i AAC, ka lidhur një kontratë për marrje ambienti me qira, në datën 19.11.2018, në të njëjtën kohë që:
 - Në datën **17.04.2018**, i ka kërkuar KD, i cili në vazhdim me vendimin nr. 5 të datës **17.04.2018**, ka rënë dakort që AAC t'i drejtohet Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili në vazhdim të kërkojë hulumtimin e pronave në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave Ajrore, me qëllim që toka të jetë në afërsi të operatorëve, zonës së Rinasit, dhe **të merret me kalim kapital nga pronat nën administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes.**
 - Drejtorit të AAC, i është dërguar përgjigje nga MIE shkresën nr. 8897/3 prot., datë 23.10.2018, me anë të së cilës, MIE i sygjeron AAC që **të presi daljen e projektvendimit për kalimin kapital të ndonjë toke nga pronësia e Ministrisë së Mbrojtjes në pronësi të AAC.**
 - Drejtori i AAC, nuk i ka dhënë asnjë informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, referuar shkresës me nr. 1714 prot., datë 08.02.2019, ku kjo e fundit i kërkon Drejtorit të AAC, **informacion të detajuar për mënyrën e nënshkrimit të Kontratës së qirasë.**
- Ambienti që AAC ka rënë dakort për ta marrë me qira, ka një sipërfaqe prej 973.7 metra katror (sipërfaqe bruto) sipas nenit 11, pikës 1.1.1 të kontratës me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018 të nënshkruar nga AAC dhe TBP. Nga auditimi, rezultoi se AAC ka zhvilluar një procedurë prokurimi me objekt “Detyrë projektimi për studim-hartimin e riparimin, hidroizolim dhe lysterje të institucionit” e në vazhdim ka lidhur kontratën me nr. 1379/1 prot., datë 25.07.2019 me subjektin “STUDIO SERVICES” për hartimin e projekt-preventivit i cili është marrë në dorëzim sipas akt-dorëzimit të datës 02.08.2019, nga AP, OA dhe AN. Referuar projektit të dorëzuar nga grupi i projektimit, sipas fletëve të projektit me nr. K-03, K-04 dhe K-05, rezulton se kati përdhe, ka një sipërfaqe bruto afërsisht 335 m² dhe kati i I (parë), ka një sipërfaqe bruto afërsisht 580 m². Këtu nuk llogaritet sipërfaqja e parkimit përpara institucionit e cila normalisht hyn tek termi sipërfaqe bruto sipas termit të përdorur në kontratë. Në total, sipërfaqja bruto e objektit është afërsisht 915 metra katror. Pra, Drejtori i AAC, ka vendosur të nënshkruajë një kontratë qiraje për një ambient me sipërfaqe vetëm 58 metra katror më tepër se sipërfaqja që AAC ka pasur në përdorim duke pretenduar se AAC ka nevojë për hapësirë për të kryer detyrat e saj të përditëshme. Një zgjidhje e mundshme do të ishte p.sh shfrytëzimi i ambientit në katin përdhe me sipërfaqe 25 m² sipas fletës K-03 të projektit, nga ambient për “Bar-Kafe” në ambient për zyrë.
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit, rezultoi se Drejtori i AAC, ka iniciuar me shkresën nr. 171 prot., datë 24.01.2019, urdhër prokurimi nr. 5, procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim i



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

transportit automobilistik të stafit të administratës” me fond limit 1,916,666 lekë pa TVSH. Kjo procedurë prokurimi është iniciuar arbitrarisht nga Drejtori i AAC, pa arsyetuar mbi nevojat reale të AAC por duke u nisur nga nevojat imagjinare. AAC, duhej që paraprakisht të paktën të merrte në dorëzim ambientet, të transferohej në ambientet e marra me qira dhe në vazhdim mund të kërkonte të kryente procedurë prokurimi për transportin e stafit nga Tirana në Rinas dhe anasjelltas (duke e miratuar në KD) duke pasur parasysh se TBP i ka ofruar transport për stafin sipas shkresës së negocimit midis AAC dhe TBP me nr. 2019/1 prot., datë 16.11.2018, ku në veçanti cilësohet se nga TBP SHPK, “**Ofrohet mundësi transporti për punonjësit sipas itinerarit Tiranë-TBP-Tiranë, çmimi 2500 lek (TVSH e përfshirë)**”. Gjithashtu, Drejtori i AAC, edhe pse është urdhëruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me anë të shkresës nr. 1714 prot., datë 08.02.2019, “Për pezullimin e zbatimit të kontratës së qirasë me TBP dhe **pezullimin e çdo procedure apo veprimi të mëtejshëm lidhur me marrjen e ambienteve me qira**”, ka lejuar vazhdimin e procedurës së prokurimit edhe pas këtij urdhri, deri në datën 09.05.2019 sipas shtojcës 20, formulari i njoftimit të anulimit të lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik “BALLA TOURS” SHPK, të shpallur fitues nga AAC, në datën 05.03.2019 sipas shtojcës 13, formulari i njoftimit të fituesit. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua se AAC ka iniciuar gjithashtu edhe një procedurë me objekt “Blerje letër murale” për ambientet e zyrave të marra me qira, në datën 08.02.2019.

-Sipas dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit, trajtuar dhe më lart, konstatohet se Drejtori i AAC, është informuar në datën 16.11.2018, lidhur vlerën e qirasë nga grupi i negocimit i ngritur prej tij. Në datën 19.11.2018, Drejtori i AAC, ka nënshkruar kontratën me TBP SHPK, pa asnjë analizë nga ana e tij ose nga strukturat përkatëse të AAC.

-Sa më sipër, referuar gjetjeve dhe konkluzioneve të grupit të auditimit, vlera e likuiduar nga AAC, në favor të TBP prej 20,252,96 Euro, konsiderohet dëm ekonomik për AAC/Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga personat përgjegjës të cilët kanë vepruar në kundërshtim me interesat ekonomike të institucionit.

ANEKSI nr. 6

Në Ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 i ndryshuar, “Për Aviacionin Civil”, konstatohet se ka paqartësi mbi çështjen e nivelit të pagave në AAC. Në Ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 i ndryshuar, “Për Aviacionin Civil”, konstatohet se ka paqartësi mbi çështjen e nivelit të pagave për arsye se AAC e ka vetë kompetencën e vendosjes së nivelit të tyre, ndërsa marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me legjislacionin e shërbimit civil. Nga kjo ka rezultuar që niveli i pagave të AAC është i lartë, krahasuar me nivelin e pagave të institucioneve të tjera që përfshihen në legjislacionin e shërbimit civil. Deri më datë 31.12.2016, pagat e Institucionit kanë funksionuar në zbatim të niveleve të pagave të miratuara për punonjësit e shërbimit civil. Pas datës 01.01.2017, nivelet e pagave kanë ndryshuar, si rezultat i miratimit me Vendimin nr. 62, datë 21.11.2016 (të protokolluar nga Këshilli Drejtues me nr. 299 datë 21.11.2016), i Rregullores “Për strukturën, nivelin e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës dhe shpërblimet për performancë në Autoritetin e Aviacionit Civil”. Me shkresën nr.5760/1, datë 01.12.2016, protokolluar në AAC me nr. 1593, datë 01.12.2016, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës është shprehur dakord në lidhje me ndryshimet e propozuara.



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

ANEKSI nr. 7

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën e auditimit 01.01.2018 - 31.08.2019, u konstatuan 2 raste të ndryshimit të strukturës, respektivisht me 69 dhe 73 punonjës. Ndërsa para shkurtit të vitit 2018 në strukturën e AAC ka pasur 83 punonjës me organigramë duke tejkalar në mënyrë të parregullt me 17 punonjës numrin e përcaktuar me VKM nr.100 datë 26.02.2014. Nga auditimi i dokumentave të vena në dispozicion, përkatësisht sipas Vendimit nr.79 datë 21.12.2017 dhe Vendimit nr.21 datë 28.12.2018 të Këshillit Drejtues, vendime këto të miratuara nga Ministri i MIE përkatësisht me shkresat nr.3868/5 datë 16.02.2018 dhe Urdhrin nr.2 datë 11.01.2019 struktura në asnjë nga dy rastet e përmendura më sipër për ndryshimet strukturore gjatë periudhës së auditimit nuk ka plotësuar kushtet për ristrukturimin e institucionit si dhe në asnjë rast nuk janë vënë në dijeni Departamenti i Administratës Publike dhe Ministri i Ekonomisë dhe Financave. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk ka shkaqe të tilla të dukshme dhe nuk ka relacione shpjeguese se përse bëhen këto ndryshime strukturore në numër dhe në përmbajtje.

ANEKSI nr. 8

Rritje e shpenzimeve të AAC nga shlyerjet e titujve ekzekutivë. AAC ka shpenzuar nga humbja e proceseve gjyqësore në total për periudhën 20 mujore të auditimit **6,112,547 lekë** gjithësej, të ndarë në dy periudhat e ndryshme vjetore përkatësisht në **528,396 lekë** (viti 2018) dhe **5,584,151 lekë** (8 muajt e parë të vitit 2019). Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se gjatë vitit 2018 është paguar një ish punonjëse e AAC-së, për të cilën janë likuiduar paga të prapambetura në vlerën 470,236 lekë bruto dhe sigurime shoqërore e shëndetësore nga punëdhënësi në shumën 58,160 lekë, periudha 14 Mars-30 Qershor 2018. Baza ligjore për pagesën janë, Vendimi Nr.2316 datë 18.06.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së parë. Nga auditimi u konstatua se objekti i kërkesë-padive të punonjësve si palë e paditur në përgjithësi konsiston në disa pika: 1- Deklarimin e marrëdhënies së punës të zgjidhur nga ana e punëdhënësit në mënyrë të menjëherëshme dhe pa shkaqe të justifikuar; 2. Detyrimin e palës së paditur, të dëmshpërblejë paditësin me disa paga mujore, për mosrespektim të afateve të njoftimit për zgjidhjen e marrëdhënies së punës; 3. Detyrimin e palës së paditur, të dëmshpërblejë paditësin me pagën e 1 (një) viti për zgjidhjen në mënyrë të menjëherëshme pa shkaqe të justifikuar të kontratës së punës me kohëzgjatje të pacaktuar; 4. Detyrimin e palës së paditur, të dëmshpërblejë paditësin me disa paga mujore, për moszbatim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; 5. Detyrimin e palës së paditur, të dëmshpërblejë paditësin me disa paga mujore, si shpërblim për vjetërsi në punë. AAC pretendonte në mbrojtjen e saj se ishin dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë ato që kishin rregulluar marrëdhëniet e punës me AAC-në, derisa ky Institucion u perfshi si një nga subjektet e ligjit nr. 152, "Për nepunësin civil", datë 26.02.2014.

ANEKSI nr. 9

Nga auditimi i dokumentacionit dhe Rregulloreve me të cilat ka punuar AAC u konstatua se Autoriteti nuk i ka pasqyruar (deri në miratimin e Rregullores në fuqi në datën 12.06.2019) në këtë dokument ndryshimet strukturore të realizuara pas 2 vendimeve përkatëse të KD dhe Ministrisë të MIE të përmendura më lart. Nga auditimi u konstatua se ndërhyrja në Rregulloren e parë nuk ishte bërë në harmonizim me strukturën e saj, duke përshtatur në disa raste vetëm përshtatjet e vendit të ri në strukturë tek Anekset, pa respektuar hierarkinë e ligjit për të përshtatur së pari Rregulloren



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

dhe pastaj anekset e saj. AAC ka hartuar dhe miratuar Rregulloren në fuqi me Vendimin nr. 5, datë 13.06.2019 me një vonesë prej mbi 5 muajsh nga miratimi i strukturës në fuqi nga Ministri me Urdhrin nr. 2 datë 11.01.2019. Nga auditimi i dokumentacionit dhe dy Rregulloreve të përdorura nga AAC për periudhën e auditimit u konstatua se ka pasur një Rregullore të miratuar me Vendimin nr. 29 datë 23.04.2013 dhe Rregulloren në fuqi të miratuar me Vendimin nr.5, datë 13.06.2019. Nga paraqitja më lart e dokumentave të shqyrtuara mbi Vendimet e strukturës së AAC duket se Rregullorja sipas Vendimit nr. 29 datë 23.04.2013 nuk ka pasqyruar ndryshimet e VKM nr. 100 datë 26.02.2014 dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 60, datë 21.11.2016, Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 69, datë 12.04.2017 dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 79, datë 21.12.2017, miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 3868/5, datë 16.02.2018, protokolluar në AAC me nr. 297, datë 19.02.2018.

ANEKSI nr. 10

Nuk ka procedurë për vlerësimin dhe ndikimin që kanë në mjedis, të materialeve elektronike që janë nxjerrë jashtë përdorimit dhe nuk dokumentohet mënyra e asgjësimit të tyre. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me aktivet e nxjerra jashtë përdorimit dhe asgjësimit të tyre, konstatohet se; Në përbërje të listës së aktiveve të cilat rezultojnë që nuk janë në përdorim dhe, që duhet të dalin nga regjistri i aktiveve të Institucionit, *ka materiale elektronike të cilat konsiderohen të dëmshme dhe nuk duhet të hidheshin apo të asgjësoheshin, pa një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre, me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim, si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore.* Nga Titullari i AAC nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre, nuk ka asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet. Këto pajisje janë pajisje IT dhe telekomunikacioni si më poshtë: kompjuter personal copë-12, laptopë copë-6, kompjuter note PAD, tabletë copë-2, printerë copë-4, fotokopje copë-3, skaner copë-2, faks copë-3, aparat celular copë-5, bateri UPS, invertitor, bateri 180 Ah, copë-61. Nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion mënyra e dërgimit, çmontimit dhe asgjësimit të këtyre aktiveve pasi, automjeti nuk rezulton të ketë përshkuar lëvizje në landfillin e Sharrës, sipas akteve të vëna në dispozicion. Konkretisht në datat pas urdhrin nr. 412, datë 19.10.2018 të titullarit të AAC e deri në datën e hartimit të procesverbalit, itinerari i automjetit me të cilin do transportoheshin aktivet, sipas sistemit GPS, nuk rezulton të ketë qenë në landfillin e Sharrës. Ndërkohë që për materialet e dërguara në landfillin e Kukësit rezulton se ka një itinerar në datën 01.11.2018 por, nuk ka dokumentacion të mënyrës së asgjësimit të aktiveve.

ANEKSI nr. 11

Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit për procedurën e prokurimit me objekt “Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO”, me fond limit 6,966,189 lekë pa TVSH, referuar në pikën 6 të projekt raportit të auditimit dhe konkretisht të gjetjes nr. 3 ku cilësohet në mënyrë të përmbledhur përsa i përket dëmit ekonomik të konstatuar “...operatori ekonomik “TC” SHPK, nuk ka dorëzuar pranë AAC, dokumentacion që vërteton angazhimin e ekspertëve të huaj të deklaruar në formularin e ofertës sipas ditëve dhe kohës së tyre të punës, mbi bazën e të cilave, është bërë dhe përlllogaritja e vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit.....”, sqarojmë se merren në konsideratë pretendimet e observacioneve të ardhura nga stafi i AAC dhe nga operatori ekonomik “TC” SHPK shkresore dhe verbale në ballafaqimin e



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

kryer në KLSH pasi janë dorëzuar fotografi që vërtetojnë kryerjen e trajnimeve të stafit të AAC në ambientet e cilësuara sipas kontratës së lidhur. Gjithashtu, është dorëzuar dhe cilësuar edhe procesverbali i grupit të ndjekjes së zbatimit të kontratës por mbi të gjitha edhe dokumentacioni që vërteton dhe garanton nga operatori ekonomik se ky i fundit sëbashku me ekspertët e tij do të asistojë në kohën që AAC do të kërkojë standartizimin me certifikatë ISO. Si rrjedhojë, gjetja nr. 3 e akt-konstatimit nr. 8 (dëm ekonomik) të Kontrollit të Lartë të Shtetit, **hiqet në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar auditimi.**

VII SHKURTIME

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministra e Infrastrukturës dhe Energjisë.
KD	Këshilli Drejtues
AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
SHPK	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
TAP	Tatimi i të ardhurave nga punësimi
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave



Kontrolli i Lartë i Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL” SHQIPTAR

NJP	Njësia e Prokurimit
AK	Autoriteti Kontraktor
DST	Dokumentet Standarde të Tenderit
OSHA	Organi Shrtetëror i Autorizuar
BVV	Blerje me vlera të vogla